



RAPORTI VJETOR 2025

PËRMBAJTJA

RAPORTI VJETOR 2025	1
I.HYRJE	8
FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE	8
Misioni	8
II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE	10
Menaxhimi sipas objektivave	10
Të ardhurat e vitit 2025	10
Grafik 1. Struktura e të ardhurave	13
Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2025	14
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2025 sipas DRT-ve (000 lekë)	14
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 lekë)	15
Tabela 4. Të ardhura nga Tatimi mbi Fitimin (000 lekë)	15
Tabela 5. Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 lekë)	16
Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zerave (000 lekë)	16
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 lekë)	17
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)	17
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke)	18
Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore	19
Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës	20
III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE	23
I- Puna e kryer nga Sektori i Asistencës dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve.	24
1.Standartizimi i funksionit të shërbimit ndaj tatimpaguesve	24
2- Ofrimi i Shërbimve cilësorë për tatimpaguesit, si detyrë e përhershme e AT.	26
Vërtetime të miratuara/lëshuara nga sportelet e shërbimit 2025	26
Vërtetime të lëshuara online nga portali e-Albania 2025	27
3- Informimi, sqarimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve:	29
II. Sektori i Thirrjeve (Call Centër)	31
Aktivitete të realizuara gjatë vitit 2025	32
IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE	34
1. HYRJE	34

2. OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR VITIN 2025	35
3. Progresi Organizativ i Administratës Tatimore dhe Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore	36
4. AKTIVITET E PROGRAMUARA DHE REALIZUARA GJATË VITIT 2025 NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE	36
SEKTORI LIGJOR.....	37
SEKTORI TEKNIK	40
V. KONTROLI TATIMOR	42
Objektivat për vitin 2025	43
Aktivitetet të realizuara për vitin 2025.....	46
VI.MENAXHIMI I RISKUT	49
Objektivat e Drejtorisë për vitin 2025.....	49
Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë vitit 2025, në funksion të aritjes së objektivave.	50
Plani i Turizmit 2025.....	50
Formalizimi i sektorit të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtoraleNë kuadër të formalizimit të sektorit të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe rritjes së sigurisë ushqimore, është analizuar çdo subjekt që ushtron veprimtari si grumbullues ose përpunues i produkteve ushqimore, përfshirë këtu edhe përpunimin e qumështit.	52
Publikimi i pagave indikative	52
Përmirësimi i Modullit të Riskut.....	53
Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë Kërkesë për Rimbursim	54
Të tjera aktivitete të realizuara nga DMR gjatë vitit 2025.	59
VII. DREJTORIA E MBLEDHJES SE DETYRIMEVE TATIMORE TE PAPAGUARA	61
Detyrimet sipas Llojit të Tatimit	62
Mosha e detyrimeve të papaguara në afat.....	63
Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesit	64
VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË.....	66
Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së	66
Baza Ligjore	66
Aktivitetet e programuara dhe realizuara për vitin 2025	67
Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së sipas afateve ligjore.....	68
Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së	71
Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim	71

Rimbursimi i TVSH-së sipas projekteve e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi.	71
IX. DREJTORIA E VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN NË DPT	72
Organizimi	72
Qëllimi	72
Objektivat:.....	72
Realizimet:	73
Grafiku 1: Kontrollët dhe Shkeljet e DVKT-së	74
Grafiku 2: Vlera e Shkeljeve sipas DVKT-ve	74
Grafiku 3: Shkeljet kryesore të DVKT-së	75
Verifikime në kuadër të Sezonit Turistik 2025 (Qershor-Shtator 2025):	76
Denoncime/Ankesa	76
Raste të administruara përmes Platformës së Bashkëqeverisjes	78
Ndihmesa për qytetarët përmes kanaleve të komunikimit	79
Vlerësim i përgjithshëm dhe përfundime	81
X. MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE	83
Hyrje.....	83
Detyrat funksionale.....	83
Objektivat për vitin 2025	84
Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2025 në funksion të realizimit të objektivave.....	85
Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë	85
Sektori i Menaxhimit të Projekteve dhe Implementimit.....	85
XI. BUXHETI DHE FINANCA.....	88
XII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE.....	89
SEKTORI I BRENDSHËM	89
SEKTORI I PROKURIMEVE	90
XIII. DIBA.....	93
XIV. DREJTORIA E KONTROLLIT TË SPECIALIZUAR	94
Hyrje	94
Struktura organizative.....	94
Objekti dhe detyrat për vitin 2025.....	95

Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2025.....	95
Analiza DIVA 2023	95
Analiza e Riskut dhe Ndërtimi i Planit të Veprimeve për Kontrollin e 100 Individëve	97
Trajnimi i stafit.....	98
XV. DREJTORIA PER PROCESET E BIZNESIT	99
1. Qëllimi i raportit	99
1.1 Sektori i Analizës dhe Implementimit të Proceseve të Biznesit (1+5).....	99
1.2- Sektori i Kordinimit të Manualeve të Punës (1+2)	100
3. Rezultatet e arritura gjatë peridhes Janar-Dhjetor 2025	101
XVI. DREJTORIA E INFORMACIONIT	105
Detyrat kryesore të Drejtorisë së Informacionit	105
Organizimi i Drejtorisë së Informacionit	106
Objektivat e Drejtorisë për vitin 2025.....	106
AKTIVITETET E PROGRAMUARA DHE KRYERA GJATË VITIT 2025	107
SEKTORI I KOMUNIKIMIT.....	107
SEKTORI I SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT	108
XVII. DREJTORIA E IMPLEMENTIMIT TË OPERACIONEVE TATIMORE.....	110
SEKTORI I OPERACIONEVE FINANCIARE DHE TATIMORE	110
Analiza mbi ecurinë e marrëveshjeve për vitin 2025, sipas rajoneve/drejtorive rajonale.....	110
Tabela përmbledhëse sipas rajoneve (14 Drt -ve) për vitin 2025	112
Implmentimi i shërbimit online në portalin e-albania	112
SEKTORI I REGJISTRIT TË BIZNESIT	113
Transferimi i tatimpaguesve nga nje DRT ne nje DRT tjetër	115
Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve.....	115
Perditesimi i ndryshimeve ne regjistrim, qe behen ne QKB.....	116
Çregjistrimi i tatimpaguesve ne sistem.....	117
Ndryshimet e paketes ligjore per vitin 2025 dhe puna per implementimin e tyre ne sistem	118
XVIII. DREJTORIA E HETIMIT TATIMOR	119
I.PËRMBLDHJA EKZEKUTIVE	119
II.PROBLEMATIKAT TË CILAT DUHEN ADRESUAR	121
III.ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN.....	123

IV. ANALIZA E SEKTORIT TË HETIMIT TATIMOR	123
5.2 Analizë për propozimet për kontroll/vlerësimet tatimore	131
6.1 Analiza e të dhënave për çështje të regjistruara gjatë vitit 2025	133
6.5 Shkresa RAD	134
6.6 Bashkëpunime me autoritetet e huaja (Letërporosi)	134
XIX. DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE	135

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit, www.tatime.gov.al

Shkurtime	
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
TAP	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
RPA	Regjimi i Përpunimit Aktiv

I.HYRJE

FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Misioni

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1 246 punonjës (fakt 2025) duke e renditur administratën tatimore si një nga institucionet ligjzbatues më të rëndësishme në vend.

Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vende anëtare të BE-së që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënie proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushje të nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasa të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive të cilat do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura të cilat shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:

Ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

Rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:

Zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut,

Përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore,

Mbledhjes efikase dhe efektive të borxhit,

Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes;

Aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne,

Zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve,

Mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore,

Zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve,

Modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës,

Kënaqësia nga shërbimet elektronike të tatimeve është dukshëm më e lartë në 2025 në të tëra aspektet e vlerësuara, si akses, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave,

Një rritje e konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen dhe etikën e inspektorëve,

Një rritje të ndjeshme në ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektim bazuar në të.

II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE

Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 një ndër objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë:

Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,

Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale,

Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit,

Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirëadministrim,

Trajnimi i vazhdueshëm për nëpunësit e të gjitha niveleve.

Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:

Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte në rritjen e tyre.

Efektet e paketës fiskale për vitin 2025.

Forcimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë.

Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore.

Të ardhurat e vitit 2025

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12 mujore 2025, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

Të ardhurat tatimore neto përbëjnë **59.7%** të të ardhurave totale neto

Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përbëjnë **40.3%** të të ardhurave totale neto.

Për vitin 2025, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 453.7 miliard lekë dhe janë realizuar 453.4 miliard lekë, me mosrealizim në vlerë prej **0.27 miliard lekë ose 0.06 % më pak.**

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

Të Ardhurat Tatimore

Për vitin 2025, të ardhurat tatimore janë programuar 282.2 miliard lekë dhe janë realizuar 280.9 miliard lekë, me një mosrealizim prej **1.3 miliard lekë ose 0.5% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, në të cilën të ardhurat u realizuan 249.8 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 31.1 miliard lekë ose 12.5 % më shumë.

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2025, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 171.4 miliard lekë dhe janë realizuar 172.5 miliard lekë, me një realizim prej 1.0 miliard lekë ose 0.6% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 155.9 miliard lekë, rezultatet janë në rritje me 16.6 miliard lekë ose 10.6 % më shumë.

Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2025 dhe faktin e vitit 2024, për periudhën Janar – Dhjetor 2025, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Për 12 mujorin 2025, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 65.9 miliard lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 68.7 miliard lekë, me një realizim në vlerë prej 2.9 miliard lekë ose 4.3% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, në të cilën u arkëtuan 59.8 miliard lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 8.9 miliard lekë ose 15% më shumë.

Rimbursimi i Tvsh-së

Për 12 mujorin 2025 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 26.7 miliard lekë dhe është realizuar në vlerën 25.3 miliard lekë me një **mosrealizim prej 1.4 miliard lekë ose 5.1% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 në të cilën janë rimbursuar 22.4 miliard lekë, rimbursimet janë me realizim 2.9 miliard lekë ose 13.1% më shumë.

Tatimi mbi Fitimin

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 60.4 miliard lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 58.7 miliard lekë, me një **mosrealizim prej 1.7 miliard lekë ose 2.8% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, në të cilën u arkëtuan 57.5 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 1.2 miliard lekë ose 2.1% më shumë.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 84.2 miliard lekë dhe është realizuar 82.7 miliard lekë, me një mosrealizim prej **1.5 miliard lekë ose 1.8% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 66.7 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 16 miliard lekë ose 23.9% më shumë.

Taksat Kombëtare dhe Tarifa

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 18.8 miliard lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 18.5 miliard lekë, me një **mosrealizim prej 0.3 miliard lekë ose 1.7% më pak.**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, në të cilën u arkëtuan 19.5 miliard lekë, mbledhja e taksave është në rënie prej **1 miliard lekë ose 5.3% më pak.**

Taksa e Qarkullimit Rrugor

Të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 23.8 miliard lekë, janë arkëtuar 24.2 miliard lekë, me një realizim në vlerë prej 0.4 miliard lekë ose 1.7% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, në të cilën u arkëtuan 21.3 miliard lekë, të ardhurat

janë realizuar me rritje prej 2.8 miliard lekë ose 13.4 % më shume.

Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12 mujore 2025

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 33.5% të të ardhurave tatimore. Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 29.4% të të ardhurave tatimore, Tatimi mbi fitimin zë 20.9 % të të ardhurave tatimore, Taksa e qarkullimit me 8.2% të të ardhurave tatimore.

Grafik 1. Struktura e të ardhurave




Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2025

E M E R T I M I		FAKTET		PLANI	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2025-2024	
		2024	2025	2025	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	405,647,901	453,377,819	453,651,000	(273,182)	-0.06%	47,729,918	11.77%
A	Te Ardhurat Tatimore	249,777,085	280,926,905	282,248,000	(1,321,096)	-0.47%	31,149,819	12.47%
1	TVSH (bruto)	82,155,813	94,017,485	92,531,000	1,486,485	1.61%	11,861,671	14.44%
	- TVSH (neto)	59,782,174	68,718,374	65,854,000	2,864,374	4.35%	8,936,201	14.95%
	- Rimbursimi i kryer	22,373,640	25,299,111	26,677,000	(1,377,889)	-5.17%	2,925,471	13.08%
2	Tatim mbi Fitimin	57,494,691	58,726,743	60,387,000	(1,660,257)	-2.75%	1,232,052	2.14%
3	Ardhura Personale	66,746,937	82,727,460	84,212,000	(1,484,540)	-1.76%	15,980,523	23.94%
4	Taksat dhe Tarifa	19,536,403	18,496,303	18,814,693	(318,390)	-1.69%	(1,040,100)	-5.32%
5	Taksa Qarkullimi	21,301,954	24,160,982	23,751,985	408,998	1.72%	2,859,028	13.42%
6	Lojrat e Fatit	2,303,120	2,574,194	2,551,322	22,872	0.90%	271,075	11.77%
7	Te tjera							
8	Denimet Administrative	238,166	223,737	0	223,737	#DIV/0!	(14,430)	-6.06%
B	Te Ardhurat Tatimore	227,403,446	255,627,794	255,571,000	56,794	0.02%	28,224,348	12.41%
C	Kontributet e	155,870,816	172,450,914	171,403,000	1,047,914	0.61%	16,580,098	10.64%
D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	383,274,261	428,078,708	426,974,000	1,104,708	0.26%	44,804,447	11.69%

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2025 sipas DRT-ve (000 lekë)

	Te ardhura Tatimore Bruto			Te ardhura Tatimore Neto			Sigurime Shoqerore		
	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%
Berat	2,099,288	2,035,000	3.16%	1,871,443	1,763,825	6.10%	3,534,083	3,480,000	1.55%
Diber	2,101,907	2,186,000	-3.85%	1,455,009	1,426,516	2.00%	3,084,752	3,050,000	1.14%
Durres	12,764,914	11,930,000	7.00%	11,154,128	10,008,364	11.45%	14,596,258	14,500,000	0.66%
Elbasan	4,425,668	4,490,000	-1.43%	4,014,090	3,851,057	4.23%	6,886,988	6,900,000	-0.19%
Fier	6,002,651	5,715,000	5.03%	5,149,446	4,938,701	4.27%	8,034,373	8,000,000	0.43%
Gjirokaster	1,818,694	1,647,000	10.42%	1,678,766	1,413,965	18.73%	2,790,398	2,700,000	3.35%
Korce	3,463,997	3,375,000	2.64%	3,154,559	2,999,126	5.18%	5,669,990	5,650,000	0.35%
Kukes	1,581,709	1,281,000	23.47%	1,460,513	1,119,089	30.51%	2,108,384	1,980,000	6.48%
Lezhe	2,323,475	2,142,000	8.47%	2,222,577	1,979,883	12.26%	3,765,562	3,700,000	1.77%
Sarande	1,883,809	1,667,000	13.01%	1,672,995	1,479,919	13.05%	2,238,185	2,100,000	6.58%
Shkoder	3,546,877	3,533,000	0.39%	3,274,834	3,268,204	0.20%	6,264,165	6,300,000	-0.57%
Tirane	105,694,341	103,284,948	2.33%	101,384,624	97,385,008	4.11%	67,950,176	67,043,000	1.35%
DTM	129,038,478	134,662,052	-4.18%	113,444,816	120,334,067	-5.73%	39,896,771	40,500,000	-1.49%
Vlore	4,181,097	4,300,000	-2.77%	3,689,994	3,603,276	2.41%	5,630,830	5,500,000	2.38%
Total	280,926,905	282,248,000	-0.47%	255,627,794	255,571,000	0.02%	172,450,914	171,403,000	0.61%

Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 lekë)

	Fakti TVSH		Plan TVSH		Ndryshimi %	
	neto	bruto	neto	bruto	neto	bruto
Berat	529,078	756,923	508,825	780,000	3.98%	-2.96%
Diber	89,531	736,429	(29,484)	730,000	-403.66%	0.88%
Durres	3,392,555	5,003,341	2,878,364	4,800,000	17.86%	4.24%
Elbasan	1,201,457	1,613,035	1,061,057	1,700,000	13.23%	-5.12%
Fier	1,781,403	2,634,608	1,773,701	2,550,000	0.43%	3.32%
Gjirokaster	564,128	704,055	366,965	600,000	53.73%	17.34%
Korce	999,893	1,309,331	924,126	1,300,000	8.20%	0.72%
Kukes	544,408	665,604	308,089	470,000	76.70%	41.62%
Lezhe	721,228	822,126	637,883	800,000	13.07%	2.77%
Sarande	562,207	773,021	512,919	700,000	9.61%	10.43%
Shkoder	908,923	1,180,967	885,204	1,150,000	2.68%	2.69%
Tirane	26,288,307	30,598,024	22,540,060	28,440,000	16.63%	7.59%
DTM	30,045,902	45,639,565	32,483,015	46,811,000	-7.50%	-2.50%
Vlore	1,089,355	1,580,457	1,003,276	1,700,000	8.58%	-7.03%
Totali	68,718,374	94,017,485	65,854,000	92,531,000	4.35%	1.61%

Tabela 4. Të ardhura nga Tatimi mbi Fitimin (000 lekë)

Tatimi mbi fitimin			
	Fakt	Plan	%
Berat	365,277	390,000	-6.34%
Diber	433,370	520,000	-16.66%
Durres	2,971,074	3,100,000	-4.16%
Elbasan	752,097	920,000	-18.25%
Fier	1,066,932	1,200,000	-11.09%
Gjirokaster	294,800	275,000	7.20%
Korce	547,566	640,000	-14.44%
Kukes	297,234	260,000	14.32%
Lezhe	458,374	470,000	-2.47%
Sarande	385,454	510,000	-24.42%
Shkoder	653,640	750,000	-12.85%
Tirane	13,520,489	13,000,000	4.00%
DTM	36,144,837	37,312,000	-3.13%
Vlore	835,598	1,040,000	-19.65%
Totali	58,726,743	60,387,000	-2.75%

Tabela 5. Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	929,509	825,000	12.67%
Diber	834,835	855,000	-2.36%
Durres	4,659,047	3,900,000	19.46%
Elbasan	2,001,234	1,820,000	9.96%
Fier	2,228,150	1,920,000	16.05%
Gjirokaster	790,971	750,000	5.46%
Korce	1,519,848	1,400,000	8.56%
Kukes	605,479	540,000	12.13%
Lezhe	1,010,419	840,000	20.29%
Sarande	703,978	445,000	58.20%
Shkoder	1,676,251	1,600,000	4.77%
Tirane	29,187,579	28,900,000	1.00%
DTM	34,874,660	38,897,000	-10.34%
Vlore	1,705,499	1,520,000	12.20%
Totali	82,727,460	84,212,000	-1.76%

Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zerave (000 lekë)

		FAKT	FAKT	Diferenca 2025-2024	
		2024	2025	+ ose -	Perqindje
	Tatimi mbi te ardhurat personale	66,746,937	82,727,460	15,980,523	23.9%
1	Tatimi mbi page nga listepagesa	40,175,924	49,382,907	9,206,983	22.9%
1,1	Nga te punesuarit e Sektorit Publik	15,608,380	18,390,705	2,782,325	17.8%
1,2	Nga te punesuarit e Sektorit Privat	24,567,544	30,992,202	6,424,658	26.2%
2	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	3,391,086	3,828,077	436,991	12.9%
3	Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate	5,347,609	5,802,419	454,810	8.5%
4	Tatim mbi Fituesit e Lodrave te Fatit	110,797	84,942	(25,855)	-23.3%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro	1,994	1,719	(276)	-13.8%
6	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	3,803,068	2,292,954	(1,510,113)	-39.7%
7	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe	5,774,686	6,115,348	340,662	5.9%
8	Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesise	357,535	114,512	(243,023)	-68.0%
9	Tatimi mbi Deklaraten Individuale Vjetore te te	1,781,733	2,197,024	415,291	23.3%
10	Tatim, shitja e pasurise se paluajtshme	5,534,659	7,529,436	1,994,776	36.0%
11	Tatim, trashegimia dhe dhurimi	35,789	16,250	(19,540)	-54.6%
12	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat te tjera	0	319,764	319,764	#DIV/0!
13	Tatim mbi te Ardhurat nga Honorare	0	500,310	500,310	#DIV/0!

14	Tatim mbi te Ardhurat per pjesmarrjene borde	0	296,384	296,384	#DIV/0!
15	Tatim mbi te Ardhurat per Prime sigurimi	0	31,925	31,925	#DIV/0!
16	Tatim mbi te Ardhurat per performancen e	0	230,835	230,835	#DIV/0!
17	Tatim mbi te Ardhurat per sherbime teknike	0	822,092	822,092	#DIV/0!
18	Tatim mbi te Ardhurat per	0	38,184	38,184	#DIV/0!
19	Tatim mbi te ardhurat personale Biznesore	432,058	3,122,379	2,690,321	622.7%

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 lekë)

	Fakt	Plan	%
Berat	43,947	40,000	9.87%
Diber	92,591	81,000	14.31%
Durres	98,915	130,000	-23.91%
Elbasan	49,311	50,000	-1.38%
Fier	60,483	45,000	34.41%
Gjirokaster	21,133	22,000	-3.94%
Korce	36,277	35,000	3.65%
Kukes	10,881	11,000	-1.08%
Lezhe	28,294	32,000	-11.58%
Sarande	14,855	12,000	23.79%
Shkoder	26,142	33,000	-20.78%
Tirane	7,221,452	8,300,000	-12.99%
DTM	10,753,507	9,983,693	7.71%
Vlore	38,515	40,000	-3.71%
Totali	18,496,303	18,814,693	-1.69%

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)

Struk.	Lloji i te Ardhurave	FAKTET		Diferenca FAKT 25-24	
		2024	2025	+ ose -	Peraindie
A=B+C	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	19,536,403	18,496,303	(1,040,100)	-5.32%
B	Tarifa Kombetare	706,040	726,453	20,413	2.9%
C	Taksa Kombetare	18,830,363	17,769,850	(1,060,513)	-5.6%
1	8.Tarife sherbimi per Qarkullimin e Automjeteve	74,774	81,934	7,160	9.6%
2	12.Tarife per rregjistrimin e Lojrave te Fatit ,	154,251	168,034	13,783	8.9%
3	5. Tarife sherbimi per licensat radiotelevizive	19,739	12,606	(7,133)	-36.1%
4	2. Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve	1,326,126	1,335,140	9,014	0.7%
5	6. Tarife sherbimi per sherbimet e	460,447	511,469	51,022	11.1%
6	Takse nacionale per lejen e ushtrimit te	19,908	21,245	1,337	6.7%
7	Takse nacionale e karbonit per benzinen, benzolin	2,943,622	2,975,372	31,750	1.1%
8	Takse nacionale per ambalazhet plastike te	2,345,182	2,569,944	224,762	9.6%
9	Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit	980	1,094	114	11.6%

10	Taksë mbi Primet e shkruara	2,019,977	2,210,485	190,508	9.4%
11	Taksa per regjistrim fillestar per automjete	236,208	243,308	7,100	3.0%
12	Taksa e pervitshme per automjetet luksoze	328,398	359,578	31,181	9.5%
13	Takse per automjetet e perdorura te transportit	6,491,200	7,108,893	617,693	9.5%
14	9.Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me avion	498,793	529,212	30,419	6.1%
15	Taksa portuale	920	513	(407)	-44.3%
16	Taksa e Akteve dhe e Pulles	64,202	61,219	(2,983)	-4.6%
17	Taksa e rentes minerare	1,108,300	991,487	(116,813)	-10.5%
18	3 .Tarife per Sherbimet Konsullore	216,887	219,786	2,899	1.3%
19	1.Tarife Per paisjen me Dëshmi Aftësie per	296,304	256,785	(39,518)	-13.3%
20	13. Tarife per Regjitrin ne arsimin e Larte	219	160	(59)	-26.9%
21	7. Tarifa per pasaporte lundrimi te personave	1,415	1,145	(270)	-19.1%
22	4. Tarifa per aktet administrative	453,830	461,001	7,171	1.6%
23	Taksa e rentes per Hidrokarbure	113	84	(29)	-25.8%
24	Taksa e Qumështit Pluhur	219,301	28,605	(190,696)	-87.0%
25	Taksa e pijeve te Homogjenizuara	12,156	2,610	(9,545)	-78.5%
26	Taksa e Hirrës së Qumështit	52,789	10,429	(42,360)	-80.2%
27	Taksa e Krem Qumështit	37,573	8,718	(28,855)	-76.8%
28	Taksa e lëndës djegëse e përdorur si karburant për	2,947,622	1,172,924	(1,774,699)	-60.2%
29	Tarife , gjoba, interesa	1,812	1,572	(240)	-13.2%
30	Taksa te tjera , gjoba, interesa	1,914	3,344	1,430	74.7%
31	Taksa e qarkullimit	21,301,95	24,160,98	2,859,028	13.4%

Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke)

	2024	2025	Plan 2025	Fakt vs Plan	%
Berat					
Diber					
Durres					
Elbasan					
Fier					
Gjirokaster					
Korce					
Kukes					
Lezhe					
Sarande					
Shkoder					
Tirane	21,301,954	24,160,982	23,751,985	408,998	1.72%
DTM					
Vlore					
Totali	21,301,954	24,160,982	23,751,985	408,998	1.72%

Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore

	2024	2025	Plan 2025	Fakt vs Plan	%
Berat	3,157,712	3,534,083	3,480,000	54,083	1.55%
Diber	2,817,837	3,084,752	3,050,000	34,752	1.14%
Durres	13,140,060	14,596,258	14,500,000	96,258	0.66%
Elbasan	6,275,320	6,886,988	6,900,000	(13,012)	-0.19%
Fier	7,288,045	8,034,373	8,000,000	34,373	0.43%
Gjirokaster	2,486,351	2,790,398	2,700,000	90,398	3.35%
Korce	5,129,595	5,669,954	5,650,000	19,954	0.35%
Kukes	1,838,866	2,108,384	1,980,000	128,384	6.48%
Lezhe	3,374,412	3,765,562	3,700,000	65,562	1.77%
Sarande	1,928,168	2,238,185	2,100,000	138,185	6.58%
Shkoder	5,706,179	6,264,165	6,300,000	(35,835)	-0.57%
Tirane	61,132,650	67,950,212	67,043,000	907,212	1.35%
DTM	36,592,740	39,896,771	40,500,000	(603,229)	-1.49%
Vlore	5,002,881	5,630,830	5,500,000	130,830	2.38%
Totali	155,870,816	172,450,914	171,403,000	1,047,914	0.61%

Në kuadër të përmirësimit të parashikimeve të flukseve monetare të qeverisjes së përgjithshme, për një menaxhim më efektivitet dhe me kosto të ulët të mjeteve monetare të qeverise, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, Sektori i Statistikës dhe Analizës, pranë DPT është pjesë e grupit të punës me Ministrinë e Financave (shkresa MF nr.9968/1 Prot, dt.17.07.2024, protokolluar me tonën nr.12988 Prot, dt.18.07.2024).

Në vitin 2025 ka dërguar informacion mbi fluksin ditor të të ardhurave tatimore për çdo ditë të vitit 2025.

Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës

Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës monitoron funksionimin e sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës me bankat e nivelit të dytë për përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesa dhe përmirësimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore.



Sektori i Kontabiliteti dhe Pagesës në përputhje me Objektivin e Planit Strategjik “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”— duke ofruar shërbime cilësore dhe duke ndikuar në reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore “ka mundësuar arritjen e rezultateve si më poshtë”.

1. Raportimin në kohë sa më të shpejtë i pagesave të arkëtuara në buxhetin e shtetit pranë Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës si dhe strukturave drejtuese në DPT.
2. Identifikimi i pagesave pezull dhe sistemimi i tyre në llogarinë e duhur të tatimpaguesit.

Gjatë vitit 2025, ky sektor ka ndjekur, përgatitur dhe raportuar në kohë dhe me saktësi informacionin mbi pagesat e kryera në bankat e nivelit të dytë dhe në thesar lidhur me të ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Puna e kësaj drejtorie gjatë vitit 2025 është fokusuar në:

- Marrjen dhe Krahësimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.

- Komunikimin me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në funksion të mbarëvajtjes së punës dhe saktësisë së informacionit. Numri i komunikimeve elektronike për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë vitit 2025 ka qenë 70 komunikime për mosrakordimin e raporteve të pagesave në Drejtorinë e Informacionit DPT pranë AKSH-it.
- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes mes Ministrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 1608 raste për vitin 2025. Më poshtë paraqiten me grafik sipas muajve dhe sipas bankave.



Përgatitjen e raporteve ditore, mujore dhe progresive të të ardhurave tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për çdo drejtori rajonale tatimore pas rakordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënja e këtyre raporteve në dispozicion të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës dhe strukturave drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Gjatë vitit 2025

janë kryer 43 komunikime elektronike me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit për problematika të ndryshme.

- Komunikimin e vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt- Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga administrata tatimore apo të ndonjë problemi të lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshje me bankat e nivelit të dytë.

- Për vitin 2025 pagesat me e-banking janë në numër 583 203 veprime dhe në vlerë 139.2 miliard lekë.

Drejtoria e Kontabilitetit dhe Riskut në organigramën e DPT-së drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë dhe është e organizuar në 2 sektorë:

- Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesave me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialistë
- Sektori i Analizës dhe Statistikës me 1 Përgjegjës dhe 4 Specialistë


Për vitin 2025, DKS ka kryer detyrat funksionale me kapacitet jo të plotë të burimeve njërezore, me 3 vende vakante (specialistë).

III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE

Gjatë vitit 2025, puna e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, është përqendruar në konsolidimin, rritjen e nivelit dhe lehtësimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve. Kjo është arritur duke ndjekur realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara, në Planin Operacional të DPT të vitit 2025, detyrave të ngarkuara në funksion të reformave të DPT-së, si dhe ndjekjen e realizimin e procedurave të përcaktuara në Manualin e Shërbimit ndaj tatimpaguesve.

Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesit është përgjegjëse, për sigurimin e ofrimit të shërbimit cilësor dhe asistencës për të gjithë tatimpaguesit kryesisht nëpërmjet shërbimit dhe komunikimit elektronik (e-albania, e-filing, telefonatave, faqes zyrtare etj) si dhe kontaktet e vazhdueshme me tatimpaguesin nëpërmjet sistemit Call Center, me qëllim përmbushjen vullnetare të detyrimeve ligjore për pagesën e tatimeve.

Funksioni i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, udhëhequr nga 1 (një) drejtor drejtorie, është realizuar nëpërmjet veprimtarisë së dy sektorëve të saj: - Sektorit të Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesit 3 punonjës (1+2) - dhe Sektorit të Thirrjeve 13 (1+12) punonjës.



I- Puna e kryer nga Sektori i Asistencës dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve.

1.Standartizimi i funksionit të shërbimit ndaj tatimpaguesve

Sektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit, është pjesë e Drejtorisë së Shërbimit për tatimpaguesit në DPT, dhe si pjesë e rëndësishme e komponentit të shërbimit ndaj tatimpaguesve, për vitin 2025 ka garantuar përmbushjen e funksionit të shërbimit në DPT dhe në DRT, duke orientuar DRT për përmirësimin e shërbimit me mënyra elektronike dhe duke shërbyer sipas rastit për tatimpaguesit edhe në sportele. Rëndësi e veçantë i është dhënë identifikimit të problemeve por dhe përgjigjeve të unifikuara nëpërmjet komunikimit me Tp në e-filing, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare të DPT.

Një vlerësim i veçantë i është dhënë edhe fokusit në zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve për përmbushjen vullnetare të detyrimeve nga ana e tatimpaguesit, bazuar Planit Operacional 2025 të DPT, të orientuar tek tatimpaguesi, me qëllim përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen tatimpaguesve, për reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore, si dhe objektivave të përcaktuara në funksion të reformave të ndërmarra nga DPT.

Objektivat e këtij Sektori për vitin 2025 ishin:

- Rritja e nivelit të asistences, informimit dhe ndërgjegjësimit të tatimpaguesve nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit në funksion të përmbushjes vullnetare së detyrimeve të tyre tatimore.
- Përmirësimin e shërbimeve të ofruara online nëpërmjet portalit e-albania, me synim shtimin e disa shërbimeve online për Tatimpaguesit.
- Hartimin e një strategjie shërbimi në bashkëpunim me STA/Projektin Suedes, e cila të jetë gjithëpërfshirëse, duke i dhënë prioritet komunikimit interaktiv dhe zgjidhjes së kërkesave të tatimpaguesit.

Drejtoria e Shërbimit në DPT për mirëfunksionimin e gjithë aktivitetit të Shërbimit gjatë vitit 2025 ka komunikuar dhe ka pritur vazhdimisht çdo ditë problemet e konstatuara për zgjidhje, të

dërguara nga DRT në rrethe, dhe ka ndërmjetësuar zgjidhjen e tyre nga Pala mirëmbajtëse e sistemit.

Po ashtu ajo ka ndihmuar dhe ndikuar në ruajtjen e standarteve të shërbimeve aktuale apo përmirësimin e tyre bazuar kërkesave të tatimpaguesve.

Baza e arritjeve dhe puna konkrete e shërbimit ofrohet përgjithësisht nga DRT në rrethe, ndërsa DSHT në DPT kujdeset për rregullat dhe standartizimet e veprimeve që kryejnë ato.

Nëpërmjet evidencave të standartizuara nga DSHT në DPT, sektori i shërbimit në DRT-të përkatëse çdo muaj raporton punën e bërë nga ana e tyre në sportele, nëpërmjet ofrimit të shërbimit dhe përgjigjeve për pyetjet dhe problemet që vijnë nga e-filing dhe komunikimeve voluminoze nëpërmjet adresave elektronike të tatimpaguesve.

Për përmbushjen e funksionit të shërbimit dhe forcimin e tij, DSHT në DPT bashkëpunon ngushtë dhe vazhdimisht me drejtori të tjera në DPT, si Drejtorinë e Riskut, Drejtorinë e Proceseve të Biznesit, Drejtorinë e Kontrollit, Drejtorinë e Informacionit etj, dhe diskuton vazhdimisht me ta, idetë për përmirësimin e komponentit të shërbimit.

Bazuar rëndësisë që ka rritja e nivelit të shërbimit, fokusi është drejtuar dhe përqëndruar tek tatimpaguesi, pra si të jemi më pranë tij, si t'i shërbejmë më mirë dhe si të zgjidhim kërkesat e tij, duke i dhënë prioritet zhvillimit të teknologjisë në shërbimet dixhitale online.

Pjesë e këtij fokusi gjatë 2025 është pasqyruar dhe në Përmirësimin e Komponentit të Shërbimit të tatimpaguesve, nëpërmjet asistencës dhe ndihmën e Projektit Suedes, ku diskutimet janë përqëndruar në;

- komunikimin me tatimpaguesit nëpërmjet gjuhës së thjeshtë dhe të kuptueshme,
- Në përmirësimin e përmbushjes vullnetare të ligjit nga tatimpaguesit, duke hartuar për herë të parë një Strategji Shërbimi për tatimpaguesin për një periudhë 3 vjeçare zbatimi.
- Në kryerjen e Anketës me bizneset dhe qytetarët për të matur nivelin e shërbimit dhe të besimit ndaj AT por dhe për të identifikuar kërkesat dhe problemet që kanë tatimpaguesit.
- Përmirësimin dhe modernizimin e shërbimit nëpërmjet Qendrës së thirrjeve.

Për të gjitha këto drejtime dhe prioritete ka patur ecuri dhe rezultate konkrete të cilat do të shërbejnë për të rritur nivelin e shërbimit për 3 vitet në vazhdim.

Konkretisht, gjatë vitit 2025 është arritur që:

- Kanali i komunikimit me tatimpaguesit dhe qytetarët, nëpërmjet rrjeteve sociale të funksionojë rregullisht dhe të japë informacion e qartësi për shumë ligje, udhëzime, veprimtari të ndryshme por dhe rezultate të arritura, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e besimit ndaj AT.
- Shumë sqarime dhe komunikime janë bërë në faqen zyrtare të DPT, që kanë ndihmuar tatimpaguesit dhe qytetarët për përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, dhe duke e vlerësuar komponentin e shërbimit me rëndësi të veçantë për sukseset e AT, u arrit që të hartohet dhe miratohet për herë të parë Strategjia e Shërbimit për Tatimpaguesit, e cila do ti shërbejë dhe orientojë drejtimet kryesore të punës për një periudhë 3 vjeçare.
- U realizua Anketa e dytë më bizneset dhe qytetarët, me ndihmë të Projektit Suedes/STA, ku u konstatua jo vetëm gjendja reale e punës dhe shërbimeve që ofron AT, por dhe u identifikuan disa kërkesa dhe probleme për zgjidhje të cilat do të rritin besimin tek institucioni Tatimor/DPT.
- Po ashtu gjatë këtij viti u bë e mundur që të hartohen të gjitha kërkesat dhe nevojat për përmirësimin dhe modernizimin e shërbimit që duhet të ofrojë Qendra e Thirrjeve, si një shërbim i rëndësishëm bashkëkohor që do të ndihmojë dhe sqarojë tatimpaguesit në kohë reale.

2- Ofrimi i Shërbimve cilësore për tatimpaguesit, si detyrë e përhershme e AT.

Aktualisht nëpërmjet platformës Qeveritare E-Albania ofrohen ndaj tatimpaguesve 31 Shërbime online. Ndër këto 14 janë shërbime të mirëfillta si vërtetime dhe aplikime e dokumenta për tatimpaguesit dhe individët.

Përshkrimi i vërtetimeve të lëshuara nga funksioni i shërbimit dhe online nëpërmjet portalit e-albania

Vërtetime të miratuara/lëshuara nga sportelet e shërbimit 2025

Vërtetime për individë që nuk kanë aktivitet privat, (aplikimi bëhet në e-albania dhe miratimi i tyre dhe dërgimi në portalin e-albania bëhet nga DRT përkatëse) etj.	68,313
Ndryshimi i Passwordit dhe dërgimi në adresën personale (Reset Password)	1,694

Kërkesa të refuzuara mbas verifikimeve të aplikimeve të ardhura nga e-albania	4,354
Totali	74,361

Theksojmë se Vërtetimet për individë të paregjistruar, aplikimi bëhet në e-albania, dhe ky aplikim dërgohet në DRT përkatëse për trajtim, duke u hapur një çështje e cila pasi menaxhohet e verifikohet, pastaj bëhet miratimi ose refuzimi i saj, mbyllet si çështje dhe dërgohet në e-albania. Për vitin 2025 janë hapur 68,313 çështje për vërtetime të ardhura nga e-albania, kërkesa për individë të paregjistruar. (refuzuar 4,354)

Bazuar funksionimit normal të lëshimit të vërtetimeve në mënyrë elektronike, në DRT përkatëse janë të pa përfillshme rastet kur lëshohen vërtetime në mënyrë manuale dhe kjo vetëm në rastet kur shfaqja e detyrimeve të paguara në portalin e-albania vonon për më shumë se 1 ditë.

Vërtetime të lëshuara online nga portali e-Albania 2025

Nr	Emërtimi i shërbimit	Janar - Dhjetor 2025
1	Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin	1,979,078
2	Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti	158,747
3	Vërtetim për përgjegjësitë tatimore	38,539
4	Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit (verifikime nga punëmarresi)	0
5	Vërtetim për regjistrim të investitorit	494
6	Vërtetim për pagim detyrimesh	283,449
7	Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)	65,530
8	Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit	188,795
9	Vërtetim për posedim mjeti	3,594
10	Vërtetim për individ të paregjistruar	66,154
11	Tatim mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël	0
12	Tatim fitimi	0
13	Tatim i mbajtur në burim	0
14	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0
15	Tatim mbi vlerën e shtuar	0
16	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	0

17	Tarifat kombëtare	0
18	Tatim mbi të ardhurat nga punësimi	0
19	Taksat kombëtare	0
20	Renta minerare	0
21	Tatim mbi të ardhurat personale	0
22	Detyrime globale	0
23	Tatim i lojrave të fatit	0
24	Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (eSig25)	46,861
25	Certifikatë Rezidence Tatimore (biznes)	3,105
26	Vërtetim për aktivitet ekonomik të hapur	0
27	Rivendosje fjalëkalimi për tatimpagues të regjistruar	0
28	Aplikim për certifikatë rezidence për individët	379
29	Kërkesë për regjistrimin e një subjekti tatimpagues	8,581
30	Njoftim i ndryshimeve në regjistrim	10,088
31	Vërtetim page	1,291,323
	Total	4,144,717

Nga të dhënat rezulton se në vitin 2025, portali e-albania u është përgjigjur tatimpaguesve dhe qytetarëve për **4,144,717 raste** (vërtetime, konfirmime situatash, aplikime për ndryshim të dhënash etj). Ndikimin më të madh në numrin e vërtetimeve të lëshuara online për vitin 2025 e ka –Vërtetimi për pagimin e kontributeve për individin që që zë rreth 47,7% të totalit, ka arritur në shifrën 1,979,078 vërtetime, nga **1,793,315** vërtetimeve për 2024, (me një rritje prej 10% më shumë për vitin 2025), të cilat kanë përmbushur më së miri dhe kërkesat e punëmarrësve individë.

Rezulton së për vitin 2025, nga të dhënat që administrojmë, nga tatimpaguesit nuk është përdorur pagesa e detyrimeve tatimore nëpërmjet portalit e-albania, ndërsa shërbimet bazë që lëshojnë vërtetime për tatimpaguesit dhe individët kanë funksionuar normalisht.

Gjatë vitit 2025 duke marrë parasysh nevojat e tatimpaguesve dhe individëve, nga DSHT por dhe nga Drejtori të tjera në DPT, janë bërë kërkesa dhe specifikimet për zhvillime në shtimin e disa shërbimeve dixhitale që do të aplikohen nëpërmjet portalit e-albania, ku me kryesoret janë:

- Konfirmimi i pasqyrave financiare të dorëzuara në AT,
- Konfirmimi/njehsimi i deklaratës vjetore të të ardhurave individuale/DIVA,
- Kërkesa për zhbllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesit,
- Vërtetim për pagesën e tatimit në burim,
- Vërtetim për të ardhurat nga punësimi,
- Informacion mbi historikun e punësimit të punonjësit,
- Kërkesa për sistemimin/kompensimin e detyrimeve tatimore,
- Lëshimi i Çertifikatës së rezidencës për individët,

Një pjesë e tyre janë në testim dhe do të publikohen si shërbime dixhitale në fillim të vitit 2026.

3- Informimi, sqarimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve:

Përveç vërtetimeve që janë lëshuar në mënyrë dixhitale, në funksion të shërbimit ndaj tatimpaguesit, gjatë vitit 2025, nga DRT përkatëse janë kryer shumë shërbime dhe asistencë të natyrave të ndryshme që kanë përmbushur gjithë aktivitetin e komponentit të shërbimit të AT, konkretisht:

- gjatë vitit 2025 ka disa tregues performance të konsoliduar të cilët raportohen sipas Planit Strategjik të DPT, që rezultojnë si më poshtë:

Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	109,609
Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	196
Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara	3,346
Numri i seminareve edukues të realizuar	127
Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)	91,902

Pra, rezulton se gjatë vitit 2025, sportelet e Shërbimit në DRT kanë pritur rreth 91,902 vizitorë, të cilët janë tatimpagues apo individë, që ju është ofruar shërbim dhe asistencë në lidhje me kërkesat e tyre për informacion, kryesisht për sqarimet dhe ndryshimet në Legjislacionin Tatimor që

ndodhën në vitin 2024-2025, për kuptimin e përgjegjësive tatimore, pagesen e detyrimeve tatimore, deklaramit elektronik, pajisjes me vërtetime nëpërmjet portalit e-albania etj.

Gjatë punës së kryer jo vetëm që janë sqaruar në mënyrë interaktive shumë tatimpagues për vitin 2025, por dhe janë dërguar shumë njoftime në adresat elektronike të tatimpaguesve për rreth 109,609 tatimpagues, këto në disa raste të ideuara nga DPT për fushata të ndryshme, për të nxitur përmbushjen vullnetare të ligjit, pasi jo çdo tatimpagues njoftohet nga Qendra e thirrjeve.

Bazuar shqetësimeve dhe pyetjeve që kanë ardhur nga tatimpaguesit, për disa lloj tatimesh (si tatimi korporativ, tatimi në burim, tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi, tatimi mbi individin DIVA etj.) shërbimi në DPT, në bashkëpunim me Drejtorinë Teknike dhe Ligjore, Drejtorinë e Informacionit, dhe Drejtorinë e Proceseve të Biznesit, hartuan përgjigjet standarte të zbatimit në praktikë të këtyre ligjeve dhe i publikuan ato në faqen zyrtare të DPT-së.

Gjatë vitit gjithashtu janë bërë edhe njoftime të herëpashershme në faqen Web dhe rrjete sociale duke demonstruar me video udhëzuesit për zbatimin e ligjit në kushte konkrete. Po ashtu janë bërë dhe shumë kujtesa/pop up në adresën personale e-filing në kontaktin direkt me tatimpaguesin.

-Janë pritur nga e-filing dhe hapur si çështje rreth 85,141 pyetje të përgjithshme të cilat kanë informuar dhe sqaruar Tatimpaguesit për ligjin dhe ndryshimet përkatëse të tij apo zbatimin në kushtet konkrete, ku një pjesë e tyre kanë qënë kërkesat për sqarime lidhur me zhbllokimin e llogarive bankare, apo të kërkesave për sistemimin e detyrimeve në llogarinë personale të Tatimpaguesve.

Por pavarësisht punës së bërë gjatë vitit 2025, bazuar sa është konstatuar dhe evidentuar nga anketa e dytë e kryer nga Projekti Suedes në maj 2025, ku rezulton se niveli shërbimit ndaj tatimpaguesit ka arritje dhe tregues pozitivë, sidomos në shërbimet dixhitale që ofrohen në mënyrë elektronike nga Administrata tatimore dhe komunikimin interaktiv, ka disa probleme që duhet të monitorohen dhe zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e besimit të tatimpaguesve dhe publikut ndaj AT.

Konkretisht, për;

- *Thjeshtimi i faqes zyrtare dhe përshtatja e saj me kerkesat që ka tatimpaguesi dhe qytetarët.*
- *Rritja e cilësisë së përgjigjeve dhe shërbimit që kërkojnë tatimpaguesit*
- *Trajtimi në mënyrë të barabartë i tatimpaguesve*
- *Lehtësimi i disa proceseve të punës nga disa funksione dhe departamente të AT, si kontrolli, mbledhja e detyrimeve, shqyrtimi i çështjeve të çregjistrimit, publikimi i vendimeve teknike etj*
- *Ulja e informalitetit dhe korrupsionit të brendshëm të perceptuar nga tatimpaguesit dhe qytetarët.*

II. Sektori i Thirrjeve (Call Centër)

Sektori i Thirrjeve është pjesë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Administratës Tatimore Qendrore, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 69, datë 26.05.2023 “Për miratimin e struktures organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore.

Sektori i Thirrjeve iu ofron tatimpaguesve informacion dhe asistencë tatimore përmes numrit pa pagesë 0800 000 2, duke garantuar informacion të saktë mbi zbatimin e legjislacionit tatimor, proceset e deklarimit dhe afatet e shlyerjes së detyrimeve tatimore.

Sektori i Thirrjeve realizon komunikimin përmes programit ViciDial, duke informuar dhe orientuar tatimpaguesit për zbatimin e legjislacionit tatimor, vetëdeklarimin dhe përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Komunikimi ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve synon harmonizimin e masave organizative dhe edukuese, duke garantuar informim të shpejtë dhe efektiv, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për përmbushjen korrekte të detyrimeve tatimore.

Aktivitetet të realizuara gjatë vitit 2025

Sektori i Thirrjeve e organizon metodologjinë e punës përmes programit ViciDial, e strukturuar në dy kategori kryesore:

- Thirrjet hyrëse, ku tatimpaguesit kontaktojnë administratën tatimore në numrin pa pagesë 0 800 000 2.
- Thirrjet dalëse, ku specialistët e Sektorit të Thirrjeve kontaktojnë tatimpaguesit për informim dhe ndërgjegjësim për përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore.

Për vitin 2025, aktiviteti i Sektorit të Thirrjeve ka përfshirë realizimin e **90,217** thirrjeve dalëse dhe **25,201** thirrjeve hyrëse, duke reflektuar kështu edhe vazhdimësinë e komunikimit me tatimpaguesit në funksion të informimit dhe përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore.

Gjatë vitit 2025, specialistët e thirrjeve dalëse kanë realizuar komunikime me tatimpaguesit lidhur me tematika të ndryshme, duke bashkëpunuar me drejtoritë në DPT, si Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Sektori i Asistencës dhe i Shërbimit të Tatimpaguesve etj.

Në mënyrë të përmbledhur thirrjet dalëse të relizuara sipas fushatave të ndryshme janë:

- Komunikimeve me tatimpaguesit debitore, të Tvsh-së, Sigurime shoqërore dhe Diva.
- Komunikim me subjekte për kthimin e pagesave të kësteve të tatimit mbi fitimin.
- Komunikim me subjekte të përcaktura me risk që kanë aktivitet me qarkullim të ulët.
- Komunikimi për informimin e tatimpaguesve që regjistrohen për herë të parë në Administratën Tatimore, lidhur me detyrimet ligjore për deklarimin dhe pagesën e tatimeve etj....

Zhvillime gjatë vitit 2025 dhe prioritetet

Sektori i Thirrjeve e organizon aktivitetin e tij përmes një strukture funksionale të përbërë nga 3 specialistë që mbulojnë thirrjet hyrëse dhe 8 specialistë që mbulojnë thirrjet dalëse, duke siguruar vijueshmërinë dhe efikasitetin e komunikimit me tatimpaguesit.

Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të shërbimit të tatimpaguesve dhe si rezultat i bashkëpunimit me administratën tatimore suedeze, është evidentuar nevoja për implementimin e një sistemi të ri të menaxhimit të thirrjeve. Ky sistem i ri, i planifikuar të vihet në funksion gjatë vitit 2026, do të mundësojë:

- Rritjen e kapacitetit për trajtimin e thirrjeve hyrëse.
- Kategorizimin e thirrjeve hyrëse sipas tematikave, p.sh si procedura tatimore, shërbime e deklarime elektronike në e-Filing dhe e-Albania, tatimi mbi të ardhurat dhe DIVA, si dhe fusha të tjera respektive.
- Gjatë vitit 2025 është vazhduar puna për përdorimin e një “gjuhe të thjeshtë” që komunikimi të jetë më i lehtë për t’u kuptuar.

Në vijim të zhvillimeve të mësipërme, prioritetet kryesore të Sektorit të Thirrjeve janë:

- Vendosja në funksion e sistemit të ri të menaxhimit të thirrjeve, si një element kyç për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit të tatimpaguesve,
- Informimi sa më i gjerë i tatimpaguesve mbi ndryshimet e realizuara në Sektorin e Thirrjeve dhe përfitimet që sjell sistemi i ri,
- Trajnimi i vazhdueshëm i specialistëve të Sektorit të Thirrjeve, me fokus në ndryshimet ligjore, procedurat tatimore dhe përdorimin e sistemeve të reja dixhitale,
- Standardizimi i përgjigjeve dhe krijimi i një baze të unifikuar informacioni për tatimpaguesit,
- Rritja e ndërgjegjësimit të tatimpaguesve mbi rëndësinë e vetëdeklarimit dhe përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

1. HYRJE

Objekti kryesor i punës së Drejtorisë Teknike dhe Ligjore siç është përcaktuar edhe në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore është garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që del nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Detyrat kryesore të Drejtorisë Teknike dhe Ligjore janë:

- ☐ Bashkëpunimi dhe koordinimi me drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me DRT, i procesit për evidentimin dhe nevojën për ndryshime ligjore, si dhe hartimi e dërgimi i propozimeve përkatëse në Ministrinë e Financave.
- ☐ Përgatitja dhe bashkërendimi në formulimin e projekt-vendimeve, urdhrave apo qarkoreve për probleme teknike dhe ligjore të zbatimit të legjislacionit tatimor për t'u miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ☐ Bashkëpunimi në hartimin e projekt-planeve strategjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- ☐ Bashkërendimi i punës dhe ndjekja e të gjitha proceseve gjyqësore ku administrata tatimore është palë si dhe asistimi me ndihmë juridike i Drejtorive Rajonale në pjesëmarrjen e tyre në proceset gjyqësore;
- ☐ Kthimi i përgjigjeve për të gjitha rastet kur kërkohet interpretim ligjor, vetëm ose në bashkëpunim me struktura të tjera të autorizuara;
- ☐ Interpretim e procedurave tatimore, TVSH, dhe ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat. Angazhimi në dhënie mendimi ligjor dhe teknik për çdo projekt ligj, draft-marrëveshje, apo çështje të tjera të karakterit ligjor/teknik;
- ☐ Zbatimi i çdo detyre tjetër, që i ngarkohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në kuadër të realizimit të detyrave të mësipërme, DTL ka synuar t'i përmbahet vizionit për ofrimin e një Administrate Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të tatimpaguesve, për të garantuar një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve në zbatim të legjislacionit tatimor.

1.2 Organizimi i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore

Drejtoria Teknike dhe Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas strukturës organizative është e organizuar si vijon:

- ☐ Sektori Ligjor
- ☐ Sektori Teknik

2. OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR VITIN 2025

2.1 Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare

- ☐ Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore;
- ☐ Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm;

2.2 Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri

- ☐ Trajtimi në kohë i çdo njoftimi, sinjali apo propozimi që lidhet me aktivitetin e AT;

2.3 Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njehësuese

- ☐ Dhënia e opinioneve për çdo ndryshim ligjor që do të propozohet lidhur me legjislacionin tatimor. Hartimi i propozimeve për ndryshime ligjore të iniciuara nga AT;
- ☐ Hartimi i komentareve përmbledhës të vendimeve teknike, të grupuara sipas natyrës së tyre.

- ☐ Përcjellja periodikisht për publikim i opinioneve që japin qëndrime për zbatimin e legjislacionit tatimor.
- ☐ Përgatita e buletineve informuese lidhur me vendimet e formës së prerë të gjykatave, shoqëruar me një analizë të vendimarrjes së tyre;
- ☐ Marrja e masave për përfaqësimin cilësor në konfliktet gjyqësore, përgatitjen e provave dhe prapësimeve etj.

3. Progresi Organizativ i Administratës Tatimore dhe Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

3.1 Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

- ☐ Ofrohet eksperiencia e deritanishme mbi shkëmbimin e informacionit me administratat homologe.

3.2 Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

- ☐ Ndarja racionale e detyrave brenda Drejtorisë;
- ☐ Vlerësimi objektiv i punonjësve sipas meritës dhe aftësive.

3.3 Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

- ☐ Trajtimi me përgjegjshmëri i problematikave lidhur me marrëveshjet ekzistuese; Hartimi i draft-marrëveshjeve sipas nevojave institucionale;
- ☐ Trajtimi dhe dhënia e opinionit për draft-marrëveshjet e propozuara nga institucionet e tjera.

4. AKTIVITET E PROGRAMUARA DHE REALIZUARA GJATË VITIT 2025 NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE

Duke pasur parasysh organizimin e strukturës së Drejtorisë Teknike dhe Ligjore raportimi mbi rezultatet dhe veprimtarinë e saj për vitin 2025 do të pasqyrohet në 2 ndarje kryesore sipas sektorëve përkatës, përkatësisht: Sektori Ligjor dhe Sektori Teknik

SEKTORI LIGJOR

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ky sektor ka ofruar shërbim ligjor dhe konsulencë e asistencë juridike për Drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoritë Rajonale Tatimore, tatimpagues të ndryshëm dhe për institucione të tjera të administratës shtetërore, nëpërmjet:

□ Dhënies së opinionit ligjor për çështje dhe problematika të hasura në praktikë, për të cilat është kërkuar mendim nga strukturat në DPT apo Drejtoritë Rajonale Tatimore. Sektori Ligjor ka bashkëpunuar me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm, në mënyrë që të garantohet asistencë teknike dhe ligjore për tatimpaguesin.

- Janë dërguar rreth 10 (dhjetë) opinione ligjore ndaj strukturave të administratës tatimore dhe subjekteve lidhur me çështje specifike të cilat janë analizuar rast pas rasti.

- Janë trajtuar mbi 850 (tetëqind e pesëdhjetë) shkresa drejtuar strukturave të administratës tatimore, subjekteve apo institucioneve të tjera të administratës shtetërore.

□ Janë përgatitur 2 Buletine të Vendimeve Gjyqësore, përkatësisht për periudhat Janar - Qershor 2025 dhe Korrik - Dhjetor 2025

□ Janë hartuar dhe është dhënë mendim për 5 marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve dhe Transportit Rrugor;

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Bankës OTP Albania;

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Bankës Raiffeisen Bank;

- Memorandum mirëkuptimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë;

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

□ Janë përcjellë propozimet për ndryshime ligjore pranë Ministrisë së Financave për:

- Propozime për Ndryshime ligjore në kuadër të Paketës Fiskale përfshirë ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr. 87, datë 18.12.2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, etj.

-Propozime për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-më nr.613, datë 29.07.2020 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare" i ndryshuar

Gjithashtu, Sektori Ligjor ka dhënë komente/mendim për 45 projekt-akte të përcjella nga Ministria e Financave.

Proceset gjyqësore

Specialistët e Sektorit të Çështjeve Ligjore në DPT përfaqësojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në të gjitha konfliktet gjyqësore ku ajo është palë ndërgjyqëse. Për vitin 2025 specialistët/juristët e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore kanë përfaqësuar DPT- në të gjitha konfliktet gjyqësore të deleguara sipas rastit, me palë paditëse ish-punonjës të kontraktuar nga administrata tatimore, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës apo nëpunës civilë të konfirmuar.

Janë marrë masat për të garantuar përfaqësimin në çdo proces gjyqësor. DPT është përfaqësuar profesionalisht në 139 çështje të lidhura me marrëdhënien e punës, si më poshtë:

çështje gjyqësore me palë paditëse punonjës dhe ish-punonjës të kontraktuar me kontratë punësimi nga Administrata Tatimore, për të cilat Gjykatat e Rrethit Gjyqësor kanë dalë me vendim për 21 çështje gjyqësore ndërsa për 11 çështje vijon gjykimi.

- Në Gjykatat Administrative gjatë vitit 2025 janë gjykuar 92 çështje gjyqësore, ku Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë dalë me vendim për 57 çështje gjyqësore ndërsa për 35 çështje vijon gjykimi.

- Gjykatat e Apelit kanë dalë me vendim për 15 çështje gjyqësore.

Detyra të tjera të realizuara nga Sektori Ligjor.

☐ Ka garantuar trajtimin e praktikave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, konform legjislacionit në fuqi.

☐ Janë ndjekur dhe vlerësuar praktikat e ardhura në DPT nga Zyrat e Përmbarimit apo kërkesa individuale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe ka përgatitur të gjitha praktikat e ardhura për trajtim si dhe përcjelljen për veprime të mëtejshme strukturave kompetente.

☐ Gjithashtu, janë trajtuar të gjitha shkresat për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare, ku subjekt raportues i të dhënave janë të gjitha institucionet financiare banka dhe jo banka, të cilat kanë në administrimin e tyre llogari bankare dhe kaseta sigurie.

☐ Pjesëmarrja në grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit si:

- Komisioni i inventarizimit për vlerat materiale në ngarkim të punonjësve të DPT-së dhe magazinave të saj.

- Komisionit të Ekspertizës

- Dy specialist të Sektorit Ligjor janë anëtare të Komisionit të çertifikimit të prodhuesve dhe mirëmbajtësve të zgjidhjeve Softwarike.

- Grupi i punës për përafrimin e direktivave të BE-së me legjislacionin shqiptar dhe ndërveprimin e sistemeve tatimore IT me ato të BE;

- Grupi i punës me qëllim rishikimin dhe përditësimin e informacionit në faqen zyrtare të internetit.

Gjithashtu specialistët e Sektorit Ligjor kanë marrë pjesë në një sërë grupesh pune në kuadër të përafrimit të legjislacionit si:

- Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”;

- Kapitulli 18 “Statistikat”;

- Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

SEKTORI TEKNIK

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ky sektor ka ofruar konsulencë dhe asistencë teknike për Drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoritë Rajonale Tatimore, tatimpagues të ndryshëm dhe për institucione të tjera të administratës shtetërore.

Trajtimi i kërkesave për interpretim dhe asistencë, realizimi i detyrave funksionale të tjera

Sektori Teknik ka trajtuar çdo kërkesë të ardhur për interpretim apo sqarime teknike dhe ligjore të përcjella nga subjektet tatimpagues, Drejtoritë Rajonale Tatimore apo nga Drejtoritë në DPT.

- ☐ Konkretisht Sektori TVSH-së ka trajtuar 240 kërkesa, duke siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm.
- ☐ Sektori Teknik ka dhënë komente/mendim për 55 projekt-akte të përcjella nga Ministria e Financave.
- ☐ Është angazhuar maksimalisht për dhënien e kontributit në draftimin e propozimeve për Paketën Fiskale 2026.
- ☐ Ka dhënë kontributin për draftimin e çdo njoftimi të publikuar në faqen zyrtare, i lidhur me ndryshimet ligjore në fushën e TVSH-së, tatimit mbi të ardhurat apo taksat kombëtare.
- ☐ Ka dhënë kontribut konkret lidhur me draftimin e akteve ligjore dhe nënligjore të lidhura me skemën e kompesimit të fermerëve.
- ☐ Është angazhuar për draftimin e deklaratave të reja tatimore të kushtëzuara nga ndryshimet ligjore në fuqi (Deklarata e Tatimit Korporativ, Deklarata e të ardhurave personale nga punësimi, Deklarata vjetore e të ardhurave personale, Deklarata e lojrave të fatit, etj).

Trajtimi i kërkesave për pajisjen e individëve me Çertifikatatë Rezidence Tatimore.

Vërtëtimi i rezidencës i lëshohet tatimpaguesve të regjistruar në organet tatimore Shqiptare nga DPT, pas kërkesës me shkrim të tatimpaguesit dhe pasi bëhen verifikimet e nevojshme në Degën e Tatimeve ku ai është i regjistruar.

Vërtetimi i rezidencës i shërben tatimpaguesit për të vërtetuar se paguan tatimet për të ardhurat globale në Shqipëri, në mënyrë që organi tatimor i shtetit të huaj, ku ai ka realizuar të ardhurat të bëjë aplikimin e Marrëveshjes (duke aplikuar, sipas rastit, tarifën e reduktuar ose duke mos i tatuar ato të ardhura).

Sektori Teknik për vitin 2025 ka trajtuar 717 kërkesa për çertifikatë rezidence, të adresuara për sektorin nga individë shtetas shqiptarë si dhe nga individë residentë në RSH, me nënshtetësi të huaj.

Angazhime të inspektorëve në grupe pune

- ☐ Një inspektor është i angazhuar si anëtar i Njesisë së Prokurimeve.
- ☐ Merr pjesë aktive në Grupin e Punës të ngritur implementimin në sistemet tatimore të ndryshimeve ligjore
- ☐ Inspektorët e Sektorit Teknik kanë marrë pjesë në një sërë grupesh pune në kuadër të përafrimit të legjislacionit:
 - Kapitulli 16 (Tatimet),
 - Kapitulli 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria),
 - Kapitulli 33 (Dispozitat Buxhetore dhe Financiare) si dhe Komiteti i Sigurisë së Informacionit.
- ☐ Gjithashtu inspektorët e Sektorit Teknik janë anëtarë të grupit të punës për përafrimin e direktivave të BE-së me legjislacionin shqiptar dhe ndërveprimin e sistemeve tatimore IT me ato të BE.

V. KONTROLLI TATIMOR

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara, punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performacës së administratës tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore si dhe udhëheqjen metodologjike të Drejtorive të Kontrollit në DRT-të.

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale në zbatim të objektivave të Planit Strategjik, si dhe në ndjekje të rekomandimeve të FMN-së.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e të dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

Realizimet e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij.

Detyrat funksionale të Drejtorisë së Kontrollit janë si më poshtë dhe janë realizuar në përputhje me objektivat e miratuar në planin operacional për vitin 2025:

DKT është pjesë aktive e Komitetit të Riskut. Propozon, monitoron dhe raporton pranë tij, duke realizuar detyrat e saj në këtë komitet:

- ❖ Kryen kontrole dhe bën verifikime në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit nga zyra dhe kontrollit në vend në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe që janë pjesë e Manualeve të Kontrollit.
- ❖ Monitoron arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigon ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur është e nevojshme. Gjithashtu, ofron

këshillim dhe udhëzim të specializuar për një kontroll eficient dhe efektiv të tatimpaguesit.

- ❖ Raporton gjetjet që kanë dalë gjatë kontrolleve në lidhje me metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit, mospërbushjet apo shkeljet ligjore, ose shërbimet e ofruara për tatimpaguesin, së bashku me rekomandimet për ndryshime të mëtejshme, duke propozuar edhe masa në rastet e shkeljeve administrative e ligjore. Dhe duke analizuar problematikat e konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit ai rekomandon programet e trajnimit, për rritjen e aftësive të inspektorëve.
- ❖ Ndjek zbatimin e planeve të kontrolleve mujore të dërguara në DRT-të, si dhe mbi bazën e rezultateve të kontrolleve mujore të raportuara nëpërmjet evidencave mujore, brenda datës 10 të çdo muaji, ka analizuar e përpunuar vlerësimet e mbledhura mbi analizën e riskut për tatimpaguesit e kontrolluar nga të gjitha drejtoritë tatimore rajonale si dhe ka mbajtur evidencë të detajuar në lidhje me numrin dhe llojin e kontrolleve për çdo DRT, duke analizuar rezultatet dhe progresin e bërë kundrejt planit dhe kundrejt faktorëve të riskut mbi të cilët subjekti është përzgjedhur për kontroll kjo në bashkëpunim me DMR.

Objektivat për vitin 2025

Objektivat strategjike përkatësisht për drejtorinë e kontrollit objektivat dhe aktivitete konkrete të ndërmarra për vitin 2025 janë si më poshtë:

Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.

Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njehësuese

Drejtoria e Kontrollit ka garantuar praninë e sistemeve të qarta dhe të rregulluara për operacionet e kontrollit tatimor të tatimpaguesve, që ato të kuptohen e të pranohen si të drejta e të arsyeshme si edhe të zbatohen dhe të ndiqen vazhdimisht nga DRT;

Është kryer përgatitja e udhëzimeve apo rregulloreve që do ndihmojnë në procesin e propozimeve të kontrollit nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT.

Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor.

Zbatimi i strategjisë së përbushjes së menaxhimit të riskut.

Janë miratuar planet mujore të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e punës për secilin sektor.

Është kryer analizimi i të dhënave dhe raporteve të kontrollit në përputhje me legjislacionin për çdo DRT objekt Kontrolli dhe nxjerrë rekomandime për rritjen e efikasitetit të Drejtorive të Kontrollit si dhe në udhëheqjen metodologjike të kontrollit nga Drejtoria e Kontrollit në DPT. Nga raportimet e DRT-ve kemi evidencën mbi kontrollet:

Kontrolle e planifikuara			Kontrolle e kryera			Realizimi i planit të kontrolleve në %		
Gjithsej	Të plota	V. Fiskale	Gjithsej	Të plota	V.	Gjithsej	Të plota	V. Fiskale
2531	507	3038	2624	645	3269	107.60%	103.67%	127.22%

Gjithashtu kryer analiza Mujore e Performancës së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT (Drejtoria e Kontrollit Tatimor).

Kryer përmirësim i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore.

Janë hartuar dhe miratuar planet operacionale të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e kontrollit për cdo drejtori rajonale.

Është kryer analiza e punës e sektorëve të Kontrollit sipas detyrave funksionale.

Gjatë vitit 2025 janë monitoruar vazhdimisht sektorët e kontrollit, në lidhje me kontrollet në proces, deklarimet, dorëzimin e pasqyrave financiare etj.

Në mënyrë progresive mujore mbi bazë të raportimeve me email, por edhe në formë shkresore tërheq vëmendjen e DRT-ve për zbatimin e afateve të kontrolleve bazuar në Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Ligjit të Procedurave Tatimore.

Për vitin 2025 është hartuar plani operacional për Drejtorinë e Kontrollit dhe është detajuar sipas sektorëve në plane pune.

Janë marrë masa që rekomandimet dhe kërkesat e, Kontrollit të Lartë të Shtetit, rekomandimet

e FMN dhe institucioneve të tjera shtetërore, ndjekur dhe zbatuar në lidhje me kontrollin e tatimpaguesve;

Është kryer analiza e zbatimit të shkallëve të ndryshme të TVSH, sipas rekomandimit të KLSH.

Është kryer analiza e efektivitetit të punës së inspektorëve sipas formimit të tyre dhe shpërndarja e kontrolleve bazuar në aftësi, sipas rekomandimeve të FMN.

Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit është kryer verifikimi i Drejtorive Rajonale mbi problematikat e kontrollit tatimor, verifikimit në terren, vlerësimit dhe analizës së riskut;

Program kontrolli në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

Është kryer evidentimi i problematikave që kanë nevojë për trajtim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe ndjekja e tyre.

Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

Drejtoria e Kontrollit ka zbatuar dhe rekomanduar programet e trajnimit për drejtuesit dhe inspektorët e kontrollit tatimor.

Është kryer evidentimi i nevojave për DRT dhe DPT nëpërmjet hartimit të një pyetëso, ku janë përcaktuar fushat e trajnimit, sektorët, etj.

Gjithashtu përgjatë vitit 2025 është kryer ndjekja e procesit të bashkëpunimit me Administratën Tatimore Suedeze, në funksion të përcaktimit të objektivave dhe fushave që asistencës së nevojshme për Drejtorinë e Kontrollit.

Mbajtja e proçeseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore.

Është kryer analiza e gjetjeve dhe rezultateve të raporteve të kontrollit tatimor dhe nxjerrja e rekomandimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së kontrollit. Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve dhe përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre.

Nr. i kontrolleve të kryera me zbulime	Zbulime (000lekë)				
	TVSH	TF	Sig Shoq	Te tjera	Gjithsej
2856	5,499,894	9,714,497	112,207	456,779	15,783,377

Për vitin 2025 nga kontrollet e kryera janë evidentuar dhe ndjekur problematika lidhur me trajtimin në raportin e kontrollit të problematikave sipas sektorëve.

Aktivitete të realizuara për vitin 2025

Drejtoria e Kontrollit ka përfunduar kontrolle tematike në Drejtoritë e Kontrollit Tatimor në DRT, për zbatimin me korrektësi dhe profesionalizëm të legjislacionit tatimor, duke u përqendruar në drejtimin metodologjik të veprimtarisë të Drejtorive të Kontrollit pranë DRT-ve. Kontrollin dhe analizën e punës së inspektorëve të sektorit të kontrollit pranë DRT-ve, bazuar në planet operationale vjetore të miratuara për këtë qëllim, në përputhje me procedurat ligjore dhe kërkesat e akteve nënligjore të përcaktuara në rregulloret e brendshme dhe në Manualin e Kontrollit Tatimor.

Nga Drejtoria e Kontrollit janë dërguar shkresa dhe email në Drejtoritë Rajonale Tatimore në lidhje me orientimin dhe zbatimin e analizës së riskut për subjektet e përzgjedhur për kontroll sa më efektive në mbështetje të manualin të kontrollit analizën e riskut duke u mbështetur në analizën dhe propozimet e kryera nga inspektori i kontrollit nga zyra.

Mbajtur protokolli i shkresave, shqyrtuar dhe adresuar shkresat për vitin 2025, si dhe përcjellë sipas problematikave sektorëve përkatës, në respektim të afateve ligjore të kthimit të përgjigjeve të afërsisht 1800 shkresa.

Është kryer trajtimi i shkresave të deleguara duke hartuar përgjigjet përkatëse si dhe në raste të caktura edhe me email.

Gjithashtu kryer ndjekja dhe hartimi raportimeve për Planin Operacional vjetor, pyetësorët e OECD, FMN si dhe analiza e performancës së Drejtorisë.

Drejtoria e kontrollit ka marrë pjesë në cdo program trajnimi, të organizuar në DPT në

zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi dhe ligjit të ri të tatimit mbi të ardhurat; si fiskalizimi dhe në projekte të përbashkëta me Suedezët, FMN apo Bankën Botërore. Drejtoria e kontrollit ka qenë pjesë aktive në mendimdhënie në lidhje me ndryshimet ligjore, si dhe pjesë e grupeve si në implementim në sisteme tatimore dhe në mënyrën e zbatimit të tyre, kjo në bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë Teknike dhe Ligjore, Drejtorinë e Proceseve të Biznesit dhe Drejtorinë e Riskut.

Nga drejtoria e kontrollit janë ndjekur dhe marr masa në lidhje me rekomandimet dhe kërkesat e auditit të Ministrisë së Financës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatit të Tatimpaguesve, etj.

Nga drejtoria e kontrollit janë ndjekur raportimet për Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjithashtu janë ndjekur të gjitha raportimet e lidhura me listat e dërguara nga Komiteti i Riskut në Drejtori Rajonale, verifikime rast pas rasti për çdo DRT dhe raportimet lidhur me evidencat për Drejtorinë e Kontrollit.

Hartimi i disa raportimeve përmbledhëse nga DRT për listat e dërguara pranë DRT-ve nga Komiteti i Riskut, referuar raportimeve dhe masave të marra nga drejtoritë rajonale sipas problematikave përkatëse. Evidentimi i rasteve të pa kryera nga ana e drejtorive rajonale, nxjerrje e të dhënave për raste që janë të përsëritura dhe referim për verifikime të mëtejshme.

Gjithashtu në lidhje me Sektorin e Taksimit të Dyfishtë, gjatë periudhës raportuese është realizuar bashkëpunim i vazhdueshëm me Ministrinë e Financave, duke marrë pjesë në takime teknike dhe procese negociuese për përfundimin dhe përditësimin e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare. Kontributi ka konsistuar në analizë të dispozitave, dhënie mendimesh teknike dhe vlerësim të ndikimit të marrëveshjeve në sistemin tatimor.

Janë ofruar sqarime dhe asistencë teknike për Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe strukturat përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Është ndjekur dhe mbështetur zbatimi i marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare duke siguruar interpretim të njëtrajtshëm dhe respektim të detyrimeve ndërkombëtare.

Gjithashtu gjatë vitit 2025 është perfunduar procedura për kalimin online të aplikimeve për zbatimin e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, përmes platformës digjitale të Administratës Tatimore.

VI.MENAXHIMI I RISKUT

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në organigramën e DPT-së është në varësi të Drejtorisë së Hartimit të Programeve, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DMR dhe është e organizuar në 2 sektorë.

- Sektori i Analizës së Riskut me 1 Përgjegjes dhe 10 Specialistë (3 pozicione vakante- 3 inspektor)
- Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve -me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialistë (3 pozicione vakante, 3 Specialist)

Objektivi parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi, mbi bazën e kriterëve të miratuara dhe të zhvilluara paraprakisht, i tatimpaguesve që paraqesin risk potencial në lidhje me përmbushjen e detyrimeve tatimore, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga administrata tatimore, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

Objektivat e Drejtorisë për vitin 2025

Objektivi strategjik i DMR-së është përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të risqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor, me qëllim ndikimin në uljen e hendekut të mospërmbushjes. Ky objektiv bazohet në këto shtylla të rëndësishme:

- ✚ Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut;
- ✚ Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;
- ✚ Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit, duke shërbyer si faktor për vlerësimin e riskut;
- ✚ Hartimi i analizave cilësore të fokusuara në identifikimin dhe targetimin e risqeve specifike;
- ✚ Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes;
- ✚ Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset, me synimin marrjes së një baze të plotë të dhënash;

Treguesit kryesorë të performances janë:

- ✚ Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve;
- ✚ Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve pas trajtimit, përmes reduktimit të numrit të tatimpaguesve me risk;
- ✚ Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve pas trajtimit, – përmes reduktimit të hendekut të përmbushjes;
- ✚ Vlera dhe numri i deklaratave të korigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta;

Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT.

Objektivat e DMR-së janë në përputhje me vlerësimin e TADAT Qershor 2022, Kapitulli IV,

Menaxhimi efikas i Riskut POA 2 ,

Raportimi i saktë në deklarata POA 6,

Fushveprimi i nismave për reduktimin e kostove të përmbushjes nga tatimpaguesit POA 3-10

Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë vitit 2025, në funksion të aritjes së objektivave.

Realizimi i trajnimeve nga ekspertë të FMN-së lidhur me Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes, trajnime për programin e përpunimit të të dhënave me volum të madh (R Studio), trajnime nga ekspertë të Administratës Suedeze, si dhe bashkëpunim me projektin anglez.

Përkushtimi dhe fokusi në procesin e integritetit në Bashkimin Europian, me synim përmbushjen e pikave referuese (**benchmarks**) për **Kapitullin 16** dhe **kriterin ekonomik**. Vëmendje e veçantë iu kushtua adresimit të rekomandimeve të **Raport-Progresit** të Komisionit Europian, si dhe ndjekjes dhe monitorimit të indikatorëve të **MTRS-së** dhe **Planit të Rritjes** (Growth Plan).

Plani i Turizmit 2025

Në kuadër të Planit të turizmit 2025, të miratuar me Vendim të Komitetit të Riskut Nr.19 dt 05.06.2025, janë analizuar të dhenat në sistemin tatimor për subjektet pjesë e planit, si dhe janë kryer një sërë analizash për risqe të ndryshme, të cilat i janë dërguar D.V.K.T për verifikim.

- ✚ Tatimpagues me mbi 20 dhoma të vetëdeklaruar dhe pa përgjegjësi TVSH-je (Durrës);
- ✚ Tatimpagues me mbi 20 dhoma të vetëdeklaruar dhe pa përgjegjësi TVSH-je (Lezhë);
- ✚ Tatimpagues me mbi 20 dhoma të vetëdeklaruar dhe pa përgjegjësi TVSH-je (Sarandë);
- ✚ Tatimpagues me mbi 20 dhoma të vetëdeklaruar dhe pa përgjegjësi TVSH-je (Shkodër);
- ✚ Tatimpagues me mbi 20 dhoma të vetëdeklaruar dhe pa përgjegjësi TVSH-je (Vlorë);
- ✚ Tatimpagues të vijës së parë të evidentuar me risk në DRT Sarandë për zonat Sarandë, Ksamil, Borsh;
- ✚ Tatimpagues me xhiro në fundjave më pak se 800.000 lekë dhe me më shumë se 6 punonjës aktiv në listëpagesë DRT Vlorë;
- ✚ Tatimpagues që dyshohen për nëndeklarim me 7 ose më shumë punonjës në zonat Dhërmi Vlorë;
- ✚ Tatimpagues me qarkullim të ulët në fundjavat e korrikut në zonat Velipojë Shirokë;
- ✚ Tatimpagues me aktivitet muzikor në Shkodër;
- ✚ Tatimpagues të evidentuar me risk në Berat;
- ✚ Tatimpagues të evidentuar me risk në Gjirokastrë;
- ✚ Tatimpagues të evidentuar me risk në Korce;
- ✚ Tatimpagues të evidentuar me risk në Lezhë, Shëngjin;
- ✚ Tatimpagues të evidentuar me risk në Pogradec;
- ✚ Tatimpagues të evidentuar me risk në Fier;
- ✚ Tatimpagues që kanë raportin xhiro në krahasim me numrin e punonjesve më të ulët duke marrë parasysh aktivitetin që kryejnë (Durrës 2);
- ✚ Tatimpagues që kanë raportin xhiro në krahasim me numrin e punonjësve e kanë më të ulët duke marrë parasysh aktivitetin që kryejnë, dyshohen për nëndeklarim (Durrës);
- ✚ Lista e TP me leje stacione plazhi.

Disa nga rezultatet e Planit të Turizmit janë:

Nga krahasimi i të dhënave nga fiskalizimi, vihet re se për periudhën Gusht 2025 krahasuar me Gusht 2024 kemi një rritje të shitjeve prej 20% dhe një rritje prej 18% për periudhën Qershor - Gusht 2025 krahasuar me Qershor - Gusht 2024.

Nga krahasimi i të dhënave nga deklaratat e TVSH-së, vihet re se për periudhën Gusht 2025 krahasuar me Gusht 2024 kemi një rritje të qarkullimit prej 21% dhe një rritje prej 34% të shumës së paguar ndërsa për periudhën periudhën Qershor - Gusht 2025 krahasuar me Qershor - Gusht 2024 kemi një rritje të qarkullimit prej 16% dhe një rritje prej 33% të shumës së paguar.

Nga krahasimi i të dhënave të lispagesës për periudhën Gusht 2024 – Gusht 2025 vihet re një rritje e numrit të punonjësve me 6% dhe një rritje e pagës bruto për kontribute me 21%.

Janë regjistruar për përgjegjësi të TVSH-se rreth 246 TP gjatë periudhës Maj – Shtator 2025.

Shkeljet e evidentuara gjatë planit të turizmit, renditur sipas numrit më të lartë të llojit të shkeljeve:

-  Moslëshim fature
-  Mall pa faturë tatimore
-  Moslëshim fature (autofature)
-  Punonjës i padeklaruar
-  Sekuestrim njësi kompjuterike
-  të tjera

Formalizimi i sektorit të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale Në kuadër të formalizimit të sektorit të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe rritjes së sigurisë ushqimore, është analizuar çdo **subjekt** që ushtron veprimtari si grumbullues ose përpunues i produkteve ushqimore, përfshirë këtu edhe përpunimin e qumështit.

Publikimi i pagave indikative

Gjatë vitit 2025, Administrata Tatimore publikoi pagat indikative për dy sektorë, me qëllim orientimin e bizneseve për deklarimin e saktë të pagave. Këto paga shërbejnë si referencë për nivelin e pritshëm të pagës dhe ndihmojnë në parandalimin e nën-deklarimit të të ardhurave.

- Publikimi i listës së pagave indikative për sektorin e turizmit (13.06.2025)

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1891/publikohet-lista-e-pagave-indikative-per-sektorin-e-turizmit>

- Publikimi i listës së pagave indikative për sektorin e ndërtimit (01.12.2025)

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1910/publikohet-lista-e-pagave-indikative-per-sektorin-e-ndertimit>

Përmirësimi i Modulit të Riskut

Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtperdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Në kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave dhe përshtatjes me ndryshimin e ligjit të tatimit mbi të ardhurat, DMR ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumentit në word.

Janë rishikuar pjesa e rregullave që lidhen me pagat dhe tatimin në burim, tatimin mbi të ardhurat personale të biznesit, tatimin mbi të ardhurat e korporatës referuar ndryshimeve ligjore në zbatim të ligjit 29/2023, për shkak se në sistemin tatimor janë implementuar deklaratat e reja.

Në bashkëpunim me specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin janë analizuar të dhënat nga Modeli i Riskut.

Kërkesa për raporte të reja

Është bërë kërkesa drejtuar palëve mirëmbajtëse për zhvillimin në sistemin C@TS për raportet:

-  Kryqëzim i Librave me deklaratën e TVSH-së
-  Numri i pozicioneve të punës, për punonjës që kanë punuar të paktën 22 ditë në muaj në nivel DRT
-  Paga mesatare për kontribute, për punonjës që kanë punuar të paktën 22 ditë në muaj në nivel DRT
-  Të dhëna statistikore nga listëpagesat sipas subjekteve
-  Numri i punonjësve sipas kategorisë për kontribute
-  Pasqyrat financiare për tatimpagues
-  Individë të parregjistruar ose mosdeklarues DIVA

Gjithashtu janë përmirësuar raportet si më poshtë;

- ✚ Lista e tatimpaguesve sipas përgjegjësisë

- ✚ Ekstrakti historik i punësimit

Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë Kërkesë për Rimbursim

Bazuar në rregulloren për rimbursimin e Tvsh-së, mbështetur në Analizën e Riskut kapitulli 6, për çdo kërkesë për rimbursim të ardhur elektronikisht nëpërmjet sistemit c@ts në formën e një mesazhi pop up nga DRTVSH-ja, nëse tatimpaguesi në fjalë bën pjesë në tatimpaguesit me risk të lartë sipas modulit të riskut, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut kryen verifikimet e duhura dhe njofton elektronikisht DRTVSH-në, sipas afateve të përcaktuara në rregulloren e rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut.

3. Analiza periodike për fenomene të ndryshme, tatime të veçanta dhe për sektorë të caktuar bazuar në vendimet e Komitetit të Riskut si më poshtë:

- ✚ Vendimi nr 26 date, 09.01.2025

- ✚ Vendimi nr 27 date, 04.02.2025

- ✚ Vendimi nr 28 date, 12.03.2025

- ✚ Vendimi nr 29 date, 23.04.2025

- ✚ Vendimi nr 30 date, 26.05.2025

- ✚ Vendimi nr 31 date, 05.06.2025

- ✚ Vendimi nr 32 date, 25.06.2024

- ✚ Vendimi nr 33 date, 23.07.2025

- ✚ Vendimi nr 34 date, 22.08.2025

- ✚ Vendimi nr 35 date, 25.09.2025

- ✚ Vendimi nr 36 date, 27.10.2025

- ✚ Vendimi nr 37 date, 27.11.2025

- ✚ Vendimi nr 38 date, 22.12.2025

- ✚ Vendimi nr 39 date, 12.01.2025

U miratuan dokumentet:

- ✚ Plani i Përbushjes DPT 2025-2026 dhe Skanimi Mjedisor.

- ✚ Plani Sektorial i Turizmit 2025.
- ✚ Plani i menaxhimit të riskut për sektorin e ndërtimit

U propozuan dhe miratuan listat për tatimpaguesit si në vijim:

- ✚ Miratimi Planeve të kontrollit;
- ✚ Lista TP për ndryshim përgjegjësie tatimore;
- ✚ Lista TP që kanë Diferenca nga deklarata e TVSH-së dhe të dhënave nga fiskalizimi;
- ✚ Lista TP deklarues me zero të deklaratës së TVSH-së por me xhiro në fiskalizim;
- ✚ Tatimpagues me punonjës në kategori për kontribute "Me raport..." por që nuk figurojnë në listen e individëve që kanë përfituar pagesa nga ISSH për muajin nëntor 2024;
- ✚ Lista e tatimpaguesve të propozuar për kontroll të plotë në vend, (OJF) që paraqesin risk potencial për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- ✚ TP me mbi 10 fatura, mbi 50% korrigjuese periudha 05 janar - 07 janar 2025;
- ✚ Lista e individëve për të cilët data e hyrjes në punë dhe data e largimit në puna janë të njëjta (2412);
- ✚ Lista e punonjësve për të cilët është dorëzuar formulari Esig027 (hyrja në punë ose edhe largimi) por nuk është dorëzuar formulari Esig025 (listëpagesa) nga tatimpaguesi;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me qarkullim afër pragut të regjistrimit për TVSH-në ose TF por që nuk e arrijnë atë;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me diferenca në librat e blerjes dhe shitjes C@TS-Fiskalizim;
- ✚ Fiskalizimi i Zyrave të Këmbimit Valutor, lista e tatimpaguesve me status aktiv por që figurojnë të pa fiskalizuara;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me shitje me 6% TVSH por që nuk plotësojnë kriteret që të shesin me këtë normë të reduktuar;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me të ardhura tatimore mbi 14 milion lekë dhe që kanë plotësuar deklaratën e TFTH;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me qarkullim afër pragut të regjistrimit për TVSH-në ose TF por që nuk e arrijnë atë;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me shitje artikuj me 6% TVSH por që përshkrimi i artikullit nuk plotëson kriteret për këtë normë të reduktuar;

- ✚ Lista e tatimpaguesve me shkallë të reduktuara të Tatim Fitimit 2023-A, por që objekti i aktivitetit të tyre nuk përfshihet te shkallët e reduktuara;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me fatura korigjuese Cash B2C mbi 20% Janar- Mars 2025;
- ✚ Lista e TP me shkallë të reduktuara të TF, 2024-A;
- ✚ Lista e TP të formës ligjore person fizik dhe dhe që kanë përdorur norme 15% për tatim fitimin e vitit 2024;
- ✚ Lista e punëmarrësve të padeklaruar brenda procesit të inspektimit nga ISHPSHSH;
- ✚ Lista te dypunesuar me kontribute me pak se niveli min.2503;
- ✚ Lista te dypunesuar me kontribute me pak se niveli max.2503;
- ✚ Punonjes i deklaruar ne kategorine per kontribute "Barrelindje ... " mbi 12 periudha dhe pa reagim edhe pas mesazhit;
- ✚ Punonjës në një nga kategoritë “I dypunësuar...” por vetem në një listëpagesë;
- ✚ Lista e tatimpaguesve pa xhiro në fiskalizim dhe mbi 2 punonjës;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me raport blerje/shitje për periudhen 2401-2504 >90%;
- ✚ Miratim i propozimit nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut për aplikimin e risqeve për tatimpaguesit të cilët kanë marrë autorizim për rindërtim në vitet 2023 - 2024;
- ✚ Tatimpagues me qarkullim 15 - 20 milion lekë;
- ✚ Tatimpagues me qarkullim nën 15 milion lekë;
- ✚ Lista e tatimpaguesve për regjistrim TB;
- ✚ Lista OJF që nuk kanë deklaruar pronarin përfitues;
- ✚ Lista e TP që kanë deklaruar fondet e pensionit vullnetar;
- ✚ Lista e tatimpaguesve që kanë çekuar pa aktivitet;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me qarkullim pa kontribute;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me risk të cilët kanë marrë autorizim për rindërtim në vitet 2023 - 2024;
- ✚ Punonjes me raport mjeksor por jo te lista ISSH;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me raport blerje/shitje për periudhen 2401-2505 >100%, pa reagim nga Pop_Up i dërguar në Maj 2025;
- ✚ Lista e tatimpaguesve të pajisur me certifikate nga Ministria e Turizmit, të cilët kanë mbi 20 dhoma dhe 1-3 punonjës;

- ✚ Lista e tatimpaguesve të sektorit turistik;
- ✚ Lista e tatimpaguesve të cilët kanë marrë leje për bitum qymyrguri, zh. Bituminoz, rërë bituminoze nga AKBN;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me 30 - 100 automjete me qira dhe numër të ulët punonjës ose nivel qarkullimi;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me aktivitete muzikore për muajin Qershor 2025, por pa faturë blerjeje nga këngëtari apo DJ ose deklaratë TB;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me paga të ulëta për profesionet e sektorit turistik edhe pas dërgimit të Pop-Up, Qershor 2025;
- ✚ Lista e subjekteve të cilët nga monitorimi i qarkullimit sipas të dhënave të fiskalizimit gjatë datave 25 – 26 – 27 Korrik 2025, rezultojnë se nuk kanë deklaruar qarkullim ose kanë deklaruar vlera të ulëta xhiroje;
- ✚ Lista e subjekteve me zero kontribute + TAP për 6 mujorin e parë të vitit 2025 por me qarkullim të pakten 1 (një) mln lekë;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me leje për stacione plazhi të vlerësuar me risk;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me risk për nëndeklarimin e qarkullimit, pa përgjegjësi TVSH;
- ✚ Lista e tatimpaguesve tregtues/ prodhues të produkteve agro ushqimore me rënie në nivelin e qarkullimit;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me aktivitete muzikore për muajin Korrik dhe Gusht 2025, por pa faturë blerjeje nga këngëtari apo DJ ose deklaratë TB;
- ✚ Lista e tatimpaguesve/ individëve që nuk kanë dorëzuar DIVA për vitin 2024;
- ✚ Lista e tatimpaguesve person fizik me fitim tatimor mbi 14.000.000 lekë 2024-A dhe pa reagim pozitiv pas mesazhit Pop_Up;
- ✚ Lista e tatimpaguesve të rinj, mosdeklarues të vendit të ushtrimit të aktivitetit. - Për trajtim mesazh Pop-Up në llogarinë e tatimpaguesit;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me diferenca midis deklaratës së dorëzuar dhe asaj të parambushur të TVSH-së për periudhën Shtator 2025;
- ✚ Lista e tatimpaguesve që kanë ulur detyrimin e rillogaritur të tatimit mbi pagat në DIVA 2024;
- ✚ Lista e tatimpaguesve që me qarkullim afër pragut për TVSH-në për 9-mujorin vitit 2025;

- ✚ Lista e tatimpaguesve që kanë aplikuar TVSH 6%, pa certificate nga MT ose për atikuj që nuk kanë të drejtë;
- ✚ Lista e tatimpaguesve që kanë kredituar TVSH për blerjet nga fermerët;
- ✚ Lista e tatimpaguesve me qarkullim afër pragut për TVSH-në, pa reagim nga mesazhi i pare;
- ✚ Lista e tatimpaguesve për të cilët është e nevojshme të korrigjohen listëpagesat/ gabim në sistem;
- ✚ Lista e Individëve që kanë kryer blerje të produkteve të argjendarisë me vlerë të lartë, të cilat nuk justifikohen nga të ardhurat në DIVA 2024, si dhe individë që nuk kanë plotësuar DIVA 2024;
- ✚ Lista e tatimpaguesve që kanë punonjës në listëpagesë me profesione nga grupi i profesioneve për të cilat është publikuar paga indikative në sektorin e ndërtimit;
- ✚ Lista e tatimpaguesve nga ekzekutimi i fundit i modulit të riskut me qarkullim nën 20 milion lekë.

1. Fiskalizimi

Gjatë vitit 2025, DMR është angazhuar në monitorimin e ecurisë së sjelljes së tatimpaguesve, bazuar në procesin e fiskalizimit. Në këtë kuadër, janë dërguar në mënyrë periodike lista me tatimpaguesit, që paraqesin mospërputhje midis të dhënave të fiskalizimit dhe deklaratës së TVSH-së, si dhe janë identifikuar tatimpaguesit që qëndrojnë pranë pragut të TVSH-së ose e tejkalojnë atë.

2. Shkëmbimi automatik i informacionit

Në kuadër të zbatimit të Përmbushjes Administrative për Standartet e Shkëmbimit Automatik të informacionit të Llogarive Financiare gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

Është përditësuar lista e institucioneve financiare raportuese bazuar në listat e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare.

Shqipëria po ndërmer veprime për të siguruar që Institucionet Financiare Raportuese janë klasifikuar në mënyrë korrekte sipas rregullave të saj të brendshme dhe po raportojnë

informacionin sipas nevojës, të tilla si dërgimi i letrave shtytëse subjekteve që mund të kualifikohen si Institucione Financiare Raportuese. Shqipëria synon të mbajë të përditësuar njohuritë e saj për popullsinë e Institucioneve të saj Financiare në baza rutinë.

Ka filluar gjithashtu zbatimi i një plani operacional për të verifikuar përmbushjen me kërkesat duke dërguar pyetësorë të përmbushjes në pesë Institucionet Financiare Raportuese me numrin më të madh të llogarive të raportuara në vitin 2024 dhe 3 prej tyre iu është sqaruar dhe problematika që kanë pasur në mënyrë që në vijim të përmirësonin raportimin e tyre.

Janë kryer takime me përfaqësues të IFR-ve;

- ✚ Online – me shoqatën e bankave dhe me përfaqësues të bankave që operojnë në Shqipëri;

- ✚ Fizik – me anëtarë të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

Është dërguar letër kujtesë institucioneve financiare para afatit të raportimit i cili :

- Nënvizoi afatin e raportimit

- Nënvizoi rëndësinë e raportimit të saktë

- Specifikoi gabimet më të shpeshta të ndodhura në raportim

- Nënvizoi rëndësinë e dallimit të llogarive individuale nga ato organizative

- Nënvizoi rëndësinë e identifikimit të personave kontrollues në llogaritë organizative

Të tjera aktivitete të realizuara nga DMR gjatë vitit 2025.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut në DPT është përgjegjëse për menaxhimin e përzgjedhjes automatike të tatimpaguesve për kontroll, bazuar në kriteret e miratuara të riskut. Hartimi i planeve mujore të kontrollit, planifikim i rasteve për rimbursim referuar shkresave të DRTVSH dhe hedhja e evidencave të kontrollit në një plan-fakt të përbashkët për 14 DRT. Drejtorja e Menaxhimit të Riskut përzgjedh 70% të tatimpaguesve për kontroll tatimor të plotë në vend sipas të dhënave të regjistrit elektronik të riskut me përjashtim të DTM dhe DRT Tiranë, ku përzgjedhja për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë përfshin 50% të totalit të planit mujor.

Jane kryer ekzekutimet e modulit të riskut për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash.

Gjatë vitit 2025 janë kryer:

- ✚ 4 ekzekutime të Modulit të Riskut për Rimbursimin e TVSH-së
- ✚ 2 ekzekutime të Modulit të Riskut për Planet e Kontrollit

VII. DREJTORIA E MBLEDHJES SE DETYRIMEVE TATIMORE TE PAPAGUARA

Në zbatim të detyrave operacionale, menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara në afat mbështetet në objektiva strategjike dhe përqëndrohet në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj risqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë evidentimin sa më real të gjendjes së detyrimeve tatimore, bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone dhe NJTM, sipas evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre.

Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri më 31 Dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2025 **162.5 miliard lekë**

Gjendja në datë 31.12.2025 **194.4 miliard lekë**

Në detyrimet prej 194.4 mld lekë, të cilat ndiqen deri më 31 Dhjetor 2025, është e përfshirë edhe vlera prej 13.15 mld lekë, e cila është në proces gjyqësor, ku deri në fund të Dhjetor 2025 zë 6.8 % të stokut të detyrimeve te papaguara.

Gjatë periudhës së marrë në analizë, detyrimet tatimore kanë pësuar një rritje neto 31.89 mld lekë në krahasim me fillimin e vitit, ose thënë ndryshe është rritur stoku i detyrimeve me 19.6%, rreth 24.6 mld lekë më shumë krahasuar me vitin paraardhës.


Detyrimet e pakësuara gjatë vitit 2025 janë 34.6 mld lekë. Në detyrimet e pakësuara përfshihen arkëtimet dhe sistemimet e ndodhura gjatë periudhës.

Detyrimet tatimore të papaguara në afat deri më 31 Dhjetor 2025 të specifikuara sipas zërave përbërës paraqitet si më poshtë:

- Detyrimi 60 %
- Penalitete 36%
- Kamatëvonesa 4%


Nga të dhënat e mësipërme rezulton se principali i detyrimeve tatimore të akumuluar përbën rreth 60% të shumës totale të detyrimeve tatimore, ndërkohë që pjesa tjetër e këtyre detyrimeve 40% e mbetur përbëhet nga penalitetet dhe kamatëvonesat.

Detyrimet sipas Llojit të Tatimit



Në stokun e detyrimeve të papaguara në afat të ndarë sipas llojit të tatimit, Tatim Fitimi zë peshën më të madhe në stokun e borxhit me 35.5% në vlerë 68.97 mld lekë, e ndjekur nga TVSH me 32.9% në vlerë 63.89 mld lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 13.5% në vlerë 26.29 mld lekë, Të Tjera me 12.5% në vlerë 24.38 mld lekë, Tatimi në Burim me 3.6% në vlerë 7 mld lekë, TAP me 1.5% në vlerë 2,96 mld lekë dhe DIVA me 0.5% në vlerë 919 mln lekë.

Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2025 vs 2024 në miliard lekë



Krahasuar me fundin e vitit 2024, gjatë këtij viti Tatim Fitimi është rritur me 21.79 mld lekë, TVSH është rritur me 6.72 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 1.9 mld lekë, Tatimi në Burim me 0.57 mld lekë, zëri TAP me 0.3 mld lekë, DIVA me 0.28 mld lekë dhe zëri të tjera me 0.35 mld lekë.

Mosha e detyrimeve të papaguara në afat

MOSHA E BORXHIT DERI NË 31.12.2025							
Periudha	borxhi deri në 3 muaj	borxhi nga 3 - 6 muaj	borxhi nga 6-12 muaj	borxhi nga 1-2 vjet	borxhi nga 2-5 vjet	borxhi mbi 5 vjet	borxhi mbi 10 vjet
Detyrimet e papaguara ne afat	21,090,721	9,799,516	8,016,990	10,053,988	28,059,566	71,226,784	46,184,226


Në total stokun e borxhit mld lekë, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- borxhi deri në 3 muaj **10.8% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 3 - 6 muaj **5% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 6-12 muaj **4.1% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 1-2 vjet **5.2% ndaj totalit të stokut**

- borxhi nga 2-5 vjet **14.4% ndaj totalit të stokut**
- borxhi nga 5-10 vjet **36.6% ndaj totalit të stokut**
- borxhi mbi 10 vjet **23.8% ndaj totalit të stokut**

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara vihet re se detyrimi më i ri është arkëtuar duke përdorur analizën e profilit të riskut (detyrimi më i ri dhe vlera më e lartë) si dhe duke ndjekur vetëdeklarimet për çdo muaj nga “Sektori i Monitorimit dhe Analizës” në Rajonet e Mbledhjes, me qëllim rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesit



- Tatimpaguesit Aktivë zënë 41% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë prej 66.9 mld lekë ose 34% të vlerës totale të borxhit.
- Tatimpaguesit Pasivë zënë 59% të numrit total të tatimpaguesve debitorë me një vlerë prej 127 mld lekë ose 66% të vlerës totale të borxhit.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë një sërë iniciativash me qëllim forcimin e funksionit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të prapambetura, me fokus në përmirësimin e kuadrit ligjor, optimizimin e proceseve të punës dhe lehtësimin e komunikimit me tatimpaguesit. Këto masa kanë synuar ndjekjen e menjëhershme të detyrimeve të reja, me qëllim parandalimin e shndërrimit të tyre në detyrime të vjetra dhe shmangien e përshkallëzimit të stokut të detyrimeve aktuale.

Nga ana e Rajoneve të Mbledhjes ka vijuar zbatimi i procedurave të komunikimit me tatimpaguesit, me synim nxitjen e vetëpërmbushjes vullnetare të detyrimeve të papaguara, si dhe informimin e tyre mbi procedurat e mbledhjes me forcë, të cilat zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërkohë, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara pranë DPT ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e stokut të detyrimeve, ka realizuar analiza të detajuara në nivel tatimpaguesi me fokus të veçantë të detyrimet me vlerë të lartë si dhe ka ndjekur zbatimin e masave të ndërmarra në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Indikatori kyç për vlerësimin e performancës së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është **raporti i detyrimeve tatimore të mbledhura gjatë vitit N ndaj detyrimeve të shtuara në po të njëjtin vit**. Për vitin 2025, ky tregues është realizuar në nivelin 52%.

VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË

Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.

Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:

1. Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të tvsh-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
2. Të kryejë procedurën e rimbursimit të tvsh-së bazuar në analizën e riskut;
3. Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim tvsh-je është bërë:
 - nga organizatat jofitimprurëse për tvsh-në e paguar në blerje, për mallra të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit si pjesë e veprimtarisë së tyre bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme;
 - në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, në bazë të parimit të reciprocitetit për TVSH-në e paguar për blerjet brenda vendit nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre.

Baza Ligjore

Baza ligjore për rimbursimin e TVSH-së është e përcaktuar në:

1. Nenin 77 të Ligjit 92/2014 datë 27.4.2017 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH” i ndryshuar,
2. Nenin 62, 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar,
3. Nenin 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar,
4. Pikën 75/1 të Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar,
5. VKM nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, e ndryshuar,

6. Udhëzimin Nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të vecantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar,
7. “Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut” dhe
8. “Manualin për rimbursimin e TVSH-së”.

Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 77 të ligjit 92/2014 "Për TVSH-në", ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

1. Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-se nëse:
 - a) personi i tatueshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 76, të këtij ligji;
 - b) TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar tejkalon shumë prej 400 000 lekësh.

Procedura e rimbursimit është e percaktuar në nenin 75/1 të Ligjit nr. Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar dhe pikes 75/1 te Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Gjithashtu, brenda afatit ligjor 30 ditor, bazuar në nenet 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar, kryhet :

- Rimbursimi i TVSH-së për projektet e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve për projektet e kryera në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA I) dhe Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II). **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, për misionet diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare. **Neni 64**

Aktivitetet e programuara dhe realizuara për vitin 2025

Bazuar në planin e aktiviteteve për vitin 2025, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së ka realizuar aktivitetet kryesore të mëposhtme:

- I. Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së sipas afateve ligjore;
- II. Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së;
- III. Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim.

Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së sipas afateve ligjore

Ecuria e treguesve të rimbursimit për vitin 2025 është si më poshtë:

Kërkesat: Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, pranë DRTVSH-së janë regjistruar **2740 kërkesa** për rimbursim (nga **2678** kërkesa të regjistruara në 2024), me vlerë totale **45,393 milion lekë** (nga **38,760** milion lekë në 2024). Gjithsej **janë pranuar 1659 kërkesa** (nga **1652** kërkesa të pranuar në 2024), me një rritje në numër rreth 0.42% krahasuar me 2024, me vlerë **27,514 milion lekë** (nga **27,551** milion lekë në 2024), me një ulje në vlerë rreth 0.1% krahasuar me 2024, dhe **1081 kërkesa** me vlerë **17,879 milion lekë** (nga **1026** kërkesa në 2024, me vlerë **11.209** milion lekë), **nuk janë pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjore.

- Nga 1659 kërkesa të pranuar, **110 kërkesa** me vlerë **853 milion lekë** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues me Risk Zero, kërkesa e të cileve duhet të miratohen dhe rimbursohet automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1659 kërkesa të pranuar, **845 kërkesa** me vlerë **8,437 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1659 kërkesa të pranuar, **704 kërkesa** me vlerë **18,224 milion lekë** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si jo-eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës.

Rimbursimet: Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, janë rimbursuar në total (FIFO + Këste) **25,293 milion lekë**, rreth **13.1 % më shumë se në 2024** (nga 22.363 milion lekë në rimbursuar në 2024). Janë miratuar dhe rimbursuar **1649 kërkesa** të trajtuara sipas metodës FIFO (nga 1601 kërkesa të pranuar në 2024), me një rritje në numër rreth 2.93 % krahasuar me 2024, me vlerë totale për rimbursim **27,678 milion lekë** (nga **24.931** milion lekë në 2024) me një rritje në vlerë rreth 11 % krahasuar me 2024. Të gjitha kërkesat FIFO të miratuara për periudhën Janar - Dhjetor 2025 janë rimbursuar në kohë.

Pjesa më e madhe vlerës së rimbursuar (rreth 61.65%) është dhënë për tatimpaguesit e DTM

Nr.	Rimbursuar sipas DRT-ve (000 leke)		
	DRT Tatimore	Numri i Kërkesave	Vlera e Rimbursuar
1	BERAT	65	227,845

2	DIBER	32	646,898
3	DURRES	372	1,604,459
4	ELBASAN	91	411,578
5	FIER	135	853,205
6	GJIROKASTER	39	139,927
7	KORCE	92	309,439
8	KUKES	17	121,196
9	LEZHE	34	100,897
10	SARANDE	29	210,814
11	SHKODER	83	272,044
12	TIRANE	344	4,309,717
13	DTM	221	15,593,662
14	VLORE	84	491,103
TOTALI		1638	

Koha e Rimbursimit: Në lidhje me kohën e procesimit (koha mesatare e miratimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së, nga data e kërkesës deri në datën miratimit të kërkesës), për periudhën Janar - Dhjetor 2025, janë miratuar dhe rimbursuar **1649 kërkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka qenë **31 ditë**, nga **31 ditë** që ishte për 2024, ku **56 %** të kërkesave janë procesuar brenda **30 ditëve**. Rreth **43 %** e kërkesave janë procesuar brenda afatit **60-ditore**.

Duhet theksuar se **1 %** e kërkesave janë procesuar mbi **120 ditë** dhe kryesisht arsyeja ka qenë mospagimi i detyrimeve për “**1900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**”, nga ana e tatimpaguesve.

Stoku me 31.12.2025: Stoku i rimbursimeve për kërkesat e miratuara dhe të pa likujduara nga administrata tatimore në date 31.12.2025 si më poshtë:

DRT	Nipti	Subjekt	Lloji aktivitetit	Stoku 31.12.2025	Komente
Durres	L82320501j	OCCHIO VIVO	EKSPORTUES	6,256,131	ceshtje teknike
DTM	K43128401L	BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD	Eksportues	1.411.597.480	Pezulluar subjekt nen hetim

Administrata Tatimore i qëndroi objektivit që kishte në fillim të vitit 2025 duke mbajtur stokun e rimbursimit të TVSH-së në mbyllje të vitit 2025. Gjithashtu, kërkesat FIFO u rimbursuan të gjitha në afat duke mos krijuar stok në fund të këtij tremujori.

Kërkesat në proces: Deri në datë 31.12.2025 në Drejtorinë e Rimbursimit rezultojnë se janë në proces në total rreth **266 kërkesa** (nga 258 kërkesa që rezultojnë në 2024), me një rritje në numër rreth 3 % krahasuar me 2024 :

Kërkesat në proces të regjistruara sipas viteve		
Viti	Numri i kërkesave	Vlera e Kërkesave (000 leke)
2018	1	5
2019	2	45
2020	4	11,193
2021	4	10,522
2023	3	3,061
2024	11	1,767,718
2025	241	5,495,526
Total	266	7,288,070

Kërkesat në proces për vitin 2025 rezultojnë 186 kërkesa të aplikuara në muajin dhjetor 2025 ndërsa pjesa tjetër rezultojnë për detyrimet e Sigurimeve Shoqërore dhe në proces kontrolli.

- I. Ndryshime Neni 10 ”Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së”;

Në Zbatim të Planit Operacional 2021 DRTVSH paraqiti propozimet për ndryshimet të Nenit 10 ”Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së”, në VKM Nr. 953 datë 29.12.2014 ”Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, për të thjeshtuar dhe saktësuar kategoritë e eksportuesve si edhe afatet respektive të rimbursimit, mbështetur edhe në rekomandimet e KLSH-se.

Domosdoshmëria për saktësimin e nenit 10 të VKM të sipërcituar, erdhi si nevojë e:

- Zbatimit të rekomandimeve të FMN për të lehtësuar kategorinë e eksportuesve për të dhënë rimbursimin e TVSH-së automatikisht pa procedure kontrolli për kategorite pa risk;
- Zbatimit të rekomandimeve/gjetjeve të auditit të KLSH-së për vitin 2018 dhe 2019 ku shprehin paqartësi në kategorizimin e kërkesave të bëra nga personat eksportues të klasifikuar me Risk Zero;

- Implementimit të platformës dixhitale të rimbursimit të TVSH-së, e cila e do automatizojë të gjithë procesin duke shmangur shkëmbimin apo/dhe dorësimin shkresor të dokumentacionit siç parashikohet në nenin 10 të VKM-së aktuale, pika 1, gëra C;
- Legjitimitit të përfshirjes së elementëve të hetimit tatimor, me propozim nga MFE, në analizën e riskut të përcaktuar në rregulloren e rimbursimit.

Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së

Në zbatim të urdhërit Nr. 28, datë 08.04.2020, nr. 6380 Prot, në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së çdo tre muaj përgatit dhe publikon një raport të detajuar statistikor lidhur me ecurinë e procesit të rimbursimit për tremujorin për treguesit:

- Numrin e përgjithshëm të kërkesave të trajtuara;
- Numrin e kërkesave të refuzuara;
- Vlera e rimbursimeve të ndara sipas tatimpaguesve me këste dhe FIFO;
- Stoku i rimbursimeve i detajuar sipas tatimpaguesve me këste dhe të tjerë.

Publikimi ka vijuar sipas planit, në website e DPT.

Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim

Platforma dixhitale e rimbursimit e cila u vendos në funksion në fillim të vitit 2022, ka ulur kohën e trajtimit të kërkesave duke garantuar trajtimin sipas radhës dhe ka mundur gjurmimin e kërkesës në çdo kohë dhe llogaritjen e kamatvonesave (interesit) për kërkesat e miratuara dhe të pa rimbursuara në kohë. Gjatë vitit 2025 janë mbajtur komunikime me kompaninë zhvilluese lidhur me implementimin e platformës.

Rimbursimi i TVSH-së sipas projekteve e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi.

Në zbatim të këtij neni të Ligjit, në nenet 63/1 dhe 63/2 të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Per Tatimin mbi vlerën e shtuar” është parashikuar procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit / grantit me donatorët dhe granteve nga Bashkimi Evropian.

IX. DREJTORIA E VERIFIKIMIT DHE KOORDINIMIT NË TERREN NË DPT

Organizimi

Drejtorja e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT), është e organizuar dhe ushtron veprimtarinë funksionale në zbatim të Urdhërit Nr.69, datë 26.05.2023 i Kryeministrit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”.

Qëllimi

Parandalimi, ndërgjegjësimi, evidentimi dhe goditja e paligjshmërisë në fushën e tatim-taksave për tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Goditja e evazionit fiskal dhe marrjen e masave administrative përkatëse.

Objektivat:

- Garantimi i përmbushjes vullnetare dhe zbatimi i legjislacionit tatimor;
- Realizimi i detyrave funksionale për kontrollet në terren;
- Trajtimi i listave të ardhura nga Sekretariati i Komitetit të Riskut dhe nga Drejtorja e Menaxhimit të Riskut;
- Përpunimi, analiza dhe ndjekja e listave të tatimpaguesve sipas objektit të ardhur nga Drejtorja e Menaxhimit të Riskut;
- Verifikimi i tatimpaguesve sipas sektorëve që do të klasifikohen me risk nga Sektori i Analizës dhe Informacionit;
- Mbledhja, analizimi, shpërndarja dhe trajtimi i ankesave të ardhura pranë Sektorit të Trajtimit të Ankesave;
- Ezaurimi i shkresave të ndryshme dhe trajtimi i emaileve të ardhura në drejtori;
- Bashkëpunime me struktura të tjera ligjzbatuese.


Realizimet:

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren gjatë vitit 2025 ka arritur rezultatet si më poshtë vijon:


- 2317 kontrolle me 2215 shkelje në vlerën 149.316.882
- 1390 verifikime ku përfshihen trajtimi shkresave me lëndë “Kërkesë për cregjistrim, pezullim aktiviteti, kalime në status pasiv etj” të cilat nuk janë arritur të identifikohen ose janë gjendur mbyllur.

DVKT	Kontrolle	Shkelje	Vlerë
DPT	451	404	23.560.000
Rajoni Jugor	310	312	15.610.000
Rajoni Qendror	1473	1.447	108.976.882
Rajoni Verior	83	52	1.170.000
Total	2.317	2.215	149.316.882

Rezultatet totale të kontrolleve dhe shkeljeve të kryera për periudhën **Janar – Dhjetor 2025** sipas grafikut:




Grafiku 1: Kontrollat dhe Shkeljet e DVKT-së



Grafiku 2: Vlera e Shkeljeve sipas DVKT-ve

Shkeljet kryesore për periudhën **Janar- Dhjetor 2025** renditen, të evidentuara sipas llojit si më poshtë:

- **540** tatimpagues janë penalizuar për moslëshim të faturës tatimore;
- **443** tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor;
- **300** tatimpagues janë penalizuar për moslëshim autofature;
- **198** tatimpagues janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padeklaruar;
- **156** njësi kompjuterike të sekuestruara të 85 tatimpagues;
- **113** tatimpagues janë penalizuar për mospërditësim të dhënash;
- **97** tatimpagues të penalizuar për mosinstalim të sistemit të fiskalizimit;
- **96** subjekte të paregjistruara në organin tatimor;
- **75** tatimpagues për mosmbajtje dokumentacioni tatimor;
- **54** tatimpagues për mosafishim të listës së cmimeve;
- **49** tatimpagues janë penalizuar për zhblokim aktiviteti pas regjistrimit;
- **29** tatimpagues janë konstatuar se nuk ishin të pajisur me çertifikatë elektronike;
- **65** shkelje të tjera të legjislacionit tatimor të konstatuara.



Grafiku 3: Shkeljet kryesore të DVKT-së

➤ **Rezultate të ndara sipas objektit të punës:**

Objekti punës	Kontrolle	Shkelje	Vlerë
Listë DMR	404	657	56.410.000
Listë Komiteti Riskut	91	78	3,420,000
TP tregtim prod. blegtorale/bujqësore	353	582	48.191.882
Rast Abuziv/Ankesë	625	432	19,520,000
Portali bashkëqeverisjes	40	23	700,000
Bashkëpunim me strukturat e tjera ligjzbatuese	138	179	11.105.000
Trajtim emaili/shkresë	606	213	7.585.000
Verifikim i subjekteve të bllokuara	60	51	2,385,000
TOTAL	2317	2215	149,316,882

- Gjatë vitit 2025 rezultojnë 849 shkresa hyrëse, të cilat janë trajtuar nga Drejtoria e Verifikimit në Terren sipas lëndës së përcaktuar.

Verifikime në kuadër të Sezonit Turistik 2025 (Qershor-Shtator 2025):

DVKT	Verifikime	Nr shkelje	Vlerë	Efektiviteti	Sekuestrim njesi kompjuterike
DPT	254	287	16,940,000	113%	32
Rajoni Qendror	379	539	50,515,000	142%	52
Rajoni Jugor	43	45	1,835,000	105%	
Rajoni Verior	4	2	50,000	50%	
Totali	680	873	69,340,000	128%	84

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren gjatë sezonit turistik për periudhën Qershor-Shtator 2025 ka kryer **680** verifikime ku janë evidentuar **873** shkelje të legjislacionit tatimor në vlerën prej **69.340.000** lekësh, nga ku:

- Janë sekuestruar gjithsej 84 njësi kompjuterike në 64 subjekte.
- Janë bllokuar 8 subjekte për moslëshim fature hera e dytë.
- Është kryer një pengim kontrolli.

Denoncime/Ankesa

Gjatë vitit 2025, Sektori i Trajtimit të Ankesave (STA) në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), ka ushtruar një rol thelbësor në garantimin e të drejtës së qytetarëve për ankim, denoncim dhe informim, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet administratës tatimore dhe publikut.

Veprimtaria e STA-së ka qenë e përqendruar në trajtimin e denoncimeve për evazion fiskal, administrimin e rasteve të ardhura përmes platformës Bashkëqeverisja, si dhe në ofrimin e ndihmës së vazhdueshme dhe profesionale për qytetarët përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.

1. Trajtimi i ankesave dhe denoncimeve për evazion fiskal

Një nga drejtimit kryesore të punës së STA-së gjatë vitit 2025 ka qenë administrimi i ankesave dhe denoncimeve për evazion fiskal, të cilat përfaqësojnë një instrument të rëndësishëm në luftën kundër informalitetit dhe shkeljeve të legjislacionit tatimor.

Gjatë vitit 2025 janë trajtuar në total 720 raste nga të cilat 671 raste abuzive të regjistruara nga STA dhe 49 raste të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes, të cilat përbëjnë ankesa dhe denoncime për shkelje të ndryshme të legjislacionit tatimor, të paraqitura nga qytetarë, punëmarrës dhe subjekte të ndryshme. Këto raste kanë ardhur përmes kanaleve të ndryshme zyrtare dhe janë administruar sipas procedurave në fuqi, duke përfshirë:

- Regjistrimin dhe evidentimin e rastit,
- Verifikimin paraprak të informacionit të paraqitur,
- Orientimin drejt strukturave përkatëse për ndjekje të mëtejshme,
- Monitorimin e trajtimit të rastit brenda afateve ligjore.

Denoncimet kanë qenë të fokusuara kryesisht në:

- Mosdeklarim ose deklarim të pjesshëm të të ardhurave,
- Moslëshim të faturës tatimore;
- Punonjës të padeklaruar;
- Paga të deklaruara nën nivelin real;
- Punësim informal dhe shkelje të detyrimeve tatimore e kontributive;
- Subjekte të paregjistruara;
- Mospajisje me procesin e fiskalizimit;
- Evazion fiskal;
- Etj.

Më poshtë po i paraqesim në formatin e një tablele rastet totale të vitit 2025:

Nr.	Forma e marrjes së denoncimit	Nr i denoncimeve të ardhura	Të ezauruara	Në proces verifikimi nga DVKT
1-	Raste Abuzive (Janar – Dhjetor)	671	624	47
2-	Bashkëqeverisja (Janar – Dhjetor)	49	49	--
	TOTALI	720	673	47

Përsa i takon 671 rasteve të administruara përmes kanaleve të komunikimit me STA paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Forma e marrjes së denoncimit	Nr i denoncimeve të ardhura	Të ezauruara	Në proces verifikimi nga DVKT
1-	Me Telefon	178	166	12
2-	Me Email nga: 1) Zyra e shtypit DPT, 2) DIBA, 3) DVKT Rajonet, 4) Qytetarët, 5) Institucione të Ndryshme	400	367	33
3-	Me Shkresë me nr.prot nga DPT	75	73	2
4-	Me Takim në ambjentet e DVKT-së	18	18	0
5-	Platforma e Bashkëqeverisjes	49	49	0
6-	Totali	720	673	47

Raste të administruara përmes Platformës së Bashkëqeverisjes

Krahas denoncimeve të drejtpërdrejta, STA ka trajtuar edhe 49 raste të ardhura përmes Platformës së Bashkëqeverisjes, të cilat përbëjnë ankesa dhe kërkesa të qytetarëve të adresuara ndaj administratës tatimore.

Këto raste janë ndjekur me prioritet, duke përfshirë:

- Analizimin e problematikës së paraqitur,

- Komunikimin me qytetarin për sqarime shitesë,
- Koordinimin me strukturat përgjegjëse për zgjidhjen e çështjes,
- Dhënien e përgjigjes përfundimtare brenda afateve të përcaktuara.

Trajtimi i këtyre rasteve ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

[Ndihmesa për qytetarët përmes kanaleve të komunikimit](#)

4.1 Linja e Gjelbër 0800 14 14

Një pjesë shumë e rëndësishme e veprimtarisë së STA-së gjatë vitit 2025 ka qenë ofrimi i ndihmës së vazhdueshme për qytetarët përmes Linjës së Gjelbër 0800 14 14. Përmes kësaj linje është administruar një numër i lartë telefonatash, përmes të cilave qytetarët kanë kërkuar informacion, sqarime dhe orientim mbi çështje të ndryshme tatimore dhe administrative.

Linja e Gjelbër ka shërbyer si mjet kryesor për:

- Sqarimin e detyrimeve dhe të drejtave tatimore,
- Orientimin për procedurat e denoncimit të evazionit fiskal,
- Udhëzimin për përdorimin e sistemeve elektronike të administratës tatimore’
- Zbatimin e Legjislacionit Tatimor.

4.2 Email-i zyrtar denoncime@tatime.gov.al

Paralelisht me komunikimin telefonik, STA ka administruar edhe një numër të konsiderueshëm komunikimesh përmes email-it zyrtar denoncime@tatime.gov.al. Ky kanal ka shërbyer kryesisht për:

- Paraqitjen e denoncimeve të detajuara për shkelje të ndryshme të legjislacionit tatimor,
- Dërgimin e dokumentacionit mbështetës (vendndodhje, foto të bizneseve, fatura jotatimore etj),
- Komunikimin e vazhdueshëm me qytetarët për ndjekjen e rasteve të tyre.

Përdorimi i këtij kanali ka mundësuar trajtim më të strukturuar dhe të dokumentuar të rasteve.

Orientimi i qytetarëve për çështje të punësimit dhe pagave reale

Një aspekt me rëndësi të veçantë i punës së STA-së gjatë vitit 2025 ka qenë orientimi i qytetarëve për nënshkrimin e kontratave të punës me paga reale, si një element kyç në mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe në luftën kundër informalitetit.

STA ka ofruar:

- Informacion mbi detyrimin ligjor për deklarimin e pagës reale,
- Sqarime mbi pasojat e deklarimit fiktiv të pagave,
- Orientim për hapat që duhen ndjekur nga punëmarrësit në rast shkeljesh,
- Këshillim për mënyrën e denoncimit të rasteve të abuzimit,
- Informacion mbi personat e dypunësuar dhe të punëmarrësve me të ardhura mbi 1.2 milion lekë në vitë, ndaj të cilëve lindin detyrime për plotësimin e DIVA,
- Informacion mbi zbatimin e legjislacionit tatimor si dhe në respektim të bashkëpunimit dhe shërbimit të administratës tatimore ndaj qytetarit/biznesit.

Asistenca për deklarata të ndryshme tatimore, procesin e fiskalizimit dhe procedura të tjera me Administratën Tatimore.

STA ka ofruar gjithashtu ndihmë të vazhdueshme për qytetarët dhe subjektet lidhur me:

- Dorëzimin e deklaratave DIVA,
- Procesin e fiskalizimit,
- Sqarime mbi procedurat elektronike (fiskalizimi dhe e-feling) dhe afatet përkatëse.
- Orientim lidhur me procedurën e bllokimit-zhblokimit të llogarive bankare si pasojë e bllokimit nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Kjo asistencë ka qenë veçanërisht e rëndësishme për qytetarët dhe subjektet me njohuri të kufizuara digjitale, duke lehtësuar përmbushjen korrekte të detyrimeve tatimore.

Raste Abuzive të kaluara për ndjekje/procedurë DHT në DPT.

Përgjatë vitit 2025 sektori i STA në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve pas vlerësimit të materialit/denoncimit pas siglimit nga Drejtori i Drejtorisë së DVKT në DPT i ka kaluar për ndjekje/procedurë më të thelluar Drejtorisë së Hetimit Tatimor 14 raste abuzive.

Vlerësim i përgjithshëm dhe përfundime

Lidhur me denoncimet të cilat janë ezauruar nga strukturat përkatëse janë vendosur penalitete dhe veprime të tjera proceduriale sipas legjislacionit tatimor sipas tabelës si vijon :

Nr.	Lloji i penalitetit	Nr i penaliteteve të vendosura	Vlera
1-	Bllokim aktiviteti	31	Për tu updatuar
2-	Mosdeklarim punonjësi	52	5.675.000
3-	Moskryerje fiskalizimi,	26	925.000
4-	Mosmbajtje dokumentacioni, mospërditësim të dhënash, mosmbajtje e saktë dokumentacioni	64	745.000
5-	Moslëshim fature, autofature, biletë,	129	4.620.000
6-	Mosrinovim Çertifikate nga AKSHI, mosmbajtje gjendje pune pajisje fiskalizimi,	16	550.000
7-	Riaktivizim Nipti,	2	-
8-	Mall pa faturë,	47	5.725.000
9-	Mosafishim listë çmimesh, çmime ndryshe nga të afishuarat,	9	600.000
10-	Sekuestrim, njesi kompjuterike etj	18 subjekte 38 njesi	-
	TOTALI I GJOBAVE	376 Penalitete + 38 njesi kompjuterike	18.840.000 Lekë

Gjatë vitit 2025, Sektori i Trajtimin të Ankesave në DVKT pranë DPT ka zhvilluar një veprimtari intensive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e marrëdhënieve administratë–qytetar në përmbushje të zbatimit sa më korrekt të legjislacionit tatimor. Trajtimi i 720 denoncimeve për shkelje të ndryshme në fushën e legjislacionit tatimor, administrimi i rasteve nga Platforma e Bashkëqeverisjes, si dhe ndihmesa e vazhdueshme përmes Linjës së Gjelbër dhe email-it zyrtar, dëshmojnë angazhimin e sektorit për një administratë më transparente, më të aksesueshme dhe më efektive.

Roli orientues i STA-së në çështje të ndjeshme si kontratat e punës me paga reale, dorëzimi i deklaratave tatimore, fiskalizimi dhe zbatimin në tërësi të legjislacionit tatimor, e pozicionon këtë sektor si një strukturë kyçe në luftën kundër informalitetit dhe në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar. Ky rol ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe bizneseve si dhe në forcimin e zbatimit të legjislacionit tatimor.

X. MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Hyrje

Përshkrim i shkurtër i DMJMP

Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve (DMJMP) është në varësi të zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DMJMP organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtarë, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare, siguron harmonizimin dhe koordinimin e të gjitha projekteve me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohen në Administratën Tatimore Shqiptare dhe që ndërlidhen me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare, koordinon procesin raportues në kuadrin e detyrimeve për integrimin në strukturat e BE-së.

Detyrat funksionale

Detyrat funksionale të DMJMP-së janë:

- Propozon dhe harton kërkesat për asistencë ndërkombëtare.
- Analizon dhe kontrollon ecurinë e projekteve që zhvillohen në DPT.
- Siguron mbarëvajtjen e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe të administratës tatimore me organizmat e huaja.
- Raporton lidhur me proceset e integritit të vendit në BE në strukturat e linjës, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit European.
- Bashkërendon punën me Drejtoritë e tjera në DPT dhe Drejtoritë Rajonale për pjesëmarrjen e personelit të administratës tatimore qendrore në programet dhe trajnimet e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare si dhe në vizitat e kryera në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Struktura

DMJMP përbëhet nga 1 Drejtor + 2 përgjegjës sektori + 5 inspektorë/specialistë.

Stafi aktual

- Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë: 1 përgjegjës sektori, 2 specialistë; 0 vende vakante
- Sektori i Menaxhimit të Projekteve dhe Implementimit: 1 përgjegjës sektori; 3 inspektorë; 0 vende vakante.

Objektivat për vitin 2025

Objektivat strategjikë të DMJMP

Objektivi strategjik 3: Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

3.1 Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

3.4 Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

Treguesit kryesore të performancës

- Kontribut në grupin e punës të ngritur për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Koordinimi i punës me Drejtoritë e përfshira në vitin e 3-të të projektit të asistencës së ofruar nga administrata tatimore e Suedisë.
- Përmirësimi i njohurive të stafit, përmes pjesëmarrjes sa më të gjerë në trajnimet e organizuara nga organizatat ndërkombëtare, vizitave studimore në administratat homologe apo sjelljes së ekspertëve të huaj të fushave të caktuara.
- Menaxhimi dhe koordinimi i kontributit të DPT në procesin e integritetit në BE.

Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2025 në funksion të realizimit të objektivave.

Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë

- Koordinimi, marrja e informacionit dhe përgatitja e materialeve raportuese në kuadrin e detyrimeve për integrimin në strukturat e BE-së për Kapitullin 16 “Tatimet”.
- Koordinimi, marrja e informacionit dhe përgatitja e materialeve raportuese në kuadrin e detyrimeve për integrimin në strukturat e BE-së për Kapitullin 33 ”Dispozitat financiare dhe Buxhetore”; Kriterin Ekonomik; nënkomitetet “Për çështjet ekonomike, financiare dhe statistika” (ECOFIN), “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet - (TIDT)”, *Reform and Growth Facility 2024-2027*, etj.
- Organizimi i trajnimeve ndërkombëtare për stafin AT, ofruar nga partneret e huaj IOTA, CEF, OECD, etj. (Organizuar 40 trajnime *online* dhe fizike).
- Mbledhje e informacionit nga Drejtoritë përkatëse në DPT, plotësimi dhe dërgimi i pyetësorit ISORA.
- Ndjekja e proceseve të Vlerësimeve të OECD-së për vlerësimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave.
- Bashkëpunimi me Drejtoritë e përfshira në DPT për hartimin e legjislacionit përkatës të transpozimit të Direktiva BE për shkëmbimin e informacionit.

Sektori i Menaxhimit të Projekteve dhe Implementimit

- Koordinimi i punës për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Menaxhimi dhe ndjekja e dy projekteve
 - (1) Projekti i Bashkëpunimit me Administratën tatimore Suedeze dhe
 - (2) Projekti i Bashkëpunimit me Qeverinë Britanike UC-SATA - Unlocking Change: Strengthening Albania’s Tax Administration
- Koordinimi dhe ndjekja e detyrave lidhur me të dyja projektet e asistencës, me të gjitha strukturat e përfshira në DPT/DRT.
- Organizimi dhe koordinimi në DPT i angazhimeve lidhur me asistencën nga FMN dhe organizma të tjerë (Banka Botërore, FMN, etj.).

- Koordinimi i punës (me Drejtoritë e përfshira në DPT) për certifikimin e DPT me ISO 27001.

Sa dhe si ndikuan këto aktivitete në arritjen e objektivave të përcaktuara.

U përmbyll viti i tretë i zbatimit të projektit 3-vjeçar të bashkëpunimit me Suedinë. Ky Projekt kontribuon drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve të administratës tatimore, duke dhënë asistencë teknike për 5 Komponentët: Kultura e integritetit, Kontrolli, Menaxhimi i Riskut CRM, Proceset e Biznesit & AEOL.

Aktivitetet përgjatë vitit të 3-të të projektit:

- **Vizita studimore e menaxhimit të lartë në STA, në Stokholm në shkurt 2025**
- **Seminar rajonal** mbi kontrollin dhe menaxhimin e riskut të pajtueshmërisë, në Tiranë, prill 2025
- **Webinar dypalësh për shkëmbim njohurish** - Në prill 2025 u organizua një seminar online dypalësh ndërmjet Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Shqipërisë, i cili mundësoi shkëmbim njohurish mbi operacionet e call center-it ndërmjet dy administratave tatimore.
- **Webinar mbi fiskalizimin në Shqipëri, në maj 2025.** Administrata tatimore shqiptare prezantoi zbatimin e fiskalizimit në Shqipëri, për Agjencinë Tatimore Suedeze. Prezantimi theksoi përmirësimin e mbledhjes së TVSH-së, uljen e informalitetit, faturimin elektronik në kohë reale dhe forcimin e pajtueshmërisë, si dhe aspekte kyçe të zbatimit, si bashkëpunimi me ofruesit e software-ve dhe komunikimi me bizneset.
- DPT dhe STA realizuan tre aktivitete prioritare që u fokusuan në dilema korrupsioni, sfida në rolin e Auditit të Brendshëm dhe kontributin e auditit/këshillimit në luftën kundër korrupsionit. seminarët prodhuan njohuri të përbashkëta dhe mjete praktike të mbështetura në Standardet Globale të Auditit të Brendshëm.
- 7 Misione fizike në Tiranë
- Mbledhja vjetore e Komitetit Drejtues, do të zhvillohet në datë 2 Shkurt 2026.

Rezultatet konkrete dhe produktet më të rëndësishme të këtij Projekti përmendim:

- U hartua dhe miratua Plani Integritetit për DPT dhe Drejtoritë Rajonale (Dhjetor 2024)
- Është zhvilluar shërbimi elektronik, "Tax Test" për informimin e tatimpaguesve për DIVA.
- **Një sondazh i dytë u zhvillua në prill–maj 2025,** “ *Citizens and Business Survey about Taxes* “ *me fokus parësor nevojat e tatimpaguesit; kjo punë prodhoi bazën e prokurimit për një përmirësim teknik dhe sqaroi ndikimet organizative.*
- Në kuadër të Shërbimit tatimpaguesve, STA ka përfunduar procedurat e tenderimit për një **software të ri për Call Center.** Software është **instaluar në Drejtorinë e Call Centerit,** pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë.
- Në kuadër të Kulturës së Integritetit, janë zhvilluar trajnime edukuese me stafin në Drejtoritë Rajonale Tatimore në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë , Berat, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës, etj. mbi Planin e Integritetit, Kodi Etikës, Sinjalizuesit dhe Konflikti Interesit në Administratën Tatimore.

XI. BUXHETI DHE FINANCA

XII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I BRENDSHËM

Në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, për Sektorin e Shërbimeve të Brendshme janë ndjekur Kontratat e Dokumentacionit Tatimor të cilat janë realizuar deri me 31.12.2025 si më poshtë:

Realizimi i kontratës për vitin 2025 të biletave të transportit rrugor me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Mbetja	Realizimi në %
1	Bileta Transporti Urban 50 lekeshe	copë	3.000.000	3.000.000	0	100%
2	Bileta Transporti Urban 40 lekeshe	copë	76.430.000	50.000.000	26.430.000	65.5%
3	Bileta Transporti Urban 30 lekeshe	copë	1.260.000	900.000	360.000	71.5%
Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Mbetja	Realizimi në %
1	Bileta të Pajtimit Mujor (Abone)	copë	1.729.154	1.605.150	124.004	93%

Realizimi i kontratave për vitin 2025 të pullave të taksës dhe tarifës me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"

Emërtimi	Sasia ne kontrata	Tërhequr (Realizimi)	Pa realizuar	Realizimi në %
Pulla takse 50 leke	578.000	293.400	284.600	50.7%
Pulla tarife 750 leke	34.200	20.160	14.040	58.9%
Pulla takse 100 leke	602.000	557.100	44.900	92.5%
Pulla tarife 200 leke	1.380.600	1.324.800	55.800	96%
Pulla tarife konsullore 200 leke	680.000	510.000	170.000	75%
Pulle konsullore 1 euro	3.400	0	3.400	0%
Pulle konsullore 5 euro	8.500	0	8.500	0%
Pulle konsullore 10 euro	17.000	0	17.000	0%
Pulle konsullore 20 euro	17.000	0	17.000	0%
Pulle konsullore 30 euro	34.000	34.000	0	100%

SEKTORI I PROKURIMEVE

Në zbatim të ligjit të buxhetit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitin 2025”, të Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetin e vitin 2025”, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu II, Neni 3, bashkëlidhur.

Ju bëjmë me dije ecurinë e realizimit të procedurave të prokurimit dhe realizimin e dokumentacionit tatimor deri më datë 31.12.2025.

Bazuar në parashikimet e regjistrit të prokurimeve të vitit 2025, deri në 31.12.2025, janë realizuar dhe mosrealizuar procedurat e mëposhtme:

1. Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.

Kontratë e nënshkruar me Operatorin Ekonomik “Vilnik Motors” sh.p.k me vlerë ekonomike 4,663,920 lekë me TVSH.

2. Blerje goma për automjete për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Kontratë e nënshkruar me Operatorin Ekonomik “SPARKLE 32” sh.p.k me vlerë ekonomike 1,850,025 lekë me TVSH.

3. Blerje karburant (Naftë)

Kontratë e nënshkruar me BOE “Kastrati Energy” sh.p.k dhe “Kastrati Energy Trade” sh.p.k me vlerë ekonomike 12.511.908 lekë

4. Materiale kancelarie të tjera zyre

Kontratë e nënshkruar me operatorin ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k me vlerë ekonomike 2.178.448 lekë

5. Blerje materiale pastrimi

- a) Me Operatorin ekonomik “Solid Group” sh.p.k me vlerë ekonomike 541.666 lekë

- b) Me operatorin ekonomik “XHNSH” sh.p.k me vlerë ekonomike 379.693

6. Shpenzime për siguracionin e automjeteve

Kontratë e nënshkruar me operatorin ekonomik “Insig” sh.a me vlerë ekonomike 435.725 lekë

7. Shpenzime për Udhëtime bileta jashtë vendi

a) Ideal Travel&Tours me vlerë ekonomike 42.300 lekë

b) Amadeus Travel & Tours me vlerë ekonomike 99.800 lekë

c) 2 Feleqi me vlerë ekonomike 75.770 lekë

d) Amadeus Travel & Tours me vlerë ekonomike 74.300

e) Amadeus Travel & Tours me vlerë ekonomike 131.500 lekë

f) One Explorer me vlerë ekonomike 110.000

g) Amadeus Travel & Tours me vlerë ekonomike 87.000

h) One explorer me vlerë ekonomike 325.500

i) Explorer Journey me vlerë ekonomike 27.500

8. Shpenzime për pritje përcjellje me vlerë ekonomike 795.308 lekë

9. Blerje libra protokolli me operatorin ekonomik “IT Store” sh.p.k me vlerë ekonomike 95.000 lekë

10. Shpenzime për mirëmbajtjen e godinës me operatorin ekonomik “Altec” sh.p.k me vlerë ekonomike 770.000 lekë

11. Shpenzime për mirëmbajtjen e kondicionerëve me operatorin ekonomik “Altec” sh.p.k me vlerë ekonomike 675.000 lekë

12. Shpenzime për larjen e automjeteve me operatorin ekonomik “Mara INT &Services” sh.p.k me vlerë ekonomike 240.000 lekë,

13. Qira operationale (pajisje elektronike, printera) me operatorin ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k me vlerë ekonomike 5,446,599 lekë

14. Shpenzime për transport aktive me operatorin ekonomik “Misin Metalia” p.f me vlerë ekonomike 60.000 lekë
15. Shpenzime për mirëmbajtje Alpha Ëeb me operatorin ekonomik “Instituti i Modelimeve në Biznes” me vlerë ekonomike 98.206 lekë
16. Shpenzime për kolaudim fikëse zjarri me operatorin ekonomik “HSE Plus” me vlerë ekonomike 91.800 lekë
17. Shpenzime për materiale të loguara me operatorin ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k me vlerë ekonomike 700.000 lekë
18. Punime Hidraulike me operatorin ekonomik “Arkad Iljazi” me vlerë ekonomike 15.000 lekë
19. Riparim automjet AA422 PS Formulari nr. 4 (rastet e emergjencës) me operatorin ekonomik “Mitat Lika” me vlerë ekonomike 100.080 lekë
20. Riparim automjet AA962 PV Formulari nr. 4 (rastet e emergjencës) me operatorin ekonomik “Dhurim Demiri” me vlerë ekonomike 83.000 lekë
21. Shpenzime për heqje mbetjesh dhe transport me operatorin ekonomik “Astrit Loshi” me vlerë ekonomike 28.128 lekë
22. Shpenzime për blerje hard disk 10TB me operatorin ekonomik “Gleni SL” me vlerë ekonomike 120.000 lekë
23. Shpenzime për blerje materiale për IT për Drejtorinë e Administrimit të të Dhënave me operatorin ekonomik “Gleni SL” me vlerë ekonomike 120.000 lekë
24. Shpenzime për blerje karrige rrotulluese me operatorin ekonomik “Dromeas Albania” sh.p.k me vlerë ekonomike 53.000 lekë
25. Shpenzime për blerje kabine për roje me operatorin ekonomik “AAEKK” sh.p.k me vlerë ekonomike 80.000 lekë.
26. Shpenzime për blerje vula për institucionin me Aparati i Drejtorisë së Policisë me vlerë ekonomike 10.800.

XIII. DIBA

Në lidhje me masat e mëtejshme me qëllim parandalimin dhe goditjen e rasteve korruptive, bazuar dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për Procedurat Tatimore në RSH*”, (i ndryshuar), Neni 105/1 i tij, dhe akteve të tjera nënligjore dalë në zbatim të tij, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT, gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2025, ka kryer verifikimin dhe investigimin për **27 (njëzet e shtatë)** raste të denoncuar, nga këto:

- **24 (njëzet e katër)** çështje janë regjistruar dhe investiguar.
- **7 (shtatë)** çështje kanë rezultuar me shkelje administrative gjatë kryerjes së detyrave funksionale, ku përfshihen gjithsej **18 (tetëmbëdhjetë)** punonjës të Administratës Tatimore të cilët janë konstatuar me shkelje administrative dhe janë referuar në Komisionin e Disiplinës në DPT.
- **3 (tre)** nga çështjet e regjistruar gjatë vitit 2025, janë në proces investigimi dhe kanë kaluar në regjistrin e vitit 2026.

Gjithashtu, në lidhje me informacionet e ardhura për ndjekje nga burime të ndryshme të informimit në Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT, janë gjithsej **3 (tre)** raste të verifikuara/investiguara, të cilat nuk përmbajnë dhe nuk plotësojnë kushtet e mjaftueshme për t’u regjistruar si çështje.

XIV. DREJTORIA E KONTROLLIT TE SPECIALIZUAR

Hyrje

Që nga muaji Nëntor 2020, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka hartuar dhe zbatuar strategjinë e përmbushjes për individët me të ardhura të larta, e cila vijon të zhvillohet edhe gjatë vitit 2025. Kjo strategji mbështetet në dy shtylla kryesore: Menaxhimin e Riskut të Përmbushjes (MRP) dhe Kontrollin Tatimor, me fokus nxitjen e përmbushjes vullnetare dhe rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve administrative.

Duke qenë se menaxhimi i riskut për këtë kategori individësh përfaqëson një fushë të specializuar për administratën tatimore, vijon të zbatohet një qasje e bazuar në udhëzimet dhe rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Gjatë vitit 2025, aktivitetet e Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar realizohen në përputhje me objektivat strategjike të administratës tatimore dhe me Planin Operacional 2025.

Aktivitetet kryesore për vitin 2025 përfshijnë:

- Plani i Përmbushjes për Individët me të Ardhura të Larta, Viti 2024;
- Analiza e Riskut dhe Ndërtimi i Planit të Veprimeve për Kontrollin e 100 Individëve, referuar të dhënave nga palë të treta.

Struktura organizative

Drejtorja e Kontrollit të Specializuar bën pjesë në organigramën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Funksioneve Operacionale.

Sipas strukturës organizative, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar është e organizuar në 2 (dy) sektorë, si më poshtë:

- Sektori i Analizës së Riskut dhe Procesi i Përzgjedhjes së Individit; dhe
- Sektori i Kontrollit të Individit.

Sektori i Analizës së Riskut dhe Procesi i Përzgjedhjes së Individit ka në përbërje të tij 5 (pesë) inspektorë, ndërsa Sektori i Kontrollit të Individit ka në përbërje të tij 4 (katër) inspektorë. Gjatë vitit 2025, në Sektorin e Analizës së Riskut dhe Procesi i Përzgjedhjes së Individit kanë qenë të emëruar 4 (katër) inspektorë, ndërsa në Sektorin e Kontrollit të Individit kanë qenë të emëruar 4 (katër) inspektorë.

Objekti dhe detyrat për vitin 2025

Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar është nxitja e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore nga individët me të ardhura të larta, përmes një qasjeje të bazuar në analizën e riskut dhe ndërhyrjeve të synuara.

Në kuadër të këtij objekti, detyrat kryesore të Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar përfshijnë:

- **Mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave** për individët me të ardhura të larta, të siguruar si nga sistemet e administratës tatimore ashtu edhe nga palët e treta, me qëllim mbështetjen e procesit të analizës së riskut;
- **Kryerjen e analizës së riskut të përmbushjes**, e cila përfshin identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, hartimin dhe zbatimin e strategjive të trajtimit të tyre, si dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra;
- **Zhvillimin e kontrolleve tatimore** për individët me të ardhura të larta, bazuar në rezultatet e analizës së riskut dhe prioritetet e përcaktuara;
- **Monitorimin dhe analizën e rezultateve faktike** të arritura gjatë zbatimit të strategjive të trajtimit të risqeve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe rritjen e nivelit të përmbushjes vullnetare.

Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2025

Analiza DIVA 2023

Drejtorja e Kontrollit të Specializuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, kreu analizën e të dhënave të deklaruara në DIVA 2023, me qëllim identifikimin e individëve që kanë shmangur përmbushjen e detyrimeve tatimore për vitin 2023. Në përfundim të procesit

analitik, u identifikuan dhe u dërguan për vlerësim 911 individë, për të cilët rezultuan shmangës të tatimit të paguar.

Të përmbledhur sipas DRT-ve paraqiten si më poshtë:

DRT	Numri individëve
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	44
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	27
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	28
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	69
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	44
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	10
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	10
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	45
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	30
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	11
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	53
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	510
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	30

Vlera e shmangies së tatimit të paguar është në një total prej 36.6 milion lekë, e përmbledhura sipas DRT-ve si më poshtë:

DRT	Detyrimi ulur me shume (Rubrika 4-
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	1,372,199
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	1,127,763
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	1,193,836
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	2,274,279
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	1,687,905
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	373,888
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	470,528
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	1,851,186
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	1,051,270
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	430,599
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	2,060,055
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	21,567,683
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	1,133,309
Totali	36,594,500

Plani i Përbushjes për individët, subjekt i deklarimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitin 2024

Gjatë vitit 2025 u miratua plani “**Plani i Përbushjes për individët, subjekt i deklarimit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin 2024**”, me Vendim të Komitetit Operacional nr. 46, datë 24.10.2025.

Plani kishte si qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e individëve që ishin subjekt i deklarimit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin 2024, mbi rëndësinë e respektimit të legjislacionit tatimor, duke nxitur përbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore përmes deklarimit të saktë, vetëdeklarimit dhe pagesës në kohë të tatimit.

Nëpërmjet zbatimit të këtij plani synohej:

- Përmirësimi i nivelit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale;
- Zgjerimi i bazës së tatimpaguesve individë, përmes regjistrimit të tyre në sistemin informatik tatimor.

Plani u fokusua në këto faza kryesore:

- Identifikimin e popullatës objekt i planit;
- Dërgimin e informacionit pranë Drejtorive Rajonale Tatimore përkatëse;
- Njoftimin e individëve subjekt deklarimi;
- Kryerjen e vlerësimeve tatimore;
- Monitorimin dhe raportimin e rezultateve të zbatimit të planit.

[Analiza e Riskut dhe Ndërtimi i Planit të Veprimeve për Kontrollin e 100 Individëve referuar të dhënave nga Palë të Treta.](#)

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Kontrollit të Specializuar, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit me palë të treta, hartoi planin për kontrollin e **100 individëve** që rezultonin jashtë sistemit tatimor.

Ky plan u fokusua në këto faza kryesore:

- a) Identifikimin e individëve objekt kontrolli;

- b) Përgatitjen e portofolit të kontrollit;
- c) Hartëzimin dhe vlerësimin e riskut;
- d) Ushtrimin e kontrollit tatimor ndaj individëve.

Zbatimi i planit filloi në muajin Korrik 2025, referuar Memos nr. 12541 Prot., datë 01.07.2025, me lëndë **“Plan Pune për Kontrollin e Individëve”**, ku fillimisht u planifikuan për kontroll **15 individë**. Më pas, procesi vijoi me përfshirjen e pjesës së mbetur të individëve, duke arritur në total **100 individë**, në përputhje me vendimin përkatës të Komitetit të Riskut nr. 18, datë 29.04.2024. Sipas planit të miratuar, shpërndarja e individëve rezulton si më poshtë:

DRT	Numri i Individëve për çdo DRT
DRT Berat	3
DRT Durrës	12
DRT Elbasan	4
DRT Fier	5
DRT Gjirokastrë	2
DRT Kukës	6
DRT Laç	12
DRT Shkodër	7
DRT Tiranë	40
DRT Vlorë	9

Trajnimi i stafit

Me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe aftësive, gjatë vitit 2025 stafi i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar ndoqi trajnimet si më poshtë:

Nr.	Tematika	Organizmi/instanca trajnuese
1	Shkëmbimi Automatik i Informacionit (AEOI)	Agjencia Tatimore Suedeze (STA)
2	Kontrolli tatimor	Agjencia Tatimore Suedeze (STA)

XV. DREJTORIA PER PROCESET E BIZNESIT

1. Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme mbi punën e kryer nga Drejtoria për Proceset e Biznesit gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, në drejtim të realizimit të detyrave funksionale, nivelit të përmbushjes së objektivave, efikasitetit të proceseve të ndjekura dhe ndikimit në standardizimin e procedurave të brendshme të DPT-së, rezultatet e arritura, sfidat e hasura dhe objektivat për vitin pasardhës në funksion të përmirësimit të proceseve të biznesit si dhe koordinimit të manualeve të punës.

Drejtoria për Proceset e Biznesit (DPB) është një drejtori e cila bën pjesë në funksionet mbështetëse në DPT. Drejtoria për Proceset e Biznesit në organigramën e DPT është në varësi të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DPB është krijuar në korrik të vitit 2020 me objektiv strategjik për t’ju ardhur në ndihmë drejtorive për përmirësimin e proceseve të tyre më qëllim automatizimin dhe lehtësimin në kryerjen e detyrave funksionale, e cila do të sillte ndikim drejtpërdrejt tek tatimpaguesit, duke ulur barrën administrative të tyre, në funksion të përmbushjes së planit strategjik të DPT për zgjerimin e komunikimeve elektronike midis tatimpaguesit dhe DPT si dhe përmirësimin e proceseve.

Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera, DPB bën identifikimin e opsioneve dhe rekomandon opsionin më të përshtatshëm për t’u implementuar në mënyrë që zgjidhja IT të përputhet me kërkesat e administratës tatimore si dhe koordinimin e vazhdueshëm me drejtoritë dhe strukturat e DPT-së për vlerësimin e vlefshmërisë së manualeve të punës.

DPB drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë dhe është e organizuar në dy sektorë:

1.1 Sektori i Analizës dhe Implementimit të Proceseve të Biznesit (1+5)

Sektori ka si funksionalitet kryerjen e analizes për mënyrën e implementimit të proceseve të biznesit dhe identifikimin e opsioneve dhe rekomandon opsionin më të përshtatshëm për tu

implementuar në mënyrë që zgjidhja IT të përputhet me kërkesat e administratës tatimore, zhvillimin e takimeve me drejtoritë e tjera brenda DPT duke nxitur bashkëpunimin mes tyre në lidhje me përmirësimin e proceseve të tyre duke koordinuar punët me disa drejtori të cilat kanë shprehur nevojën për përmirësime apo automatizime procesesh pune

1.2- Sektori i Kordinimit të Manualeve të Punës (1+2)

Sektori ka si funksionalitet koordinimin e manualeve të punës, evidentimi i mospërputhjeve midis manualeve të punës të drejtorive në DPT, dokumentimi i këtyre mospërputhjeve dhe ndjekja e procesit deri në zgjidhjen përfundimtare të problematikave për të realizuar standardizimin e procedurave të brendshme të DPT-së për harmonizimin e proceseve të punës.

2. Fushat kryesore të veprimtarisë.

Sektori i Analizës dhe Implementimit të proceseve të Biznesit:

- Analiza e proceseve ekzistuese të biznesit dhe evidentimi i mundësive për optimizim duke marrë në analizë mënyrën e implementimit të proceseve të biznesit në sisteme, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat tatimore.
- Hartimi i kërkesave funksionale dhe teknike për zhvillimin ose përmirësimin e sistemeve IT duke identifikuar e opsionet me të mira, për t'u implementuar, në mënyrë që zgjidhja IT të përputhet me kërkesat e Administratës Tatimore.
- Testimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve të reja para implementimit duke ndjekur proceset e testimit me Drejtoritë funksionale dhe bën dokumentimin e rezultateve të testimit.
- Koordinimi me Drejtoritë e tjera për integrimin ndër-sistemor dhe menaxhimin e ndryshimeve.
- Monitorimi i performancës së sistemeve pas implementimit dhe mbledhja e feedback-ut nga përdoruesit.
- Trajnimi i stafit përdorues mbi sistemet e reja apo funksionalitetet e përmirësuara.
- Bën identifikimin e risqeve kryesore për një projekt të suksesshëm;

- Mirëmban dhe kryen dizenjimin e dokumentave dhe formularëve elektronikë që përdoren në sisteme
- Ndjek dokumentimin e sistemeve, manualeve të përdorimit në sisteme;
- Merr pjesë në idejimin e raporteve, analizave dhe statistikave;

Sektori i Koordinimit të Manualeve të Punës:

- Koordinimi i strukturave të DPT për krijimin, përditësimin e manualeve të tyre të punës me qëllim qartësimin, dokumentimin e punës së kryer nga strukturat për realizimin e detyrave të tyre funksionale.
- Mban një regjistër ku përditëson kërkesat e strukturave përkatëse lidhur me ndryshimet në manualet e punës, ndjek dhe koordinon punën deri në miratimin e ndryshimeve dhe variantin përfundimtar e kalon për publikim në rrjetin e brendshëm të Administratës Tatimore;
- Kërkon periodikisht apo kur paraqitet rasti, vlerësim nga strukturat në DPT, mbi vlefshmërinë e manualeve respektive të punës;

3. Rezultatet e arritura gjatë peridhes Janar-Dhjetor 2025

Sektori i Analizës dhe Implementimit të Proceseve të Biznesit:

U përmyll me sukses implementimi i Ligjit të ri “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, në zbatim të kontratës me Nr. 101, datë 02.08.2024, lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe IkubINFO, me objekt kontrate “Përmirësimi i sistemit e-taxation për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”. Për zbatimin e kësaj kontrate:

- u kryen analizat funksionale për ndryshimin/krijimin e deklaratave tatimore.
- u realizua shtimi i periudhës vjetore në vërtetimin e pagës në e-albania.

- u ndoq procesi për përditesimin e rregullave të riskut si rezultat i impaktimit nga ndryshimet në deklaratë dhe në listëpagesë.

- implementimi i ndryshimeve ligjore sipas Udhëzimit Nr. 6, datë 24.02.2025 për “Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, për SASPAC, duke krijuar një shërbim të ri në e-Albania me emërtimin “Aplikim për pajisje me çertifikatën 7A” dhe më pas krijohet një çështje e re në mënyrë automatike në C@TS me të njëjtin emërtim “Aplikim për pajisje me çertifikatë 7A”. Shërbimi është në proces në pritje të përgjigjes nga drejtoria e Kontrollit Tatimor.

- U realizua me sukses aplikacioni TAX TEST në bashkëpunim me STA, për të ardhur në ndihmë individëve për të kuptuar nëse kanë detyrim për të dorëzuar DIVA. Ky shërbim i ri u publikua në faqen zyrtare të DPT në datë 10 Mars 2025.

Në lidhje me procesin e zgjerimit të shërbimeve online dhe derregullimit janë realizuar:

- Deklarimi i Pasqyrave financiare dhe vendimit të ortakut në format të dixhitalizuar është realizuar në 17 qershor 2025.

- Paraplotësimi i deklaratës së TVSH është realizuar në 16 prill 2025.

- Paraplotësimi i deklaratës së Tatimit në Burim është realizuar në 29 Prill 2025.

- Paraplotësimi i deklaratës DIVA është realizuar në 21 Gusht 2025.

- Konfirmim dhe Njehësim i Deklaratës vjetore të të Ardhurave, është realizuar në datë 20 Tetor 2025.

- Konfirmimi i Pagesës së Tatimit në Burim është realizuar në datë 20 Tetor 2025.

- Aplikimi për regjistrim i enteve publike/Njësitë e zbatimit të projekteve është realizuar në 1 Janar 2025.

- Dixhitalizimi i dokumentit të Njoftimit dhe kërkesës për pagesë ka kaluar në Live, por për shkak të disa problematikave të identifikuara gjatë përdorimit në Live për rreth një muaj, po vijohet ndjekja e kësaj çështje me palën mirëmbajtëse.

- Dixhitalizimi i dokumentit të Njoftimit Vlerësimit – për gjobat për deklarim të vonuar është në proces, pritet qëndrimi i DTL nëse duhet të vijohet me këtë kërkesë apo jo dhe nëse po, DTL do duhet të paraqesë kërkesën për implementim.
- Vërtetim për historikun e punësimit të punonjësit është në proces, pritet përgjigja nga pala mirëmbajtëse
- Vërtetim për të Ardhurat nga Punësimi është në proces, pritet përgjigja nga pala mirëmbajtëse.
- Aplikim për Çertifikatë Rezidence për Individët është në proces, pritet përgjigja nga pala mirëmbajtëse.
- Konfirmim dhe njehsim pasqyrash financiare është në proces, pritet konfirmimi nga DTL
- Aplikim/kërkesë për kompensim/sistemim të detyrimeve tatimore është në proces, në pritje të përgatitjes së dokumentit funksional nga ana e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
- Lirimi nga masat shtrënguese është në proces, dërguar kërkesa për zhvillim tek pala mirëmbajtëse.
- Aplikimi për akt-marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara është në proces, pritet konfirmimi i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
- Ndjekje permanente e problematikave të raportuara nga tatimpaguesit dhe kompanite e certifikuar si zgjidhje softuerike në lidhje me fiskalizimin.

Spektori i Koordinimit të Manualeve të Punës:

- Përgatitja e draft manualit për spektorin e Koordinimit të Manualeve të Punës.
- Është realizuar koordinimi i vazhdueshëm me drejtoritë dhe strukturat e DPT-së për vlerësimin e vlefshmërisë së manualeve ekzistuese.
- Janë ndjekur proceset e hartimit dhe rishikimit të manualeve në funksion të ndryshimeve ligjore, procedoriale dhe teknike.

- Manualët e përditësuara kanë reflektuar më qartë proceset funksionale dhe përgjegjësitë institucionale të strukturave.
- Është krijuar dhe mirëmbajtur regjistri i ndryshimeve në manualët e punës, ku janë evidentuar versionet, datat e miratimit dhe përmbajtja e përditësimeve.
- Sektori ka monitoruar respektimin e afateve nga strukturat përkatëse gjatë procesit të hartimit dhe rishikimit të manualeve.

XVI. DREJTORIA E INFORMACIONIT

HYRJE

Objekti kryesor i veprimtarisë së Drejtorisë së Informacionit, i përcaktuar edhe në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore, konsiston në garantimin e informimit të tatimpaguesve dhe individëve mbi veprimtarinë e institucionit, produktet dhe shërbimet e tij, si dhe në dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion.

Detyrat kryesore të Drejtorisë së Informacionit

- **Planifikimi dhe hartimi i fushatave sensibilizuese, mbi objektivat e punës së Administratës** Tatimore dhe për çështje me impakt të gjerë në publik;
- Garanton maksimizimin e daljeve publike për çështje të ndryshme, në të gjitha kanalet e komunikimit publik (Web, TV dhe media sociale);
- Siguron organizimin e aktiviteteve, intervistave dhe takimeve me qëllim informimin dhe promovimin e punës së institucionit/produktet dhe shërbimet e tij;
- Koordinon komunikimin e vazhdueshëm me përfaqësues të medias, gazetarë dhe profesionistë të tjerë me ndikim në fushë;
- Ka në ngarkim funksionin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit për dhënien e informacionit, duke respektuar afatet ligjore, në zbatim të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”;
- Trajton kërkesat për informacion që vijnë në kuadër të AEOI (Automatic Exchange of Information) dhe EOIR (Exchange of Information on Request) si dhe kërkesat që i drejtohen Drejtorisë së Informacionit që vijnë nga:
 1. Mediat;
 2. Institucionet publike;
 3. Tatimpaguesit;
 4. Individët;
 5. Përmbauesit;

Në kuadër të realizimit të detyrave të mësipërme, Drejtoria e Informacionit ka në fokus rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së komunikimit me tatimpaguesit, nëpërmjet sqarueseve dhe materialeve informuese në të gjitha kanalet e komunikimit dhe jo vetëm.

Organizimi i Drejtorisë së Informacionit

Drejtoria e Informacionit sipas organigramës së DPT-së, është në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DI dhe është e organizuar në 2 sektorë:

- Sektori i Shkëmbimit të Informacionit me 1 Përgjegjës dhe 7 Inspektorë (5 pozicione vakante - 1 Përgjegjës, 4 Inspektorë)
- Sektori i Komunikimit me 1 Përgjegjës dhe 3 Specialistë (1 pozicion vakant - 1 Përgjegjës)

Objektivat e Drejtorisë për vitin 2025

Garantimi i informimit dhe ndërgjegjësimit të tatimpaguesve dhe opinionit publik me qëllim përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore

- ✓ Publikimi në kohë i çdo njoftimi, lajmi apo pop-up që lidhet me aktivitetin e Administratës Tatimore;
- ✓ Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm brenda afateve ligjore;
- ✓ Rikujtesë për tatimpaguesit për përmbushjen e detyrimeve tatimore me qëllim shmangien e masave administrative të parashikuara në ligj;

Rritja e sensibilizimit publik në kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri

- ✓ Informimi dhe komunikimi publik i vazhdueshëm me tatimpaguesit;
- ✓ Zbatimi i planit të komunikimit, me në fokus ndryshimet ligjore sipas ligjit të ri dhe çështjet prioritare që Administrata Tatimore ka në fokus, në kohë dhe rrethana të caktuara.
- ✓ Zbatimi i planeve sektoriale për informalitetin në tregun e punës, për sigurinë ushqimore dhe për turizmin.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

- ✓ Ndarja racionale e detyrave brenda Drejtorisë;
- ✓ Vlerësimi objektiv i punonjësve sipas meritës dhe aftësive;
- ✓ Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve me qëllim ofrimin e shërbimit dhe informacionit për tatimpaguesit në mënyrë sa më efikase;

AKTIVITETET E PROGRAMUARA DHE KRYERA GJATË VITIT 2025

Duke pasur parasysh organizimin e strukturës së Drejtorisë së Informacionit, raportimi mbi rezultatet dhe veprimtarinë e saj për vitin 2025, do të pasqyrohet në 2 ndarje kryesore sipas sektorëve përkatës, përkatësisht: Sektori i Komunikimit dhe Sektori i Shkëmbimit të Informacionit.

SEKTORI I KOMUNIKIMIT

Përgatitja dhe publikimi i njoftimeve në website dhe rrjete sociale.

- ✓ Janë përgatitur dhe publikuar 39 njoftime/ lajme në web-in e Administratës Tatimore.
- ✓ Janë përgatitur dhe publikuar 208 njoftime dhe postime në rrjetet sociale Facebook, Instagram dhe LinkedIn.
- ✓ Janë përgatitur dhe publikuar në rrjete sociale video për kontrollet e kryera në sektorin e turizmit dhe në sektorin e tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe për kontrollet e kryera për luftën kundër informalitetit.
- ✓ Janë përgatitur dhe redaktuar pop up për tatimpaguesit për çështje të natyrave të ndryshme në përputhje me nismat, aksionet etj.

Publikimi i Spotit.

Gjatë vitit 2025 është përgatitur dhe transmetuar në media audiovizive një spot publicitar për informimin e publikut për sensibilizimin kundër informalitetit në tregun e punës.

Trajtimi i kërkesave dhe çështjeve të ardhura në Zyrën e Shtypit dhe te Koordinatori për të Drejtën e Informimit.

- ✓ Pranë Koordinatorit për të Drejtën për Informim, kanë ardhur 37 kërkesa. Të gjitha janë trajtuar dhe u është kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar në legjislacionit në fuqi.
- ✓ Pranë Zyrës së Shtypit, kanë ardhur dhe janë trajtuar rreth 900 çështje. Të gjitha rasteve u është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor.

Përdorimi i gjuhës së thjeshtë

Drejtoria e Informacionit është kujdesur në mënyrë të vazhdueshme të përdorë një gjuhë të thjeshtë dhe më empatike për komunikim sa më të qartë dhe të kuptueshme për tatimpaguesit dhe qytetarët.

Detyra të tjera të realizuara nga Drejtoria e Informacionit.

- ✓ Organizoi aktivitete publike, me qëllim informimin për çështje të caktuara që lidhen me ndryshimet ligjore dhe detyrimet tatimore;
- ✓ Organizoi intervista me qëllim informimin e publikut, në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni tatimor apo çështje të tjera në fokus;
- ✓ Trajtoi dhe ktheu përgjigje brenda afatit të gjitha kërkesave për informacion që kanë ardhur nga mediat.

SEKTORI I SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT

Trajtimi i kërkesave për informacion në rrugë shkresore

Gjatë vitit 2025 janë trajtuar dhe është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore, 2203 shkresave të ardhura në Drejtorinë e Informacionit, të ndara si më poshtë vijon:

1. 1001 shkresa të ardhura nga Përmbaruesit;
2. 1010 shkresa të ardhura nga palët e treta (Institucionet publike);
3. 144 shkresa të ardhura nga tatimpaguesit dhe individët;
4. 48 shkresa të ardhura në kuadër të EOIR (Exchange of Information on Request).

Trajtimi i kërkesave/ ankesave të ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes

- ✓ Janë ndjekur, trajtuar dhe u është kthyer përgjigje brenda afatit, 333 kërkesave/ankesave të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes.

Angazhimi në grupe pune

Inspektori i Sektorit të Shkëmbimit të Informacionit është pjesë e grupit të punës për trajtimin e kërkesave për përjashtim nga TVSH, në kuadër të procesit të rindërtimit. Gjatë vitit 2025 ka trajtuar dhe ka kthyer përgjigje për 117 kërkesa për përjashtim nga TVSH.

Gjithashtu, inspektorët/specialistët e Drejtorisë së Informacionit kanë marrë pjesë në grupe pune të ndryshme, të caktuara me urdhër të titullarit.

XVII. DREJTORIA E IMPLEMENTIMIT TË OPERACIONEVE TATIMORE

SEKTORI I OPERACIONEVE FINANCIARE DHE TATIMORE

Analiza mbi ecurinë e marrëveshjeve për vitin 2025, sipas rajoneve/drejtorive rajonale.

Për vitin 2025 Sektori Operacioneve Financiare dhe tatimore ka trajtuar kërkesat për lidhje të marrëveshjes për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara, dërguar nga Drt-të rajonale dhe DTM nga periudha Nëntor - Dhjetor 2025.

Shqyrtimi dhe analiza bazohen mbi dispozitat ligjore të procedurave tatimore dhe udhëzimin përkatës, si dhe kriteret referuese të sugjeruara nga DIOT:

verifikimi i pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; tatim në burim;

ekstraktet bankare për 6 mujorin e dytë, analizë të situatës financiare për të vlerësuar aftësinë paguese;

ngarkim të marrëveshjes dhe mandat pagesës së 20% te dosja e tatimpaguesit.

kontrolli mbi dorëzimin e deklaratave tatimore sipas përgjegjësive tatimore, listëpagesave; librave të shitjes/blerjes; dorëzimin e pasqyrave financiare dhe vendimin e asamblesë;

rakordim të shitjeve në deklaratën vjetore të TF dhe pasqyrës të ardhura & shpenzime;

verifikim nëse ka patur në ulje të detyrimit tatimor të deklaratave;

rakordim të shitjeve/blerjeve në FDP të tvsh-së me deklaratimet e raportuara në pasqyrat mujore në cpcm;

historiku i aktmarrëveshjeve, a ka pasur më parë, a është respektuar?

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 rezulton se kanë ardhur për shqyrtim gjithsej 756 kërkesa për marrëveshje nga drejtoritë rajonale. Kërkesat janë shqyrtuar nga inspektorët dhe kthyer përgjigje nga eprori për miratim/refuzim marrëveshje apo plotësim dokumentacioni, sipas afateve ligjore.

Nga 756 kërkesa për lidhje aktmarrëveshje, janë refuzuar 120 kërkesa, pasi nuk plotësonin kriteret ligjore, (detyrime tatimore në kontribute; tatim në burim; konstatim gjendje të mjeteve monetare në llogaritë e subjektit, mosdorëzim deklaratash tatimore apo pasqyrave financiare; pasiguri të aftësisë pagueuse të tatimpaguesit).

Për vitin 2025 është dhënë miratim nga DIOT gjithsej për 641 kërkesa për lidhje të marrëveshjes për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara, nga këto nuk janë lidhur në drejtoritë rajonale 56 prej tyre, për shkak të tërheqjes së tatimpaguesit apo mospagesës së parapagimit 20%.

Nga monitorimi i ecursisë së marrëveshjeve për pagesë me këste të detyrimeve tatimore, rezulton se 77 tatimpagues kanë përmbushur pagesat me këste të aktmarrëveshjes brenda afateve të përcaktuar ligjore.

Aktualisht janë 391 tatimpagues që vijojnë të respektojnë marrëveshjet e lidhura.

Vlera e kërkuar për të hyrë në marrëveshje në total është 4,373,434,434 lekë, për 641 tatimpaguesit që kanë bërë kërkesë për lidhje aktmarrëveshje me administratën tatimore.

Shuma e arkëtuar nga parapagimet e detyrimit tatimor (20% ose me tepër) është vlera 912,491,938 lekë.

Vlera e detyrimit tatimor për të cilën është lidhur aktmarrëveshja është 3, 189, 665, 178 lekë.

Bazuar në monitorimet e kryera, periodikisht nga DIOT, janë konstatuar 117 tatimpagues që nuk respektojnë pagesat e kësteve të detyrimeve tatimore, sipas planeve të ngritura, është komunikuar me Drt-të për zgjidhjen e tyre. Nga analiza dhe kontrollet e kryera periodikisht, janë minimizuar ndjeshëm parregullsitë e konstatuara në procedurë si dhe janë zbatuar rekomandimet e lëna për zbatim nga ana e Klsh -së.

Tabela përmbledhëse sipas rajoneve (14 Drt -ve) për vitin 2025

DREJTORIA E IMPLEMENTIMIT TË OPERACIONEVE TATIMORE										
Sektori i Operacioneve Financiare dhe Tatimore										
Analiza 12-mujore e Aktmarveshjeve periudha 1 Janar - 31 Dhjetor 2025										
Rajoni	Drejtoria Rajonale	Nr Kërkesa të ardhura	Kërkesa AM të Refuzuara	Akt-marveshje të Miratuara	Nuk është lidhur akt-marveshje	Vlera e Detyrimit	Parapagimi 20% / > se	Vlera e Detyrimit të lidhur në Marveshje	Akt-marveshje të zgjidhura	Akt-marveshje të Përbushura
Verior	Lezhe	30	5	25	1	71,560,794	17,538,872	57,573,807	4	7
	Shkoder	56	9	47	1	64,325,581	16,836,903	53,628,445	1	11
	Diber	18	2	16	3	81,292,311	22,097,649	81,571,041	3	2
	Kukes	19	3	16	2	33,414,711	15,014,358	26,585,459	2	4
	shuma	123	19	104	7	250,593,397	71,487,782	219,358,752	10	24
JUGOR	Fier	35	5	30	1	316,465,028	70,228,269	246,236,759	6	1
	Gjirokastr	15	1	14	1	50,529,553	5,593,607	21,669,802	2	4
	Berat	16	2	14	0	47,561,304	10,267,546	37,293,758	1	2
	Vlore	42	4	38	2	199,608,237	40,242,994	152,607,773	14	1
	Sarandë	12	1	11	2	21,207,063	5,407,317	15,800,746	2	1
	shuma	120	13	107	6	635,371,185	131,739,733	473,608,838	25	9
Qendror	Tirane	294	42	252	16	1,638,061,279	320,430,189	1,080,452,934	61	44
	Durrës	124	25	99	10	1,606,090,744	323,347,841	1,254,441,128	12	0
	Elbasan	41	7	34	5	160,182,326	50,282,749	101,068,949	6	0
	Korçë	54	12	42	12	40,034,651	6,583,474	26,253,895	3	0
	shuma	513	86	427	43	3,444,369,000	700,644,253	2,462,216,906	82	44
DTM	Tirane	5	2	3	0	43,100,852	8,620,170	34,480,682		
Totali Rajonave (13 DRT)		761	120	641	56	4,373,434,434	912,491,938	3,189,665,178	117	77

Grupi i punës ka hartuar draft manualin e punës së Sektorin të Operacioneve Financiare dhe Tatimore, procedurat tatimore që do të monitorojë inspektorët. Nga ana e sektorit është përgatitur pjesa takuese në rregulloren dhe funksionimin e DPT.

Implmentimi i shërbimit online në portalin e-albania

Nga Drejtoria e Implementimit të Operacioneve Tatimore është përgatitur draft dokumenti paraprak për implementimin e “Kërkesës për Marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara”, në portalin e-albania, për tatimpagues me status ligjor: Entitetet; Person Fizik tregtar; Ent Publik; Individ.

Tatimpaguesit ti mundësohet ofrimi i shërbimit ” Kërkesë për marrëveshje për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara“, duke aplikuar online nëpërmjet llogarisë së tij në e-albania/e filing. Duke qene se ky funksionalitet është pjesë e procedurave të Drejtorisë së

Kontrollit Tatimor, paraprakisht nevojitet një konfirmim i workflow-ut dhe draft kërkesës së ngritur nga DIOT, përpara dërgimit të kërkesës për implementim tek pala mirëmbajtëse.

Monitorimi i vendimeve të Drejtorisë së Apelit Tatimor (DAT)

Gjatë monitorimit dhe verifikimeve të kryera mbi procesin e zbatimit të Vendimeve të Apelit, bazuar në raportet e marra nga Aksh-i në DPT, dhe raportimet e Drt Rajonale, janë konstatuar tatimpagues të cilët vijojnë të jenë të checkuar “nën apel”, pavarësisht se çështja gjyqësore është mbyllur.

Kjo situatë është krijuar për shkak të ndërrimit të drejtorëve rajonal, të cilët kanë pasur akses në çdo çështje nën apelim tatimor, të hapur. Rezulton se aksesin në sistem ka vijuar, edhe pas largimit të tyre nga detyra. Kjo ka penguar në mbyllje e çështjeve të apelit në sistem nga drejtorët e rinj, të cilët nuk kanë pasur akses.

Për zgjidhjen e këtij ngërçi është komunikuar me drt rajonale, të cilëve u është dërguar lista me tatimpaguesit, për çdo drt, të cilët rezultojnë të jenë ende të checkuar nën apel apo proces gjyqësor. Nga ana e DRT na është dhënë informacioni mbi situatën aktuale të çdo TP, nëse janë ende nën apel/proces gjyqësor, nëse ka përfunduar procedura ligjore ndaj tyre, apo për TP për të cilët nuk kanë patur akses në çështje.

Me suportin e Aksh-it, u janë hequr check-in 280 tatimpaguesve me vlerë detyrimi 771, 546,632 lekë, të cilër rezultonin të chekuara nën apel edhe pse u kishte përfunduar procesi.

Lista me 280 TP, iu dërgua Drejtorisë Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, që të vijoj me masa shtrënguese ndaj tyre. AKSH-i në DPT iu kërkuar të bëjë ndryshimet në sistem, duke iu hequr aksesin në çështje ish drejtorëve rajonal, dhe krijimin e aksesit për drejtorët e rinj.

SEKTORI I REGJISTRIT TË BIZNESIT

Gjate vitit 2025, (Janar- 31 Dhjetor) sipas të dhënave të transmetuara nga QKB dhe atyre të ngarkuara në sistem nga veprimet e kryera nga DRT-të në rrethe për tatimpaguesit që regjistrohen nga ana e tyre, rezulton se:

Numri i tatimpaguesve aktive, (që kanë një përgjegjësi tatimore) në Regjistrin Kombëtar në fund të vitit 2025, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e Sistemit Tatimor, rezulton: 139,705 tatimpagues gjithsej (132,105 **tp. fund 2024**). Rezultojnë 7600 TP aktive më shumë se 2024.

Sipas kategorizimit të tatimpaguesve, (bazuar në formën ligjore) në fund të vitit rezultojnë: 103785 TP persona fizike (që janë objekt i TAPB), 35920 Entitete (që janë objekt i TAK).

Në shifrën gjithsej të tatimpaguesve aktive rezultojnë të regjistruar në përgjegjësinë tatimore TVSH 38938 tatimpagues në fund të vitit 2025.

Gjatë vitit 2025 u regjistruan si tatimpagues, të rinj për herë të parë 18804 tp, nga të cilët 13900 si TP persona fizike dhe 4904 tp Entitete.

Në numrin e tatimpaguesve aktive nuk janë përfshirë 110253 fermerë/prodhues bujqësore të cilët nuk kanë përgjegjësi tatimore. Vetëm në vitin 2025 u regjistruan nga DRT në rreth 6996 Fermerë.

Realizimi i funksionit të regjistrimit të subjekteve të reja, është kryer nëpërmjet:

- Regjistrimeve në QKB-në nëpërmjet regjistrimeve të bizneseve të reja
- Regjistrimit të tatimpaguesve të kategorisë OJF-ve, Ambulante, Fermere, Njësi zbatimi projekti, Ente e organizata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare., që kryen nga Drejtoritë Rajonale.
- Mbikqyrjes dhe zgjidhjes së problemeve të vazhdueshme nga Sektori i Regjistrimit në DPT

Vlen për tu theksuar se procesi i transmetimit dhe procesimit të të dhënave për regjistrimet dhe ndryshimet e kryera nga QKB në DPT për vitin 2025 ka ecur normalisht por ka patur edhe probleme të cilat sektori i regjistrimit, duke punuar sistematikisht ka arritur ti zgjidhë me sukses.

Gjatë monitorimit të punës së përditshme, rezulton se gjatë vitit 2025 nga sektori i Regjistrimit është bërë një punë e vazhdueshme mbikqyrëse dhe operacionale për realizimin e mirëmbajtjes dhe azhurnimit të Regjistrimit Kombëtar të Tatimpaguesve duke zgjidhur situata dhe raste që kanë patur probleme dhe pengesa teknike për regjistrimet, përgjegjësitë tatimore, përditësimin e ndryshimeve në regjistrim, cregjistrimeve etj. Kjo është realizuar duke bashkëpunuar me, Drejtorinë e TIK-AKSHI –DPT, me Palën mirëmbajtëse të Sistemit të Tatimeve dhe me QKB-në.

Transferimi i tatimpaguesve nga nje DRT ne nje DRT tjetër

Transferimet i tatimpaguesve nga nje drejtori rajonale tatimore ne nje tjetër, jane veprime qe kryhen nga Administrata tatimore ne baze te ndryshimeve te selise qe kane kryer tatimpaguesit ne QKB gjate nje viti. Ky transferim iniciohet mbas ndryshimit qe ben tatimpaguesi prane QKB/DRTse. Te dhenat nxirren nga Sistemi bazuar veprimeve te transmetuara nga QKB, apo ndryshimeve te selive nga sektoret e regj ne DRT. Me pas Sektori i Regjistrimit ne DPT pasi kryhen veprimet perkatese per ndryshimin e DRT ne Sistem njofton çdo DRT per ndryshimet e ndodhura.

Gjate vitit 2025 jane transferuar (ndryshuar DRT ne Sistem) 938 tatimpagues dhe ky informacion perveç njoftimit te DRT perkatese, publikohet e perditesohet dhe ne faqen tone te intranetit per tju ardhur ne ndihme Drejtorive te tjera ne DPT.

Gjate vitit 2025 ka patur levizje te tatimpaguesve nga DRT ne DTM dhe anasjelltas te cilat behen per nevoja administrimi me te mire me urdher dhe rregullore te Drejtorit te Pergjithshem te Tatimeve. Per vitin 2025 kane kaluar per administrim ne DTM 399 tatimpagues dhe kane dale nga DTM, per tu administruar nga DRT, 25 Tatimpagues.

Realizimi i transferimeve te kryera nga ndryshimi i selise se tatimpaguesit ne QKB dhe i levizjeve te tatimpaguesve (Hyrje-daljeve) nga DTM jep numrin e tatimpaguesve gjithesej, qe ka nje DRT ne nje periudhe te caktuar ne regjistrin e tatimpaguesve per administrim nga ana e saj.

Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve

Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve per vitin 2025 ka qene nje proces qe kryesisht kryhet ne menyre automatike nga sistemin informatik ose me aplikim ne QKB dhe nga DRT ne rrethe per tatimpaguesit qe regjistrohen prane tyre. Nga te dhenat qe administrojme ne fund te vitit 2025 rezultojne te regjistruar ne regjistrin pasiv (progressive) gjithesej 161,345 tatimpagues, nga te cilet kane kaluar gjate ketij viti 15,680 tatimpagues.

Perditesimi i regjistrimit Pasiv behet nepermjet – kalimit ne pasiv nga veprimet e pezullimit te aktivitetit qe kryhen tatimpaguesi ne QKB, dhe kalimi automatik nga sistemi edhe i tatimpaguesve qe kane periudhe mosdeklarimi dhe deklarimin pa veprimtari per me shume se 12 periudha mujore te njepasnjeshme dhe tashme kjo procedure per ekzekutimin e procesit te kalimit automatik ne Pasiv nga Sistemi, funksionon rregullisht per cdo muaj dhe te dhenat per mbikqyrje operacionale nxiren periodikisht nga strukturat perkatese brenda Administrates tatimore.

Theksojme se procedurat e kalimit ne pasiv tashme jane me te thjeshtuara duke bere te mundur pastrimin e regjistrimit nga tatimpaguesit jo aktive dhe perditesimin e te dhenave ne Regjistrin e Tatimpaguesve.

Spektori i Regjistrimit ne DPT, Brenda funksionit te saj, vazhdimisht bashkepunon me QKB dhe Palen Mirembajtese per problemet qe mund te shfaqen per kalimin e tatimpaguesve ne statusin pasiv, si dhe orienon DRT ne rrethe per zgjidhjen e problemeve, dhe bazuar veprimeve nga QKB sqaron tatimpaguesit per statusin e tij.

Pervec kalimeve ne statusin pasiv, ne zhvillimet aktuale te bera ne Sistem eshte e mundur riaktivizimi automatik i Tp. nga statusi Pezulluar qe ai ka ne QKB duke kaluar ne Aktiv ne sistemin tatimor. Gjate vitit 2025 eshte bere riaktivizimi per 3120 TP.

Perditesimi i ndryshimeve ne regjistrim, qe behen ne QKB

Çdo ndryshim mbi te dhenat e regjistrimit qe kryejne subjektet apo tatimpaguesit ne QKB apo ne DRT (per sa eshte e percaktuar ne ligj, udhezimet perkatese, Protokollin e komunikimit elektronik me QKB dhe manualin e punes se Regjistrimit) pasqyrohet ne Sistem Tatimor.

Procesi i perditesimit te ndryshimeve ne regjistrim (transmetimi nga QKB - ne DPT) qe bejne tatimpaguesit ne QKB, dhe qe jane pjese e ndryshimeve te te dhenave ne regjistrin tregtar, gjate vitit 2025 ka hasur dhe veshtiresi, te cilat kane ardhur si rezultat kryerjes se proceseve online nga QKB, por dhe mosvenia ne perdorim e sherbimeve online te parashikuara ne Marrveshjen e Bashkepunimit dhe Protokollin e komunikimit midis DPT-QKB.

Ne kete perditesimin te ndryshimeve qe ka bere tatimpaguesi ne QKB per vitin 2025 ka ndikuar zbatimi i Marreveshjes se bashkepunimit si dhe protokollit elektronik te shkembimit te te dhenave midis dy institucioneve DPT-QKB (firmosur ne shtator 2019).

Konkretisht per vitin 2025 jane mbajtur nen monitorim me qellim transmetimin e gjithe veprimeve mbi:

Marrja e te dhenave mbi regjistrimet e tatimpaguesve te rinj dhe zgjidhja e pengesave e problemeve.

Nxjerrja e te dhenave te ndryshuara nga Tp. ne QKB qe nuk perditesohen ne Sistemin Tatimor dhe reklamimi ne QKB per zgjidhjen e tyre dhe ridergimin drejt DPT

Keto te dhena shfaqen ne sistem dhe ndihmojne perdoruesit per te marre nje informacion me te shpejte dhe me te sakte per qellim te punes se tyre gjate verifikimeve dhe kontrolleve ne kohen e duhur.

Ne punen e perditeshme sa here qe konstatohen probleme nga sektoret e Regjistrimit ne DRT, ato behen prezent ne Sektorin e Regjistrimit ne DPT per zgjidhje me Palen Furnitore qe miremban Sistemin, per te dhene zgjidhje praktike çdo rasti te konstatuar.

[Çregjistrimi i tatimpaguesve ne sistem](#)

Gjendja e tatimpaguesve te çregjstuar progresive ne Sistemin Tatimor ne fund te 2025 rezulton 83 004 tatimpagues.

Per vitin 2025 u finalizuan çregjistrimet ne Regjistrin Kombetar te DPT per 6036 tatimpagues te cilet permbushen dhe detyrimet ligjore.

Procesi i çregjistrimit te tatimpaguesit finalizohet ne DRT perkatese. Çertifikatat e çregjistrimit (kopje) te leshuara nga QKB aktualisht dergohen direkt ne DRT perkatese ne baze te marrëveshjes qe kemi me QKB, pasi aty do te kryhen dhe veprimet konkrete per çregjistrimin e tatimpaguesit edhe nga Regjistri i tatimpaguesve te DRT.

Edhe ne vitin 2025 çregjistrimi i tatimpaguesve bazuar nga problemet e derguara nga DRT ne rrethe ne disa raste ka veshtiresi, pasi finalizimi i çregjistrimit nuk mund te realizohet nga punonjesit tane ne DRT.

Kjo vjen edhe si rezultat;

-I mospermbushjes se kushteve ligjore nga ana e tatimpaguesve duke mos paguar te gjitha detyrimet dhe dorezuar te gjitha deklaratat tatimore.

-I mosveprimit te punonjesve te Kontrollit per te vleresuar deklaratat dhe llogarine perkatese te Tatimpaguesit ne Kohen e duhur, dhe i mosmiratimit te cregjistrimit nga ana e tyre, per te cilat pengojne cregjistrimin e tij.

-I moslejimit te cregjistrimit te tp., kur ai nuk ka paraqitur dokumentacionin mbi vendin e biznesit nese e ka me qera apo jo, dhe i kerkohet mbas cregjistrimit nga QKB.

Ne kuadrin e Planit të Integritetit të Administrates Tatimore 2024-2027, sektori i Regjistrimit ne DPT, po punon per implementimin e informatizimit te plotë i procesit te cregjistrimit.

[Ndryshimet e paketes ligjore per vitin 2025 dhe puna per implementimin e tyre ne sistem](#)

Gjate vitit 2025, Sektori i Regjistrimit si funksion baze i DPT, ishte pjese aktive ne punen per zhivillimet ne lidhje me implmentimin e ligjit te ri te tatimit mbi te ardhurat ne sistemin tatimor.

Nga ana e punonjesve te sektorit u krye me sukses, dokumentimi i funksionaliteteve te regjistrimit, detajimi i ndryshimeve perkatese ligjore, analiza e ndryshimeve te propozuara nga pala mirembajtese, testimet per cdo funksion deri ne miratimin perfundimtar te implementimit te tyre ne sistem, duke gjetur zgjidhje efikase per cdo problem te hasur, ne bashkepunim me drejtorine e IT ne DPT.

Ne funksion te ketij procesi u hartuan jo vetem formularet e rinj te sektorit per AT, por edhe formularet e rinj per QKB, ne menyre qe veprimet qe do te kryhen nga kjo e fundit te shkojne ne unison me veprimet ne AT.

U hartuan raportet e reja te regjistrimit te cilat do ti vijne ne ndihme gjate punes sektorit te Regjistrimit ne AT dhe sektoreve perkates ne DRT, sipas percaktimeve te ligjit te ri.

Ne funksion te ligjit te ri u kryen edhe ndryshimet perkatese ne Marrveshjen e bashkepunimit QKB-DPT si dhe ne protokollin e komunikimit elektronik ne funksion te saj.

Puna e kryer nga Sektori i Regjistrimit, hapi rrugen per drejtorite e tjera ne DPT per implementimin e ndryshimeve ligjore, sipas funksioneve perkatese.

XVIII. DREJTORIA E HETIMIT TATIMOR

I.PËRMBLDHJA EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin 2025 ka në fokus të pasqyrojë aktivitetin e zhvilluar gjatë gjithë këtij viti, në drejtim të përmbushjes së objektivave që lidhen me forcimin e zbatimit të ligjit tatimor, parandalimin e evazionit fiskal, ndjekjen e fenomeneve me risk të lartë fiskal, si dhe, përcielljen e rekomandimeve për ndryshime, etj.

Veprimtaria e Drejtorisë së Hetimit Tatimor është zhvilluar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, e konkretisht;

-Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-VKM-në me nr.400, datë 22.04.2009 “ Mbi përcaktimin e detyrat dhe funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor”;

- Manualin e Punës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor;

- Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar;

- Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar;

- Ligjin nr.8677, datë 02.11.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar;

- Ligjit nr.8457, datë 11.02.1999, për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar më vonë me Ligjin nr. 9541, datë 22.05.2006 dhe me Ligjin nr. 25/2012, datë 15.03.2012;

- Ligjin nr.9917, datë 19.05.2008, “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”;

- Si dhe, duke u mbështetur në VKM-të, Urdhërat dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore, etj;

Gjatë vitit 2025, puna e Drejtorisë së Hetimit Tatimor është orientuar jo vetëm ndaj individëve dhe subjekteve të veçanta, por si fokus kryesor ka pasur trajtimin e fenomeneve me risk të lartë fiskal, evazionit tatimor, shmangies së detyrimeve fiskale dhe veprave të tjera penale që dëmtojnë interesat fiskale të shtetit. Qasja hetimore është ndërtuar mbi analizën e dinamikës së këtyre fenomeneve dhe verifikimin e rasteve konkrete, duke synuar jo vetëm ndjekjen e subjekteve individual, por edhe adresimin e modeleve të evazionit me efekt të gjerë makro.

Volumi i rasteve për të cilat është kërkuar ushtrimi i ndjekjes penale nga Drejtoria e Hetimit Tatimor nëpërmjet referimeve në Prokurori për vitin 2025 ka shënuar një rritje të dukshme, duke reflektuar një angazhim më të madh në luftën kundër evazionit fiskal, pastrimit të parave dhe veprave të tjera penale që dëmtojnë interesat e shtetit. Krahësuar me vitin 2024, numri i referimeve të bëra në Prokurori është rritur me **67%**, ndërsa numri i tatimpaguesve të referuar ka shënuar një rritje prej **102%**. Po ashtu, vlera e detyrimeve të papaguara të evidentuara nga këto referime ka pësuar një rritje të jashtëzakonshme, duke u rritur me **1090%**, që tregon një intensifikim të punës së hetimeve dhe një fokus të veçantë në identifikimin e evazionit.

Ky progres është rezultat i një qasjeje më të strukturuar dhe sistematike të punës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor, e cila ka fokusuar punën jo vetëm në raste specifike, por mbi fenomene me risk të lartë fiskal. Për më tepër, ky trend pozitiv ka ardhur edhe falë përmirësimit të bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, duke rritur shkëmbimin e informacionit dhe efektivitetin e veprimeve hetimore.

Rezultatet e arritura gjatë vitit 2025 tregojnë se, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka arritur të konsolidojë ndikimin e saj në luftën kundër informalitetit, duke u bërë një aktor kyç në mbrojtjen e interesave fiskale të shtetit dhe forcimin e sistemit tatimor në Shqipëri.

Gjatë vitit 2025, gjithashtu Drejtoria e Hetimit ka forcuar bashkëpunimin ndër-institucional dhe ndërkombëtar, duke u bërë host dhe pikë kontakti për **projektin TIWB – Tax Inspectors Without Borders**, një iniciativë e **OECD** dhe **UNDP**, e cila ka për qëllim zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të inspektorëve tatimorë në hetime komplekse. Në kuadër të këtij projekti, stafi i Drejtorisë ka qenë prezent në **Konferencën Vjetore TIWB në Paris**, ku Shqipëria dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë prezantuar me sfidat dhe sukseset e saj në luftën kundër evazionit dhe informalitetit. Gjithashtu, u organizua faza e parë e këtij projekti Workshop 3-ditor me pjesmarrje të disa institucioneve. **Projekti do të vijojë me asistencë të drejtpërdrejtë nga ekspertet e Guardia di Finanza për dy vitet e ardhshme**, duke punuar ngushtë me inspektorët tanë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 Drejtoria e Hetimit Tatimor ka avancuar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbim informacioni dhe trajnime të specializuara, duke përfshirë trajnime me ekspertë pranë **OSCE-së**, ekspertë pranë **NCA** dhe **Ambasadës Britanike në Tiranë** dhe institucione të tjera homologe, duke rritur kapacitetet profesionale të stafit dhe efektivitetin e hetimeve.

Ky raport paraqet një **pasqyrë të plotë dhe të detajuar të veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin 2025**, duke reflektuar përpjekjet për mbrojtjen e interesave fiskale të shtetit, rritjen e efektivitetit në hetim dhe përmirësimin e bashkëpunimit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë.

II.PROBLEMATIKAT TË CILAT DUHEN ADRESUAR

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Hetimit Tatimor, ka përballuar disa sfida të rëndësishme që ndikojnë në efektivitetin dhe cilësinë e hetimeve, veçanërisht në fushën e luftës kundër evazionit fiskal dhe veprave të tjera penale të lidhura me to. Për këtë, Drejtoria e Hetimit Tatimor, ka ngritur probleme dhe ka propozuar zgjidhje si;

- 1. Procedura e vlerësimit tatimor në DHT ishte shumë e ngadaltë, pasi të gjitha kërkesat për vlerësim dërgoheshin në Drejtorite Rajonale dhe për shkak të mbivendosjes së punës nuk arrinin të kryenin procedurat në afat.** Kjo problematikë u zgjidh edhe pas propozimeve tona për ndryshime ligjore që DHT-ja të kryejë brenda strukturës së saj, gjithë vlerësimet tatimore në funksion të hetimeve që kryen. Ky propozim gjeti mbështetjen e Drejtorit të Përgjithshëm e instancave të tjera dhe, u propozuan dhe u bënë ndryshime në ligjin nr.9920/2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar”, konkretisht në nenin 15 të tij, i cili ka hyrë në fuqi në Janar 2026. Ky ndryshim do të jetë sfidë e Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin 2026.
- 2. Bankat e nivelit të dytë nuk orfronin informacionin sipas formateve apo nevojave të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, informacion i cili të mund të analizohej me softe, etj.** Kjo problematikë është trajtuar gjerësisht në mënyrë individuale me secilën bankë por dhe me Shoqatën e Bankave nga ana jonë, por edhe pse janë bërë disa ndryshime prej tyre, **ngelet akoma një shqetësim që duhet adresuar akoma.**
- 3. Problematika e të dhënave ekonomiko-financiare të ruajtura në formatet elektronike nga subjektet tatimpagues nuk na janë ofruar në kohë reale**

dhe të pamanipuluara nga kufizimet e aksesit në to. Kjo pengesë ka qenë e mbështetur edhe nga shoqëritë që i ofrojnë shërbimet e sofwarëve të fiskalizuar, apo duke përdorur vendruajte të servera-ve të tyre me adresë të pacaktuar (cloud), kryesisht jashtë Republikës së Shqipërisë. Edhe kjo problematikë mbetet një sfidë e rëndësishme për DHT gjatë vitit 2026.

- 4. Mungesa e IT te specializuar dhe mjeteve digjitale (software) për analizimin dhe hetimin e të dhënave digjitale janë një pengese reale në kohën që po jetojmë, pasi cdo tatimpagues është përdorues i transaksioneve digjitale.** Mbështetja e Drejtorisë së Hetimit Tatimor me IT te specializuar, software dhe pajisje elektronike shitesë për përpunimin e të dhënave digjitale është një sfidë reale për vitin 2026, pasi marrja dhe përpunimi i të gjitha të dhënave digjitale financiare kërkon kohë dhe burime njerëzore të posacme.
- 5. Një sfidë e veçantë është gjithashtu përdorimi në rritje i kriptovalutave, etj, të cilat për Drejtorinë e Hetimit Tatimor mbeten pothuajse të panjohura dhe pa instrumente financiare e teknik, për analizimin e tyre.** Pavarësisht se, me ndihmën e Ambasadës Britanike në Tiranë kemi filluar të trajojmë 2 Inspektorë të DHT-së, sfidat në këtë sektor ngelet të hapura për ne.
- 6. Tregtia dhe shërbimet në vitet e fundit kanë ndryshuar formë duke kryer transaksionet financiare në fushën digjitale. Aftesitë tona për të mbikqyrur këto transaksione janë të kufizuara pasi, nuk kemi një kuadër për operatorët digjitale në funksion të aktiviteteve ekonomike dhe financiare si dhe burime njerëzore të përshtatshme për këtë treg. Gjithashtu, ky treg është vetëpërshtatur duke ruajtur modelin e ekonomisë me cash pasi, shërben produktin me anë të postës, e cila mundëson edhe arkëtimin e parave si ndërmjetës financiar. Ky rregullim bëhet vetëm në bashkëpunim me AKEP, për ndryshimet e nevojshme kuadër si në operatorët digjital edhe në gjurmimin e shpërndarjes me postë. Sfidat janë për këtë formë të re të ekonomisë mbetet e hapur për vitin 2026 në rritjen e kapaciteteve njerëzore për të tilla tregje dhe bashkëpunim me i ngushtë me AKEP-in deri në ndryshimet e nevojshme kuadër.**

Në përmbledhje, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka arritur rezultate të dukshme gjatë vitit 2025, por sfidat teknologjike, financiare dhe të burimeve njerëzore, përfshirë

kriptoalutat, mbeten prioritet për adresim, në mënyrë që të forcohet kapaciteti hetimor dhe ndikimi i saj në mbrojtjen e interesave fiskale të shtetit.

III.ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në zbatim të **Rekomandimeve të Bashkimit European për realizimin e Growth Plan 2024-2027 për indikatorin 1**, gjatë vitit 2025 Drejtoria e Hetimit Tatimor ka nisur auditimin e individëve të pasur që përfitojnë të ardhura nga rrjetet sociale, pronësia e makinave luksoze dhe aktivitetet e shitblerjes së aksioneve, duke synuar identifikimin e rasteve me risk të lartë fiskal dhe zbulimin e shmangieve të mundshme tatimore.

Sipas indikatorit 1, që parashikon auditimin e 200 individëve të pasur në dy vite (2025-2026), për vitin 2025, tre sektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor - kanë audituar gjithsej 150 individë dhe i kanë propozuar për vlerësim tatimor. Nga ky numër, për 46 individë kanë përfunduar vlerësimet, duke rezultuar në detyrime tatimore të konstatuara për evazion fiskal në shumën totale prej 107,480,898 lekë. Janë në proces vlersimi 104 individë të tjere të cilët janë kryer analizat përkatëse, të cilëve do j'u lindin detyrimet në vitin 2026.

Ky aktivitet ka treguar efektivitetin e metodologjisë së Drejtorisë në identifikimin e fenomeneve me risk të lartë dhe në përgatitjen e bazës për vlerësimin tatimor të detyrimeve të papaguara. Auditimet e kryera brenda këtij viti përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt arritjes së objektivit dyvjeçar të auditimit të 200 individëve të pasur, duke forcuar disiplinën tatimore dhe zbatimin e ligjit.

Gjithashtu sipas të njëjtit indikator **kërkohet nga DHT të kryen për vitet 2025-2027 të paktën - 500 analiza hetimore**, bazuar në planet vjetore, ku vetëm për vitin 2025 janë realizuar **-200 analiza hetimore**. Sipas këtij ritmi, parashikohet të arrihet brënda afatit, qershor 2027 edhe ky tregues.

IV. ANALIZA E SEKTORIT TË HETIMIT TATIMOR

Në këtë kapitull të raportit zhvillohet një analizë përmbledhëse e veprimtarisë së Sektoriti të Hetimit Tatimor për vitin 2025, duke paraqitur një pasqyrë të detajuar të

punës së kryer në zbatim të planit operacional të Drejtorisë së Hetimit Tatimor dhe prioriteteve strategjike për luftën kundër evazionit fiskal, si dhe kundër veprave të tjera penale që dëmtojnë interesat fiskale të shtetit.

Sektori i Hetimit ka bashkëpunuar ngushtë me sektoret e tjera të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, si dhe me institucionet ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, duke synuar rritjen e efektivitetit të punës hetimore, përmirësimin e metodologjisë së administrimit të provave dhe rritjen e cilësisë së referimeve të rasteve në organet e ndjekjes penale.

Të dhënat paraqiten më poshtë në formë tabelore, duke reflektuar qartë rezultatet e punës hetimore dhe impaktin e saj në identifikimin dhe luftimin e fenomeneve me risk të lartë fiskal.

4.1 Analizë për propozimet për kontroll/vlersimet tatimore

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit ka kryer veprimtari të shumta hetimore: janë punuar **48 kërkesa për kontroll ndaj subjekteve** dhe **5 kërkesa për rikontroll**, ndërsa janë propozuar **46 vlerësime tatimore ndaj subjekteve** dhe **22 vlerësime ndaj individëve**. Nga këto propozime, janë **përfunduar 19 kontrolle tatimore** që kanë rezultuar me detyrime tatimore në vlerë totale **153,751,317 lekë**, 4 rikontrolle të përfunduara me detyrime **736,931,254 lekë**, 34 vlerësime tatimore ndaj subjekteve me gjetje **18,179,956,752 lekë** dhe 4 vlerësime ndaj individëve me gjetje **17,059,033 lekë**. Nga këto veprime, 7 kontrolle dhe 4 vlerësime ndaj individëve janë referuar në Prokurori për veprat penale të “Fshehjes së të ardhurave”, ndërsa 23 vlerësime tatimore ndaj subjekteve janë referuar gjithashtu për ndjekje penale për “Fshehje të ardhurash”, etj. Ndërsa 12 dosje janë të deleguara nga Prokuroria për hetime të mëtejshme.

Propozime per kontroll/vlersim	Numri i kërkesave / veprimeve	Përfunduar	Në proces	Vlera e gjetjeve (lek)	Referuar në prokurori	Nga prokuroria / Dosje të deleguara	Shënime
Kontroll ndaj subjekteve	48	19	29	153,751,317	7	7	29 kontrolle ende në proces
Rikontroll ndaj subjekteve	5	4	0	736,931,254	0	1	1 rikontroll ne proces
Vlerësim tatimor ndaj subjekteve	46	34	12	18,179,956,752	23	12	12 vlerësime në proces

Vlerësim tatimor ndaj individëve	22	4	18	17,059,033	4	0	18 vlerësime në proces, 4 referime për neni 180 K.Penal
----------------------------------	----	---	----	-------------------	---	---	---

Sic vërehet nga tabela të dhënat tregojnë një nivel të lartë të zbatimit të veprimeve hetimore dhe efektivitet në identifikimin e mosdeklarimeve dhe evazionit tatimor, duke kontribuar në rritjen e detyrimeve të konstatuara dhe ndjekjen ligjore të rasteve që kryejn evazion fiskal.

4.5 Referimet në Prokurori

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit Tatimor, në bashkëpunim me Sektorin e Administrimit dhe Analizës, si dhe me Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, kanë referuar në Prokurori një numër të konsiderueshëm çështjesh.

Burimi i referimit	Numri i referimeve
Nga sektori i Hetimit	62 (1 rast nga shkresat sekrete)
Ardhur nga sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës	16
Ardhur nga sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave	17
Totali referime	95 çështje me (133 subjekte)

Kjo tabelë tregon burimin dhe numrin e referimeve të çështjeve në prokurori gjatë vitit 2025. Referimet nga Sektori i Hetimit, së bashku me ato të ardhura nga Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës si dhe sektori i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, reflektojnë mënyrën se si çështjet e identifikuara gjatë hetimit përpunohen për ndjekje penale. Numri total i **referimeve është 95**, por ato përfshijnë **133 subjekte**, duke reflektuar faktin se disa referime përfshijnë më shumë se një subjekt. Referimet lidhen me fenomenet fiskale të identifikuara gjatë hetimeve, si fshehje të ardhurash, pastrim parash, mospagim i detyrimeve tatimore, skema mashtrimi me TVSH etj.

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit Tatimor, në bashkëpunim me Sektorin e Administrimit dhe Analizës, si dhe, me Sektorin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, kanë referuar gjithsej 95 çështje në Prokurori. Çështjet përfshijnë kryesisht fshehje të ardhurash, mospagim të tatimeve dhe pastrimin e produktit të veprës penale etj.

Nga përmbledhja e të dhënave, vlerat totale të detyrimeve të evidentuara sipas nenëve të Kodit Penal nga Drejtoria e Hetimit Tatimor janë:

- Nenet 180 dhe 181 të K.Penal = **10,307,608,841 lekë;**
- Neni 144 i K.Penal = **70,986,655 lekë;**
- Neni 287 i K.Penal = **517,747,887 lekë;**

Nga hetimet tona kemi evidentuar se vihet re një tendencë për sofistikimin e skemave me fatura fiktive të abuzimit me buxhetin e shtetit (rimbursim tvsh-je). Disa nga veçoritë e këtyre skemave janë;

Krijimi i subjekteve tregtare fiktive. Krijohen shoqëri tregtare fiktive të cilat ngrihen me qëllim faturime fiktive ndaj shoqërive që duan të ulin fiktivisht fitimin kështu duke abuzuar dhe përfituar padrejtësisht rimbursim të tvsh-së dhe, duke çuar kështu dhe në mospagim tatim fitimi që duhej të paguanin, në shkelje të ligjit. Këto shoqëri kryesisht hapen me objekt aktiviteti shërbimesh, duke qënë më e vështirë faktimi i punës së kryer sesa në rastet kur ka mallra, dhe vërtetimi që puna nuk është kryer dhe shërbimi është fiktiv është më e vështirë të provohet. Këto shoqëri operojnë për një kohë të shkurtër dhe më pas pezullohen ose lihen me detyrime të papaguara.

Roli i ortakëve të fshehtë: Ortakët *de facto* të shoqërive tregtare të cilat aplikojnë për rimbursim tvsh-je apo faturime fiktive, fshihen dhe nuk dalin në pah, por përdorin persona të tjerë si ortakë fiktivë, *de jure* në dokumentacionin e shoqërisë.

4.6 Delegimet nga Prokuroritë

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit ka marrë dosje të deleguara nga Prokuroritë për çështje të ndryshme penale. Këto hetime janë kryesisht në drejtim të veprave penale të “Fshehjes së të ardhurash”, “Mospagimit të taksash dhe tatimeve”, “Krijimit të skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar”, “Pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 180, 181, 144/a, 287, etj, të K.Penal.

Statusi i dosjeve	Nr	Shënime
Dosje të mbartura nga vitet e mëparshme (2021-2024)	78	Dosje të deleguara paraprakisht
Dosje të reja të deleguara gjatë vitit 2025	60	Dosje të reja që iu janë deleguar inspektorëve gjatë vitit
Dosje të dërguara për gjykim	46	Përfundim i procedurës, në gjykatë
Dosje derguar për kompetencë SPAK	1	Kalim për ndjekje në SPAK

Dosje të përfunduar (vlerësim prokurori)	3	Relacion përfundimtar, çështje e mbyllur
Dosje të tërhequra nga prokurori (largim)	1	Prokurori i larguar e ka tërhequr dosjen
Dosje të dërguara për pushim	4	Përfundim i hetimit, pushim procedural
Dosje të dorëzuara në prokurori nga 2 inspektorë të larguar	18	Dorëzohen në prokuroritë përkatëse, ndjekja vazhdon nga prokurorët aktualë
Gjendja përfundimtare e dosjeve të deleguara që do mbarten në 2026	65	Pas dorëzimit të 18 dosjeve dhe llogaritjes së dosjeve të tjera të përfunduara/pushuar

Kjo pasqyrë tregon rrjedhën e punës hetimore dhe menaxhimin e dosjeve të deleguara nga fillimi deri në përfundim. Këto të dhëna tregojnë përmirësime në efektivitetin e hetimit të sektorit, me një balancim mes hetimeve të hapura dhe atyre të përfunduara, duke synuar një menaxhim më të qëndrueshëm të volumit të punës.

4.7 Bashkëpunime me autoritetet e huaja (Letërporosi)

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit ka bashkëpunuar me autoritetet e huaja përmes letërporosive, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen e hetimeve në çështje komplekse ndërkombëtare. Ky bashkëpunim ka mundësuar ndjekjen e veprave penale me elementë ndërkufitar dhe rritjen e efikasitetit të hetimeve tatimore dhe financiare.

Lloji	Nr	Vendet	Status
Letërporosi dërguar jashtë shtetit	3	Irlandë, Hollandë, Gjermani	2 janë ezaurura, 1 është në proces
Letërporosi pranuar nga jashtë shtetit	8	Greqi, Portugali, Britania e Madhe	3 janë ezauruar, 5 janë në proces

4.9 Plane masash dhe analiza të realizuara nga Sektori i Hetimit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit ka planifikuar dhe realizuar një sërë masash dhe analizash me qëllim identifikimin dhe ndjekjen e informalitetit dhe evazionit fiskal në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Një nga prioritetet kryesore ishte zbulimi i informalitetit në sektorin e qirave afatshkurtra përmes platformave **Airbnb** dhe **Booking**, ku shumë hoste nuk deklarorin të ardhurat, duke krijuar një evazion të lartë. Pas një procesi të gjatë për mbledhjen e informacionit përmes letrëporosive dhe takimeve në **Hollandë dhe Paris**, si dhe takimeve me përfaqësues të platformave u arrit të merrej informacioni mbi hostet që ofrojnë shërbime përmes këtyre platformave. Të dhënat e administruara tregojnë qartë informalitet dhe evazion në **vlera të larta**, dhe aktualisht janë duke filluar procedurat e vlerësimit të

individëve që nuk kanë deklaruar këto të ardhura, kjo në bashkëpunim edhe me vendimarrjet e Komitetit të Riskut.

Një fokus tjetër ishte sektori i **hidrokarbureve**, ku u zbuluan evazione dhe skema mashtruese të shoqërive të huaja që operojnë në Shqipëri si koncesionarë. Në këtë kontekst, u identifikuan skema mashtruese nga shoqëri si “**Bankers Petroleum Albania**” Ltd apo “**Delvina Gaz Company**”, të cilat janë referuar në Prokurori, ndërsa disa subjekte të tjera janë ende në proces hetimi dhe analize nga ne.

Gjatë **sezonit turistik**, inspektorët e Sektorit të Hetimit vepruan proaktivisht duke marrë pjesë në mbi **30 kontrole në terren** si dhe duke sekuestruar pajisje kamerash dhe njësi kompjuterike në hotele dhe restorante që kryenin evazion fiskal. Një pjesë e këtyre subjekteve janë referuar në Prokurori dhe janë aktualisht në proces hetimi dhe analizash, ndërsa për një pjesë subjektesh të tjera i kemi në pritje të rezultateve të vlerësim/kontrolleve që janë duke kryer Drejtoritë Rajonale të Tatimeve në bazë të Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm mbi sqarimin e zbatimit të nenit 127 të ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Këto plane dhe analiza dëshmojnë përkushtimin e sektorit për të monitoruar dhe goditur informalitetin dhe evazionin fiskal në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar.

Për vitin 2025, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer 40 Trajnime / Takime / Konferenca / Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

4.10 Vizita studimore/Trajnime/konferenca jashtë shtetit

Për vitin 2025, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga Drejtori i Hetimit Tatimor janë kryer gjithashtu mbi 40 Trajnime/Takime/Konferenca/Vizita Studimore Suedi/Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër krimeve financiare nga sektori i Hetimit Tatimor.

Gjatë vitit 2025, Sektori i Hetimit ka trajtuar një volum të konsiderueshëm dokumentacioni zyrtar, me 1,594 shkresa hyrëse dhe 1,048 shkresa dalëse, duke reflektuar aktivitetin intensiv dhe punën e vazhdueshme të sektorit në mbledhjen, analizimin dhe dërgimin e informacionit të nevojshëm për hetimet.

4.11 Analizë krahasuese e performancës me vitin 2024

Gjatë viteve 2024 dhe 2025, Sektori i Hetimit Tatimor ka evidentuar dhe referuar në Prokurori një numër të konsiderueshëm rastesh, duke reflektuar rritjen e aktivitetit hetimor dhe angazhimin e shtuar në parandalimin dhe zbulimin e evazionit fiskal.

Tabela e mëposhtme pasqyron qartë këtë rritje në vitin 2025, si në terma absolutë ashtu edhe në përqindje. Krahasimi i të dhënave ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 tregon një rritje shumë të ndjeshme të volumit dhe efektivitetit të punës së Sektorit të Hetimit Tatimor.

Treguesi	Viti 2024	Viti 2025	Rritja në numër	Rritja në %
Referime në Prokurori	57	95	38	66.00%
Subjekte të referuara	66	133	67	102%
Vlera e (lekë) e detyrimeve neni 180 & 181	866,124,261	10,307,608,841	9,441,484,580	1090%
Vlera(lekë) neni 287 – Pastrim parash	115,759,278	517,747,887	401,988,609	347%

Krahasimi i të dhënave ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 tregon një rritje shumë të ndjeshme të volumit dhe efektivitetit të punës së Sektorit të Hetimit Tatimor. Numri i referimeve në Prokurori është rritur me 38 raste, ose rreth 66%, ndërsa numri i subjekteve të referuara është dyfishuar, duke shënuar një rritje mbi 102%.

Veçanërisht domethënëse paraqitet rritja e vlerave financiare të detyrimeve të evidentuara, ku për veprat penale të parashikuara nga nenet 180 dhe 181 të K.Penal, vlera totale e konstatuar është rritur mbi dhjetë herë krahasuar me vitin 2024. Gjithashtu, vlerat e evidentuara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal është rritur me mbi 400 milionë lekë.

Në tërësi, këto të dhëna dëshmojnë një rritje të qartë të kapaciteteve hetimore, forcim të bashkëpunimit ndërsektorial dhe një orientim të qartë drejt goditjes së evazionit tatimor në nivele më të larta financiare gjatë vitit 2025.

Në përfundim, krahasimi me vitin 2024 konfirmon një rritje të ndjeshme të performancës së Sektorit të Hetimit Tatimor gjatë vitit 2025, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor e financiar. Krahas rritjes së referimeve në Prokurori, të dosjeve të deleguara të dërguara për gjykim dhe të vlerave të detyrimeve tatimore të evidentuara, vërehet edhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, i reflektuar në rritjen e aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimin e informacionit dhe pjesëmarrjen në trajnime dhe nisma

ndërkombëtare. Këta elementë dëshmojnë konsolidimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efektivitetit të hetimeve në goditjen e evazionit tatimor të vitit 2025.

V.ANALIZA E SEKTORIT TË ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE ANALIZËS

5.1 Analiza e të dhënave për kërkesat e informacionit gjatë vitit 2025

Një nga funksionet bazë dhe më të rëndësishme të Sektorit të Administrimit të Informacionit dhe Analizës (AIA) është trajtimi i kërkesave për informacion dhe garantimi i një qarkullimi të kontrolluar, të dokumentuar dhe brenda afateve të komunikimit zyrtar me institucionet ligjzbatuese dhe me struktura të tjera publike brenda dhe jashtë Administratës Tatimore. Ky funksion ka një rëndësi të dyfishtë: (i) mbështet organet e drejtësisë dhe ligjzbatimit me informacion tatimor të nevojshëm për hetime/procedime, dhe (ii) siguron që DPT/DHT të ketë një mekanizëm të besueshëm të gjurmueshmërisë dhe standardizimit të përgjigjeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për të dhëna sensitive ose të klasifikuara.

Pershkrimi	Nr	Shënime
Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm	946	Kërkesa për informacione nga databazat tatimore
Prokuroria e Posaçme	15	Kërkesa për informacione nga databazat tatimore
Drejtoria e Policisë së Shtetit	127	Kërkesa për bashkepunime dhe informacione nga databazat tatimore
Institucione të klasifikuara	86	Kërkesa për informacione dhe vënie në dijeni
Drejtoria e Informacionit	24	Kërkesa në funksion të ligjit për Shkëmbimin e të Dhënave Financiare me agjencitë homologe të vendeve partnere
Institucione të tjera bashkëpunimi	85	Kërkesa për informacione dhe vënie në dijeni
Denoncime nga burime të ndryshme	147	Raste abuzive të evidentuara nga qytetarë dhe entitete të ndryshme
Komunikime të tjera	77	Kërkesa për informacione dhe vënie në dijeni
Gjendja përfundimtare e shkresave të trajtuara	1537	Shkresa të ardhura/dërguara me kërkesë për informacion, kalim për kompetencë etj

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 janë trajtuar gjithësejt 1537 kërkesa për informacion.

5.2 Analizë për propozimet për kontroll/vlerësimet tatimore

Gjatë vitit 2025, Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës (AIA) ka zhvilluar një veprimtari të gjerë në funksion të mbështetjes analitike dhe informative të proceseve hetimore dhe administrative të Drejtorisë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, AIA ka administruar dhe përpunuar një volum të konsiderueshëm kërkesash dhe çështjesh, të cilat janë trajtuar përmes verifikimeve në sistemet tatimore, konsultimit të dokumentacionit arkivor pranë rajoneve respektive dhe kryqëzimit të të dhënave nga burime të ndryshme si ato sektoriale ekonomike dhe burime të hapura. Si rezultat i analizës paraprake, sektori ka përgatitur dhe përcjellë për trajtim në strukturat përkatëse:

- 3 kërkesa për kontroll tatimor ndaj subjekteve;
- 2 kërkesa për rikontroll;
- 10 propozime për vlerësim tatimor ndaj subjekteve;
- 67 propozime për vlerësim tatimor ndaj individëve.

Nga propozimet dhe materialet analitike të përcjella nga AIA, janë ndjekur dhe finalizuar një numër rastesh nga strukturat e drejtorive të kontrollit respektive, të cilat kanë rezultuar me detyrime tatimore të konstatuara dhe/ose me gjetje me ndikim fiskal. Në formë tabele aktiviteti i vitit 2025 në bashkëpunim me Drejtorite e Kontrollit paraqitet si me poshtë;

- 1 kontroll tatimor, me detyrime tatimore në vlerë totale 333,219 lekë;
- 2 vlerësime tatimore ndaj subjekteve, me gjetje në vlerë 4,169,166 lekë;
- 26 vlerësime tatimore ndaj individëve, me gjetje në vlerë 26,103,940 lekë.

Përveç kontributit në masat administrative, AIA ka pasur rol të rëndësishëm edhe në filtrimin dhe dokumentimin paraprak të rasteve me elementë të dyshuar penalë. Në bazë të analizave dhe materialeve të përgatitura, **16 çështje janë referuar për ndjekje penale në bashkëpunim me Sektorin e Hetimit pranë organeve të prokurorisë.**

Në përmbledhje, veprimtaria e AIA gjatë vitit 2025 ka shërbyer si hallkë kyçe për rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve të Drejtorisë, duke garantuar që veprimet hetimore dhe administrative të bazohen në analiza paraprake të strukturuar, në të dhëna të verifikuara

dhe në dokumentim të plotë, si për qëllime të vlerësimit tatimor ashtu edhe për referime të argumentuara për ndjekje penale.

5.3 Bashkëpunime me autoritete e huaja (Letërporosi)

Gjatë vitit 2025, Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës (AIA) ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në bashkëpunimin me autoritete të huaja, nëpërmjet trajtimit të kërkesave të ardhura nga Drejtoria e Informacionit, në funksion të zbatimit të kuadrit ligjor për shkëmbimin e të dhënave financiare me agjencitë homologe të vendeve partnere. Në këtë kontekst, **AIA ka përpunuar 24 kërkesa**, të cilat përbëjnë rreth 1.6% të totalit të kërkesave shkresore të administruara gjatë vitit. Edhe pse në përqindje ky volum rezulton relativisht i kufizuar, natyra e këtyre kërkesave është e veçantë dhe zakonisht kërkon një nivel më të lartë rigoroziteti, pasi lidhet me komunikime ndërkufitare ku saktësia e të dhënave, respektimi i afateve dhe standardizimi i përgjigjeve janë elementë thelbësorë. Vendet nga të cilat janë kërkuar informacione janë Italia, Belgjika, Greqia, Anglia dhe Tunizia.

Në trajtimin e këtyre kërkesave, sektori ka ndërmarrë verifikime dhe kryqëzime të të dhënave të cilat kërkojnë një kohë relativisht të gjatë.

Në tërësi, trajtimi i kërkesave në kuadër të bashkëpunimeve me autoritete të huaja gjatë vitit 2025 ka shërbyer për forcimin e rolit të AIA si strukturë mbështetëse e shkëmbimit të informacionit dhe analizës, duke kontribuar në përmbushjen e angazhimeve institucionale në dimensionin ndërkombëtar dhe në rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit me agjencitë homologe të vendeve partnere.

5.6 Analizë krahasuese e performancës 2024-2025

Në vitin 2025 evidentohet një rritje e fortë e volumit të punës së Sektorit AIA, me **+58.6% krahasuar me vitin 2024**, ç'ka reflekton një ngarkesë më të lartë në administrimin, ndjekjen dhe përpunimin e kërkesave për informacion. Kjo rritje nuk është vetëm sasiore, por shoqërohet edhe me një ndryshim domethënës në profilin e komunikimeve, duke e orientuar sektorin drejt një pune më intensive “në funksion operativ”, me kërkesa që kërkojnë reagim më të shpejtë, filtrime paraprake dhe koordinim më të ngushtë me strukturat e tjera të Drejtorisë.

Në funksion të objektit të veprimtarisë çështje janë verifikime dhe vlerësime nëpërmjet informacioneve në sistemet tatimore e atyre në formatin arkivor pranë rajoneve respektive dhe kryqëzimi i tyre nëpërmjet analizave paraprake për tatimpagues të ndryshëm të raportuara në sektor në rrugë komunikimi të ndryshme shkresore apo me email me burim informacioni të ndryshme si, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut,

denoncime, institucione të tjera ligjzbatuese, etj. Ky aktivitet kërkon dhe sigurohet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm komunikimi, grumbullim dhe vlerësim të informacionit. Në pasqyrim të këtij aktiviteti gjatë 2025 rezultojnë;

- 66 çështje të ardhura nga viti 2024
- 147 çështje të regjistruara gjatë vitit 2025

Në total **gjatë vitit 2025 sektori i AIA ka përpunuar 213 çështje.**

VI. ANALIZA E SEKTORIT TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Analiza vjetore të Sektorit të Parandalimit të Pastrimit të Parave për periudhën Janar–Dhjetor 2025, në kuadër të veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve synon të ofrojë një pasqyrë të plotë dhe të argumentuar mbi punën e kryer gjatë vitit 2025.

Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave ushtron rol thelbësor në identifikimin, përpunimin dhe vlerësimin e rasteve me indikatorë të dyshuar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, veçanërisht kur këto fenomene shfaqen të ndërlidhura me sjellje tatimore, mospërputhje financiare, skema mashtruese, transaksione të pazakonta apo përdorim të strukturave të ndërmjetme për fshehjen e origjinës së të ardhurave. Në këtë kuadër, sektori kontribuon në rritjen e integritetit fiskal dhe në forcimin e qasjes parandaluese të administratës tatimore, duke orientuar veprimet drejt rasteve me risk të lartë dhe duke mbështetur ndërhyrjet administrative dhe/ose referimet për ndjekje penale, sipas natyrës së çështjes.

6.1 Analiza e të dhënave për çështje të regjistruara gjatë vitit 2025

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Sektori i Parandalimit të Pastrimit të Parave (PPP) ka ushtruar një veprimtari të gjerë analitike dhe operative në funksion të identifikimit të rasteve me indikatorë të dyshuar të pastrimit të parave dhe/ose skemave me impakt fiskal, duke i orientuar këto raste drejt instrumenteve përkatëse administrative (vlerësim/kontroll tatimor) dhe, sipas rastit, drejt referimit për ndjekje penale. Trajtimi i çështjeve është mbështetur në analizën e të dhënave nga sistemet tatimore, dokumentacionin shoqëruar, si dhe komunikimet dhe shkresat e ardhura nga burime institucionale, përfshirë autoritetet ligjzbatuese dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF/FIU).

Në kuadër të propozimeve për kontroll tatimor dhe vlerësimeve tatimore të ndërmarra gjatë vitit 2025, sektori ka trajtuar në total **113 subjekte/individë**, me një vlerë totale 470,509,582 lekë. Këto raste ndahen në mënyrë të detajuar si më poshtë:

- Individë të propozuar për vlerësim tatimor: janë propozuar **59 individë**, nga të cilët kanë përfunduar 18 vlerësime me gjetje në vlerën 48,050,563 lekë. Ky grup rastesh reflekton vlerësimin e indikatorëve të riskut të lidhur me mospërputhje të të ardhurave të deklaruar, flukse të dyshimta financiare dhe/ose elementë të tjerë që kërkojnë verifikim të thelluar.
- Subjekte të propozuara për vlerësim tatimor: **janë propozuar 7 subjekte**, nga të cilat kanë përfunduar 2 vlerësime me gjetje në vlerën 101,375,765 lekë. Edhe pse ky segment ka volum më të ulët, ai paraqet raste me peshë të konsiderueshme fiskale dhe kompleksitet më të lartë analitik.
- Subjekte të propozuara për kontroll tatimor: **janë propozuar 47 subjekte**, nga të cilat kanë përfunduar 27 kontrolle me gjetje në vlerën 321,083,254 lekë. Ky është segmenti me impaktin më të madh në rezultatet e konfirmuara, duke treguar që përzgjedhja e rasteve për kontroll është orientuar drejt profileve me risk të lartë.

Në tërësi, shpërndarja e rezultateve tregon se kontrollet tatimore kanë prodhuar pjesën më të madhe të gjetjeve të konfirmuara gjatë vitit 2025, ndërkohë që vlerësimet tatimore kanë shërbyer si instrument i rëndësishëm për trajtimin e rasteve të targetuara, veçanërisht në segmentin e individëve dhe në raste të caktuara të subjekteve.

6.5 Shkresa RAD

Në kuadër të raportimit dhe komunikimit zyrtar me AIF, për periudhën Janar–Dhjetor 2025 sektori ka përcjellë **28 RAD (Raste të Aktivitetit të Dyshimtë)**, duke kontribuar në zinxhirin e sinjalizimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për rastet me indikatorë të dyshimtë.

6.6 Bashkëpunime me autoritetet e huaja (Letërporosi)

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe komunikimeve ndërkufitare, gjatë vitit 2025 është trajtuar 1 shkresë me autoritetet e shtetit Grek, në funksion të shkëmbimit të informacionit për çështje konkrete në trajtim.

XIX. DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE

Drejtoria e Administrimit të të Dhënave në organigramën e DPT-së është në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Administrimit të të Dhënave, i cili është përgjegjës për koordinimin, mbikëqyrjen dhe drejtimin e veprimtarisë së kësaj drejtorie në përputhje me objektivat dhe politikat institucionale të administratës tatimore. Kjo drejtori luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe administrimin e informacionit, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të përditësuara dhe të disponueshme për strukturat përkatëse të institucionit.

Kjo drejtori është e organizuar në 2 sektorë, të cilët funksionojnë në mënyrë të koordinuar për të përmbushur detyrat që lidhen me administrimin, përpunimin dhe raportimin e të dhënave:

Sektori i Administrimit të të Dhënave me 1 Përgjegjës dhe 4 Inspektorë, i cili është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave, si dhe për sigurimin e cilësisë dhe integritetit të tyre në sistemet përkatëse.

Sektori i Raportimit të të Dhënave me 1 Përgjegjës dhe 5 Inspektorë, i cili merret me përpunimin, analizimin dhe përgatitjen e raporteve të ndryshme statistikore dhe informative, në funksion të mbështetjes së proceseve vendimmarrëse dhe kërkesave për informacion nga strukturat e brendshme dhe institucionet e tjera.

Objekti parësor i kësaj drejtorie është administrimi, përpunimi dhe raportimi i të dhënave, duke siguruar menaxhimin e saktë dhe të strukturuar të informacionit në funksion të veprimtarisë së administratës tatimore dhe mbështetjen e proceseve vendimmarrëse përmes raportimeve dhe analizave të ndryshme. Drejtorja luan një rol të rëndësishëm në garantimin e cilësisë, integritetit dhe aksesueshmërisë së të dhënave, si dhe në koordinimin e kërkesave për informacion që vijnë nga strukturat e brendshme dhe institucionet e tjera.

Gjatë vitit 2025, në këtë drejtori janë trajtuar rreth 1200 raportime përmes komunikimit zyrtar me email, të cilat kanë konsistuar kryesisht në kërkesa për informacion, përpunim të të dhënave, raportime statistikore dhe koordinim me strukturat e tjera të administratës tatimore dhe institucione të ndryshme. Përveç kësaj, janë përgatitur dhe dërguar edhe 10 kthime përgjigjesh zyrtare me shkresë, në përgjigje të kërkesave institucionale që kanë kërkuar trajtim dhe komunikim formal administrativ. Këto procese kanë kërkuar bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet sektorëve të drejtorisë për të siguruar saktësinë, plotësinë dhe kohën e duhur të përgjigjeve.

Gjithashtu, Drejtorja e Administrimit të të Dhënave ka dhënë kontributin e saj në procesin e implementimit dhe certifikimit të standardit ISO 27001, duke mbështetur

proceset që lidhen me administrimin e sigurt të informacionit dhe menaxhimin e të dhënave në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit. Në këtë kuadër, drejtoria ka kontribuar në identifikimin dhe dokumentimin e proceseve që lidhen me administrimin dhe raportimin e të dhënave, si dhe në zbatimin e praktikave që synojnë rritjen e nivelit të sigurisë, integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit. Ky kontribut ka qenë pjesë e përpjekjeve institucionale për forcimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të mënyrës së administrimit dhe mbrojtjes së të dhënave në institucion.